



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 304 Akti

Nr. 297 Vendimi
Tiranë, më 17.9.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datat 14 dhe 15 shtator 2020, përkatësisht në orën 14:30 dhe 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Tritan Hamitaj**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Tritan Hamitaj, aktualisht me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.3.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Tritan Hamitaj, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët: Genta Tafa (Bungo), Suela Zhegu dhe Lulzim Hamitaj. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 20.3.2019, u caktua me mirëkuptim kryesues znj. Suela Zhegu, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Tritan Hamitaj.
5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Tritan Hamitaj, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.
7. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Tritan Hamitaj. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ky institucion, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:
 - deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor në mbështetje të deklarimeve;
 - ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
8. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në datën 29.6.2020, vendosi:

¹ Me shkresën nr *** prot., datë 18.6.2018.

(i) përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Tritan Hamitaj, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes, bazuar mbi kriterin e pasurisë; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruar nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

9. Subjekti i rivlerësimit, në datën 30.6.2020, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë deri në datën 15.7.2020 apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni.

10. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 2.7.2020 dhe më 9.7.2020, ka njoftuar Komisionin rreth gjendjes së tij shëndetësore, duke kërkuar shtyrje të afatit për dhënien e shpjegimeve dhe provave.

11. Subjekti, në datën 15.7.2020, me anë të postës elektronike, ka kërkuar shtyrje të afatit, duke vënë në dispozicion të Komisionit:

- raport mjekësor lëshuar nga mjeku i familjes datë 3.7.2020 për z. Tritan Hamitaj, për datat 3-6.7.2020;
- përgjigje e Njesisë vendore të kujdesit shëndetësor Durrës nr. ***, datë 10.7.2020, sipas së cilës ka rezultuar me Covid-19, që nga data 7.7.2020.

12. Në datën 16.7.2020 subjekti u njoftua se trupi gjykues ka pranuar kërkesën e tij për shtyrje të afatit deri në fund të muajit korrik dhe në datën 27.7.2020, subjekti ka dërguar nëpërmjet postës elektronike² një kërkesë procedurale. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga subjekti, ka konstatuar se përmbush kushtet e një kërkesë të mirëfilltë procedurale, duke vlerësuar çdo pikë të saj. Në përfundim, trupi gjykues, me vendim nr. 3³, datë 28.7.2020, vendosi të pranojë pjesërisht pikën 1 dhe 2 të kërkesës, si dhe plotësisht pikën 3 të saj, ndërkohë që për pikat e tjera vendosi refuzimin e tyre.

13. Në datën 31.7.2020 subjekti ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit. Subjekti ka vazhduar të dërgojë provat e tij me *e-mail* edhe në datat 2.8.2020, 20.8.2020, 3.9.2020, 6.9.2020, të gjitha këto të administruara nga trupi gjykues.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë me *e-mail*, në datën 31.8.2020.

16. Në datën 8.9.2020, subjekti ka kërkuar, nëpërmjet postës elektronike, shtyrje të seancës dëgjimore për shkak të problemeve shëndetësore të familjarëve të tij. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi këtë kërkesë, kërkoi informacionin e nevojshëm⁵ nga strukturat përkatëse, ku konstatoi se kërkesa e subjektit nuk është e bazuar në prova dhe, për këtë, njoftoi subjektin me *e-mail*-in e datës 9.9.2020, ora 16:01.

² Shiko *e-mail*-in e datës 27.7.2020, ora 20:05.

³ Njoftuar subjektit në datën 29.7.2020.

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 4, datë 31.8.2020.

⁵ Shkresa nr. ***, datë 9.9.2020 e Institutit të Shëndetit Publik.

17. Po në të njëjtën datë, me e-mail-in e orës 17:24, subjekti ka dërguar në Komision një raport mjekësor të datës 9.9.2020, me nr. *** regjistri, lëshuar nga Qendra Shëndetësore nr. 1, Durrës, sipas të cilit subjektit i jepen tri ditë pushim dhe është i aftë për punë në datën 12.9.2020.

18. Në këto kushte, trupi gjykues e ftoi subjektin në seancë dëgjimore në datën 14.9.2020, e cila u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, datë 14.9.2020, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

19. Me fillimin e seancës dëgjimore, me anë të një kërkesë paraprake verbale, subjekti ka kërkuar shtyrjen e saj për të paktën tre muaj, me arsyetimin⁶ se: (i) procesi është i vështirë; (ii) për të mbledhur prova është tejet e vështirë; (iii) ka pasuri, ka dinamikë lëvizjeje gjatë gjithë kohës nga viti 2003 e në vazhdim, ka 6 apo më shumë persona të tjerë të lidhur, që i bie 6 subjekte të tjerë për të mbledhur prova dhe të gjenden provat e subjektit tjetër të lidhur është tmerrësisht e vështirë; (iv) nga Komisioni i janë dhënë 46 barrë prove dhe duhej t'u përgjigjej brenda 15 ditëve; (v) provat shtrihen në kohë tejet të largët; (vi) duhet të shkojë në punë 8 orë, ndërkohë ka 3 fëmijë (njëri prej tyre ka probleme dhe është sa 3 të tjerë).

Subjekti ka parashtruar se pasi ka kaluar Covid-19⁷, do të paktën 3 muaj kohë që të kthehet në gjendje normale shëndetësore, për t'u përballur me procesin.

20. Pas kësaj kërkesë, seanca u ndërpre dhe trupi gjykues u tërhoq në dhomën e këshillimit për të shqyrtuar kërkesën e subjektit në prani të vëzhguesit ndërkombëtar.

21. Trupi gjykues konstaton se subjekti ka rezultuar pozitiv me Covid-19 në datën 9.7.2020 dhe negativ në datën 21.7.2020. Pas kësaj, sipas institucionit kompetent, Instituti i Shëndetit Publik, çdo person kur del negativ është i aftë të kthehet në detyrë. Subjektit i janë dërguar rezultatet e hetimit në datën 30.6.2020, duke i përcaktuar një afat të arsyeshëm prej 15 ditësh për të paraqitur provat dhe shpjegimet për të përmbysur rezultatin e hetimit. Subjekti ka kërkuar zgjatjen e këtij afati deri në fund të korrikut 2020, kërkesë kjo që i është pranuar nga trupi gjykues. Subjekti ka paraqitur parashtrimet e tij prej 104 faqesh më 31.7.2020, së bashku me provat mbështetëse dhe është njoftuar për seancën dëgjimore në datën 31.8.2020. Subjekti ka konfirmuar marrjen në dijeni.

Në datën 8.9.2020, dy ditë përpara seancës së njoftuar, subjekti ka kërkuar shtyrjen e saj. Trupi gjykues ka marrë në shqyrtim këtë kërkesë dhe ka njoftuar subjektin për refuzimin e saj, si të pambështetur në prova⁸, dhe për këtë arsye, seanca do të zhvillohej në datën e njoftuar, më 10.9.2020. Menjëherë, pas marrjes së këtij njoftimi me anë të postës elektronike, subjekti ka dërguar raport për paaftësi të përkohshme në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi. Në këto kushte, trupi gjykues ka njoftuar për shtyrjen e seancës dëgjimore dhe zhvillimin e saj në datën 14.9.2020 dhe i ndodhur përpara kësaj kërkesë, bërë nga subjekti në fillim të seancës dëgjimore, pasi e bisedoi çështjen në tërësi, vlerëson se kjo kërkesë nuk duhet pranuar.

Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion, fakte apo prova, pamundësinë e tij për mbrojtje efektive në seancën dëgjimore. Për këtë, trupi gjykues ka parasysh se subjekti ka depozituar në mbrojtje të tij, një material prej 104 faqesh, si dhe provat përkatëse në datën 31.7.2020. Ndërkohë, subjekti ka vazhduar të dërgojë prova shtesë edhe pas përfundimit të afatit, duke pasur mundësinë për mbrojtjen e tij efektive, por nuk solli asnjë raport mjekësor, që të

⁶ Shihni procesverbalin e seancës dëgjimore të datës 14.9.2020.

⁷ Subjekti ka qenë i aftë për punë në datën 22.07.2020 (shkresa e ISHP-së).

⁸ Në kërkesën e tij për shtyrje të seancës, subjekti ka argumentuar se ka dyshime për infektim me Covid-19 të bashkëshortes dhe një prej fëmijëve të tij, por ende nuk u ishte bërë testi/tamponi, ndërsa vetë subjekti ankohet për luhatje të tensionit.

vërtetonte pamundësinë e tij fizike apo mendore për të garantuar një mbrojtje të rregullt ligjore, si dhe nuk ka shfrytëzuar as të drejtën e tij ligjore për t'u paraqitur së bashku me një mbrojtës.

Pretendimi i subjektit se pas kalimit të Covid-19 i duhen të paktën tre muaj kohë për të qenë në gjendje të bëjë një mbrojtje efektive dhe proces të rregullt, nuk u mbështet me asnjë dokument apo studim shkencor. Trupi gjykues, në vlerësimin e tij, pati parasysh faktin se kjo është një kërkesë e përsëritur nga subjekti dhe në këto kushte, vendosi mospranimin e kërkesës për shtyrje të seancës, duke e vijuar atë.

22. Sapo u njoh me këtë vendim të trupit gjykues, subjekti ka paraqitur një kërkesë tjetër, ku ka parashtruar: *“Në nenin C të Aneksit të Kushtetutës pika 3, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit udhëhiqen nga 3 parime themelore dhe i treti është parimi i transparencës. Nga materialet që më janë dërguar, doja të dija, vëzhgues ndërkombëtar ka qenë z. Buatier. Sot në seancë është z. Theo Jacobs. Jam përpjekur nga mjetet e informimit publik të njihem me organizmin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe nuk kam arritur të marr një informacion, a ka apo jo një rregullore të brendshme, si zgjidhen komisionerët, sa është mandati, si zëvendësohen dhe në funksion të këtij parimi edhe për një proces të rregullt ligjor, duke vënë në vëmendje që vëzhguesi ndërkombëtar nuk është thjesht një vëzhgues në momentin që vendi jonë aplikon për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe është i detyruar të ndjekë hapat e përcaktuar prej tij për të marrë ftesën e anëtarësimit dhe janë ca kërkesa që për ne janë të detyrueshme. Edhe Kryeministri i Shqipërisë gjithmonë flet për detyrat e shtetit shqiptar për t'u anëtarësuar në Bashkim Evropian. Në funksion të saj, vëzhguesi ndërkombëtar, pavarësisht se me procedurë ligjore nuk ka vendimmarrje, por siç e dimë, për shkak të kësaj që thashë dhe siç e dimë që ndodh de facto vëzhguesi ndërkombëtar është shumë, është shumë në këtë proces, madje edhe më shumë se ju, sepse rekomandimet e vëzhguesit janë themelore edhe për integrimin e shtetit shqiptar në Bashkimin Evropian. Në funksion të kësaj, doja një informacion.”*

23. Në përgjigje të kërkesës së bërë nga subjekti, kryesuesja e seancës qartësoi se kjo kërkesë nuk ka të bëjë dhe nuk lidhet me aktivitetin e këtij trupi gjykues, lidhur me procesin e rivlerësimit.

Vëzhguesi ndërkombëtar sqaroi më tej subjektin, në përgjigje të kërkesës së tij se: *“ ne jemi thjesht vëzhgues, pra, nuk kemi fuqi vendimmarrëse në proces, në fakt ne nuk mund të ankimojmë, ne thjesht rekomandojmë dhe të kërkojmë që të apelohej, kështu që mos e mbivlerësoni kontributin tonë, kjo e para dhe e dyta ka të bëjë që vëzhguesit ndërkombëtar mund të vendosin midis tyre se kush do të bëjë secilën nga çështjet. Dhe për arsye të bazuara ne mund të shkëmbejmë çështjet në organizatën tonë, që do të thotë mund të fillohet me një vëzhgues dhe të përfundohet me një tjetër, është absolutisht e mundur sepse jemi absolutisht të zëvendësueshëm. Kjo është e vetmja gjë që duhet të dini për ONM-në, nuk ka arsye të veçanta pse sot jam unë këtu dhe jo kolegu im. Herën tjetër do të zëvendësohem nga një koleg tjetër kur të mos jem i disponueshëm, sepse jemi thjesht vëzhgues. Ata mund të punojnë përsosmërisht pa ne, por kanë gjithsesi nevojën që dikush ta vëzhgojë procesin dhe prandaj ndodhi edhe në këtë çështje.”*

24. Pas kësaj kërkesë të dytë në seancë, subjekti paraqiti një kërkesë të tretë, objekt i së cilës është “gjykim nga një trup i formuar sipas ligjit”.

Në parashtrimin e kësaj kërkesë, subjekti arsyetoi: *“ Do kërkoja nga ju durim dhe vëmendje ose të bëni së paku atë që kam bërë unë këto 20 vjet gjyqtar. Mos u mërzisni. Nuk e kam me asnjërin nga ju, por me procesin. Procesi duhet të jetë i rregullt ligjor dhe këto janë kërkesat e mia. Atëherë, objekti i kërkesës është gjykim nga një trup gjykues i formuar sipas ligjit. Në Aneksin e Kushtetutës, në nenin C, paragrafi 1 është parashikuar që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit përbëhet nga 4 trupa gjykues të përhershëm me tre anëtarë secili, të përhershëm,*

e përsëris. Dhe gfarë ndodh. Këto 4 trupa të përhershëm në momentin e krijimit të organit tuaj nuk janë krijuar, nga ana juaj, duke marrë për bazë edhe rregulloren që është e botuar në faqen e internetit 'Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisioni e Pavarur të Kualifikimit', përcakton se trupat gjykues caktohen për çdo short, që kjo rregullore vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Jo më kot Kushtetuta e ka përcaktuar në këtë lloj mënyre rregullimin e KPK-së dhe në momentin që ky parim kushtetues është shkelur, shkojmë te neni 179/b/2 i Kushtetutës, i cili përcakton atë që ritheksova në fillim se rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e procesit të rregullt dhe neni 42/2 i Kushtetutës ka parashikuar që nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme trupi gjykues caktohet me ligj. Duke marrë për bazë statusin tuaj që ju ka caktuar Aneksi i Kushtetutës, një trup gjykues i Gjykatës së Lartë- me statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë dhe kur përdor Kushtetua termin 'e pavarur dhe e paanshme dhe e caktuar me ligj' do të thotë që juve, edhe praktika gjyqësore shqiptare, edhe legjislacioni shqiptar parashikon për organizimin gjyqësor me trupa gjykues jo të përhershëm, sepse duke qenë gjyqtari me mandat derisa del në pension, nuk mund të rrijë në një trup gjykues përjetësisht, por me mandat dyvjeçar. Ligji aktual në fuqi për juve ka thënë të përhershme, sepse mandati juaj është 5 vjet dhe do të thotë që me ato trupa do e filloni gjykimin dhe ato treshe do të vazhdojnë deri në fund. Kjo, jo pa qëllim është parashikuar nga ligjvënësi dhe jo pa qëllim në nivel kushtetues. Ju mund të hiqni fjalën e përhershme nga ligji dhe t'i bëni trupat sipas rregullores. Në këto kushte, unë do të kërkoj që të gjykohem nga një gjykatë e formuar sipas ligjit siç e thotë Kushtetuta, që do të thotë, juve ose vetërregullohuni dhe zbatoni ligjin ose nëse nuk e bëni këtë, unë jam i detyruar të kërkoj përjashtimin tuaj."

25. Me administrimin e kësaj kërkesë, trupi gjykues ndërpreu seancën dhe u tërhoq në dhomën e këshillimit për shqyrtimin e saj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar. Trupi gjykues vlerëson se kërkesa e subjekti nuk gjen mbështetje ligjore dhe, si e tillë, duhet të rrëzohet. Sipas pikës 1 të nenit C të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni përbëhet nga 4 trupa gjykues të përhershëm me tre anëtarë secili, ndërsa ligji nr. 84/2016, në nenin 14 të tij, "Organizimi i Komisionit", pika 1, përcakton se Komisioni organizohet në 4 trupa gjykues, të përbërë nga 3 anëtarë, të cilët caktohen me short. Në asnjë moment, as ligji organik dhe as Aneksi i Kushtetutës nuk ka vënë theksin në 4 trupa me anëtarë të përhershëm. Komisioni është i organizuar gjithmonë në 4 trupa gjykues dhe ky numër është i përhershëm. Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerëson se kjo kërkesë e subjektit i tejkalon kompetencat e saj, për pasojë e gjen atë të pabazuar.

26. Trupi gjykues rifilloi seancën, duke njohur subjektin me vendimin për rrëzimin e kërkesës së tij dhe duke i bërë të ditur se arsyetimi i këtij vendimi do të bëhet në vendimin përfundimtar dhe mund të ankimohet së bashku me të.

27. Menjëherë subjekti ka depozituar një kërkesë të katërt, me 17 pika. Trupi gjykues u tërhoq në dhomën e këshillimit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

28. Gjatë shqyrtimit të kërkesës së katërt, të paraqitur në seancë nga subjekti Tritan Hamitaj, trupi gjykues konstaton se kjo është një kërkesë e përsëritur dhe duke qenë se subjekti ka marrë dijëni me vendim të arsyetuar të trupit gjykues nr. 3, datë 28.7.2020, për të gjitha çështjet e rikërkuara, vlerëson se ndodhen përpara një çështjeje të gjykuar tashmë, për pasojë kjo kërkesë nuk pranohet. Trupi gjykues, i ndodhur përpara një kërkesë të përsëritur, për të cilën subjekti ka marrë dijëni elektronikisht më 29.7.2020, e konsideron këtë përsëritje si një përpjekje për të penguar e vonuar procesin.

29. Me njohjen e vendimit të trupit gjykues për rrëzimin e kërkesës së katërt të tij, subjekti ka depozituar një kërkesë të pestë me objekt "gjykim nga një trup i formuar sipas ligjit, i pavarur dhe i paanshëm". Trupi gjykues ndërpreu seancën për të vlerësuar këtë kërkesë.

30. Trupi gjykues konstaton se subjekti, në përfundim të arsyetimit të tij, ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues të përbërë nga komisionerët: Suela Zhegu, Lulzim Hamitaj dhe

Genta Tafa (Bungo). Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016, një kërkesë e tillë duhet të shqyrtohet nga një trup tjetër gjykues i ngritur me short. Për pasojë, kjo kërkesë iu përcoll menjëherë Komisionit për veprimet e mëtejshme. Ndërkohë, trupi gjykues e njohu subjektin me këtë fakt dhe ndërpreu seancën, për ta rifilluar në datën 15.9.2020, ora 14:00.

31. Me administrimin e kërkesës së subjektit Tritan Hamitaj, për përjashtimin e trupit gjykues, protokolluar nga Komisioni me nr. ***, datë 14.9.2020, me vendim nr. 60, datë 14.9.2020, të Komisionit u përzgjedh me short trupi gjykues që do të marrë në shqyrtim këtë kërkesë. Ky trup gjykues, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi dhe analizoi kërkesën, vendosi në përfundim mospranimin e saj, si kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova. Ky vendim i protokolluar me nr. ***, datë 15.9.2020, iu dërgua menjëherë subjektit nëpërmjet postës elektronike, përpara rifillimit të seancës dëgjimore.

32. Seanca dëgjimore rifilloi në datën 15.9.2020, ora 14:00, në të njëjtën sallë.

33. Subjekti i rivlerësimit, z. Tritan Hamitaj, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer dhe në përfundim të tyre kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

34. Z. Tritan Hamitaj nuk ka qenë gjithmonë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke mos u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe përgjigjet e tij nuk kanë qenë të plota e sqaruese për trupin gjykues.

Komisioni çmon se sjellja e subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, nuk ka qenë bashkëpunuese dhe, si e tillë, e ka vështirësuar punën e organeve në kryerjen e procesit të rivlerësimit. Kundërshtitë në deklaratimet e subjektit gjatë procesit, duket se kanë qenë një mënyrë sjelljeje e qëllimtare, e cila ka synuar të manipulojë të vërtetën, në kundërshtim me detyrimin ligjor që kanë subjektet për të qenë të vërtetë e të saktë përgjatë këtij procesi. Gjithashtu, subjekti gjatë gjithë procesit ka paraqitur kërkesa të përsëritura, të cilat kanë pasur për qëllim zvarritjen e procesit nga ana e tij. Komisioni çmon se kjo sjellje duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit arrihet në konkluzionin se një sjellje e tillë ndaj një procesi kaq të rëndësishëm, jo vetëm për jetën profesionale të subjekteve, por edhe të mirëfunksionimit të vetë sistemit të drejtësisë e shtetit të së drejtës në vend, cenon besimin e publikut te funksionari që e kryen atë.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

35. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

36. Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁹ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

⁹“41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

37. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; dhe (d) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe shpjegimet gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

38. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

39. Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

40. Tokë arë¹⁰ në bashkëpronësi të shtetasve Tritan dhe Rr. H. etj.: pasuria me nr. ***, sip. 597 m²; nr. ***, sip. 395 m²; nr. ***, sip. 1.057 m²; nr. ***, sip. 2.546 m²; nr. ***, sip. 5.024 m²; nr. ***, sip. 4.305 m²; nr. ***, sip. 2188; nr. ***, sip. 2.909 m²; nr. ***, sip. 4.636 m²; nr. 174/1, sip. 2.268 m²; nr. 190/1-ND, sip. 189 m²; nr. 190/9-ND, sip. 60 m², të ndodhur në z.k.

harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Komisionerët Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

¹⁰ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 18.6.2015, për arë me sip. 597 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 18.6.2015 për ullishte me sip. 395 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***; (iii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 18.6.2015, për arë me sip. 1.057 m² me nr. pasurie ***, z. k. ***; (iv) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 18.6.2015 për arë me sip. 2.546 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***; (v) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 18.6.2015 për arë me sip. 5.024 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***; (vi) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 18.6.2015 për arë me sip. 4.305 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***; (vii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 18.6.2015 për arë me sip. 2.188 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***; (viii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 18.6.2015, për arë me sip. 2.909 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***; (ix) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 18.6.2015, për arë me sip. 4.636 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 18.6.2015, për ullishte me sip. 2.268 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 18.6.2015 për ndërtesë me sip. 189 m², me nr. pasurie ***-Nd, z. k. ***; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 18.6.2015 për ndërtesë me sip. 60 m², me nr. pasurie ***-Nd, z. k. ***; dublikatë e AMTP-së nr. ***, datë 25.7.2005 për tokë në emër të familjes së z. Rr. H., gjithsej 25.760 m²; certifikatë familjare nr. ***, për gjendjen e datës 31.8.1991 me kryefamiljar z. H. H.; certifikatë familjare nr. ***, për gjendjen e datës 31.8.1991 me kryefamiljar z. Rr. H.; vërtetim datë 15.11.2016 i Bashkisë Mallakastër.

***, si dhe 35 rrënjë ullinj. Brenda kësaj sipërfaqeje janë mbjellë edhe 150 rrënjë ullinj dhe kthyer një sipërfaqe prej 1.500 m² në vresht. Kjo ka ndodhur në vazhdimësi të viteve. Pjesa takuese: subjekti Tritan Hamitaj ka 1/8 e kësaj prone (3 dynym për frymë). Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: ligji nr. 7501 “Për tokën”.

Arsyetimi ligjor

Bazuar në shkresën e ASHK-së Mallakastër rezulton se:

40.1 Subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar pasuri të paluajtshme tokë bujqësore¹¹, të përfutuar nga ligji nr. 7501, në bashkëpronësi me 1/6 pjesë takuese për pasuritë, si më poshtë:

- ullishte me sip. 395 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, Hekal, Mallakastër;
- tokë arë me sip. 5.024 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, Hekal, Mallakastër;
- tokë arë me sip. 4.305 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, Hekal, Mallakastër;
- tokë arë me sip. 2.188 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, Hekal, Mallakastër;
- tokë arë me sip. 2.909 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, Hekal, Mallakastër;
- tokë arë me sip. 4.636 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, Hekal, Mallakastër;
- ullishte me sip. 2.268 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, Hekal, Mallakastër;
- tokë arë me sip. 2546 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, Hekal, Mallakastër;
- tokë arë me sip. 1057 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, Hekal, Mallakastër;
- tokë arë me sip. 597 m², me nr. pasurie ***, z.k. ***, Hekal, Mallakastër është në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (segmenti Levan-Tepelenë).

Origjina e këtyre pasurive, sipas dokumentacionit të depozituar nga subjekti së bashku me deklaratën “Vetting”, është AMTP¹² nr. ***, datë 25.7.2005, në emër të familjes së z. Rr. H., gjithsej sip. 25.760 m² në Hekal, Mallakastër.

40.1.1 Gjatë hetimit për të njëjtën tokë bujqësore u administruan katër AMTP në katër versione të ndryshme, si vijon:

AMTP	Depozituar ¹³ nga subjekti së bashku me deklaratën <i>Vetting</i> . Në emër të Rr. H.	Depozituar nga subjekti në ILDKPKI ¹⁴ në vitin 2015. Subjekti në ILDKPKI ka deklaruar në lidhje me këtë pasuri, si vijon: “... është tokë e regjistruar në emrin e gjyshit tim H. H si kryefamiljar i tokës bujqësore...” ,po ju paraqes AMTP-në. Në emër të H. H.	Vënë në dispozicion nga Bashkia Mallakastër ¹⁵ Në emër të Rr. H.	Vënë në dispozicion nga ASHK-ja Mallakastër. Në dokumentacionin e ASHK-së Mallakastër është certifikata familjare me gjendjen në vitin 1991 të familjes së Rr. H.
Data	25.7.2005	6.4.1994	6.4.1996	Nuk ka datë në kokën e dokumentit, por ka një datë në fund 20.6.2008

¹¹ Subjekti në DVP/2003 deklaroi tokë bujqësore me sip. 3 dynym përfutuar nga ligji nr. 7501.

¹²Bazuar në certifikatë familjare nr. ***, për gjendjen e datës 31.8.1991 me kryefamiljar z. Rr.H, rezulton se subjekti ka qenë në përbërjen familjare të z. Rr. H..

¹³ AMTP-ja ka shënimin “dublikatë”.

¹⁴Shihni procesverbalin datë 22.4.2015, administruar me shkresë nr. *** prot., datë 25.2.2020, kthim-përgjigjeje ILDKPKI-ja.

¹⁵ Shihni kthim-përgjigje nr. ***, datë 19.3.2020, nga Bashkia Mallakastër.

Ndarjet	Çezma 6600 m ² Kurtaj 105 9000 m ² Plepi 247 4200 m ² Shengjone 190 3000 m ² Hamitaj 159 2660 m ² Trualli 190 300 m ²	190 300 m ² Çezma Tafaj 173 6600 m ² Kurtaj 105 9000 m ² Plepi 274 4200 m ² Shengjone 190 3000 m ² Hamitaj 159 2660 m ²	Çezma 173 6600 m ² Kurtaj 105 9000 m ² Plepi 247 4200 m ² Shengjone 190 3000 m ² Hamitaj 159 2660 m ² Trualli 190 300 m ²	Nr.190 300 m ² Ç. Tafaj 173 6600 m ² Kurtaj 105 9000 m ² Plepi 247 4200 m ² Kurtaj 105 2000 m ² Shengjone 190 3000 m ² Hamitaj 159 2660 m ²
Sipërfaqe totale	25760	25760	25760 m ²	27760 m²

Personat që kanë përfaqësuar Komisionin e Tokës janë të ndryshëm në 4 AMPT-të.

40.1.2 Në lidhje me versionet e ndryshme të AMTP-së, Komisioni i kërkoi informacion të detajuar:

i) Këshillit të Qarkut Fier, i cili sqaron:

“Në dokumentacionin e ndarjes së tokës, të përgatitur nga Komisioni i Tokës së fshatit Hekal Bashkia Ballsh, që disponohet në arkivin e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier, zyra Mallakastër ndodhet vetëm formulari nr. 6 dhe lista e gjendjes civile, të cilat janë të pa nënshkruara nga Komisioni i tokës së këtij fshati.”

Bazuar në formularin nr. 6, të vënë në dispozicion nga Këshilli i Qarkut Fier, si përfitues i tokës bujqësore rezulton z. H. Q.H. me të dhënat e tokës, si vijon:

- 190 300 m²;
- Ç. Tafaj 173 6600 m²;
- Kurtaj 105 9000 m²;
- Plepi 274 4200 m²;
- Shengjone 190 3000 m²;
- Hamitaj 159 38 m².

ii) Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ka sqaruar se: *“Në fshatin Hekal Mallakastër është ndarë nga 3 dynym tokë bujqësore/frymë dhe 5 rrënjë ullinj...”. Në datën 1.8.1991, gjyshi i tij H. H. jetonte së bashku me gjyshen në një certifikatë familjare, gjithsej dy veta dhe së bashku me prindërit e tij dhe vëllezërit në familje tjetër, gjithsej 6 veta. AMTP-ja është përfituar për të dyja familjet së bashku dhe ky është shkaku që në të është pasqyruar numri i personave prej 8 vetash. Si kryetar i familjes bujqësore në kohën e ndarjes së tokës është përcaktuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës z. H. H.. Pas vdekjes së gjyshit, në mungesë të AMTP-së, babai i tij Rr. H., i është drejtuar Komunës Hekal për të marrë kopje të saj. Nga Komuna i është dhënë një AMTP e cilësuar “dublikatë”, e cila nuk ka ndryshim në përmbajtje të parcelave dhe sipërfaqeve, por në “dublikatë” është pasqyruar si kryefamiljar z. Rr. H..*

40.1.3 Shpjegimet e dhëna nga subjekti u analizuan së bashku me dokumentacionin e administruar dhe, në përfundim, ka rezultuar se: (i) AMTP-ja për tokën bujqësore ka pasur si kryefamiljar z. H. H., provuar me shkresën e Këshillit të Qarkut Fier, si dhe me AMTP-në e depozituar nga subjekti në ILDKPKI; (ii) deklaratimet e subjektit në lidhje me AMTP-në (e cilësuar dublikatë), e cila është lëshuar në mungesë të AMTP-së origjinale nuk përputhen me provat e administruara, pasi subjekti dhe familja e tij kanë pasur kopje të AMTP-së origjinale, e cila është depozituar nga subjekti në ILDKPKI; (iii) AMTP-ja, për të njëjtën tokë bujqësore, është administruar në katër versione me përmbajtje të ndryshme; (iv) subjektit i përkasin 1/8

pjesë takuese tokë bujqësore dhe jo 1/6 pjesë takuese sikundër është konfirmuar nga ASHK-ja Mallakastër; (v) subjekti ka depozituar së bashku me deklaratën “Vetting” një AMTP që nuk ka qenë origjinale dhe nuk pasqyrore kryefamiljarin, në emër të të cilit është lëshuar ky dokument.

40.1.4 Në përfundim të kësaj analize, Komisioni ka ngritur dyshime se subjekti ka fshehur AMTP-në origjinale të lëshuar në emër të z. H. H., me qëllim justifikimin e pronësisë së kësaj pasurie në emër të familjarëve të tij, duke përjashtuar trashëgimtarët e tjerë të z. H. H dhe znj. L. H.. Për këto dyshime, subjektit iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

40.1.5 Në parashtrime, subjekti ka deklaruar se detyrimi i tij kushtetues dhe ligjor ka qenë të deklarojë saktë pasurinë në pronësinë e tij. Ky detyrim është realizuar me deklarin e tij se nga ligji nr. 7501 ka përfituar 1/8 e sipërfaqes prej 25.760 m², me kryefamiljar z. H. H.. Në funksion të deklaramit, subjekti sqaron se i ka paraqitur AMTP-të që ka pasur ai apo familja e tij në varësi të periudhës kohore duke u shprehur se: *“AMTP-ja e dorëzuar nga ana ime te ILDKPKI-ja në vitin 2015 nuk përbën dokument zyrtar, pasi nuk ka firma dhe vula të institucionit lëshues”*.

Subjekti vazhdon të sqarojë se AMTP-ja e dorëzuar në deklaratën *Vetting*, është marrë nga Komuna Hekal, e cila është dokument i rregullt shtetëror dhe nëse ka përputhshmëri ose jo me formularin 6 në lidhje me kryefamiljarin kjo nuk është përgjegjësia e tij as e familjarëve të tij, por e institucionit që lëshon dokumentin.

Regjistrimi i bashkëpronarëve të tokës bujqësore në 1/6 dhe jo në 1/8 nga ASHK-ja Mallakastër është përgjegjësi e saj, në mënyrën si e kupton dhe zbaton ligjin. Një regjistrim i tillë nuk mund të ngarkojë atë me përgjegjësi, kur nuk ka kryer asnjë ndikim formal dhe joformal pranë këtij institucioni.

Ndërkohë në parashtrimet e paraqitura në seancë dëgjimore subjekti deklaroi se: *“...pjesa e hallave, e cila dyshohet se është përfituar nga familja ime është në vlerën 492.000 lekë ose 4.000 euro”*. Halla e tij, Xh., jeton në SHBA, ka tokë bujqësore në Levan, tokë të cilën e punon fqinji i saj pa shpërblim. Nga ana tjetër, halla e ndjera D., ka përfituar tokë në Tepelenë, tokë e cila nuk punohet prej fëmijëve të saj.

40.1.6 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se janë kontradiktore dhe nuk janë bindëse. Nga hetimi ka rezultuar se AMTP-ja është lëshuar në emër të kryefamiljarit z. H. H., fakt i cili nuk është pasqyruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”. Nga subjekti nuk rezulton të jetë depozituar së bashku me deklaratën “Vetting”, e njëjta AMTP, sikundër është depozituar në vitin 2015 në ILDKPKI. Shpjegimet e tij, në seancë dëgjimore, se hallat apo fëmijët e hallave janë në gjendje të mirë ekonomike dhe se nuk punojnë tokat bujqësore që kanë përfituar, nuk justifikojnë faktin që ato janë përjashtuar nga përfitimi i tokës bujqësore së babait/gjyshit të tyre.

40.1.7 Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” përfitimin e tokës bujqësore në pronësi të tij, si dhe nuk ka depozituar dokumentin e saktë (AMTP-në lëshuar në emër të gjyshit të tij) të përfitimit të kësaj pasurie së bashku me deklaratën “Vetting”. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarin të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “a” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

40.2 Babai i subjektit ka në pronësi, në cilësinë e individit, pasuritë e mëposhtme:

- ndërtesë me sip. 189 m², me nr. pasurie ***-Nd, z.k. ***, Hekal, Mallakastër;
- ndërtesë me sip. 60 m², me nr. pasurie ***-Nd, z.k. ***, Hekal, Mallakastër.

40.2.1 Origjina e këtyre dy pasurive është kontrata e dhurimit nr. ***, datë 16.9.1996, nëpërmjet së cilës z. H. H. (gjyshi i subjektit) i dhuron babait të subjektit një objekt me përmasa $9 \times 21 + 189 \text{ m}^2$, që përbëhet nga 4 dhoma dhe një ndërtesë me përmasa $10 \times 6 = 60 \text{ m}^2$, që përbëhet nga 4 dhoma. Në kontratë thuhet se këto pasuri janë të rrethuara nga toka e tij (e z. H. H.).

Z. H. H., pasuritë e mësipërme i ka blerë nga Komanda e Repartit Ushtarak Fier, me kontratë shitjeje nr. ***, datë 26.12.1994. Komisioni konstaton se në notën e transkriptit nr. ***, datë 10.1.1995, por edhe në kontratën e shitjes përcaktohet se të dyja këto ndërtesa kufizohen me tokën e z. H. H..

40.2.2 Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar se ndërtesat e mësipërme janë në bashkëpronësi, por nga dokumentacioni rezulton se janë vetëm të babait të tij. Gjatë hetimit ai ka sqaruar se ka qenë një lapsus i tij në plotësimin e deklaratës, duke u ndikuar nga fakti se certifikatat ishin bashkë me ato të tokës bujqësore. Komisioni konstaton se, pavarësisht se shpjegimet e subjektit janë bindëse, mbetet fakt që subjekti nuk ka qenë i saktë në plotësimin e deklaratës “Vetting”, pasi ka deklaruar pasuri që nuk janë në emër të tij.

40.3 Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se në tokën bujqësore janë mbjellë 150 rrënjë ullinj dhe kthyer në vresht një sipërfaqe prej 1.500 m^2 . Në lidhje me këtë deklaram, Komisioni i ka kërkuar subjektit informacion të detajuar. Nga ana e tij, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, është deklaruar se nuk mban mend sa ka qenë vlera e shpenzimeve për mbjelljen e ullinjve¹⁶ dhe të vreshtit dhe se nuk disponon dokumentacion. Kjo përgjigje e subjektit nuk është e plotë, pasi, pavarësisht faktit nëse subjekti nuk dispononte dokumentacion, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 ka pasur detyrimin për të deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” dhe gjatë hetimit, vlerën e pasurive dhe burimin e tyre duke mbartur detyrimin për të deklaruar vlerën e shpenzimeve për mbjelljen e 150 rrënjëve ullinj dhe të vreshtit, si dhe kohën e kryerjes së këtyre shpenzimeve. Mosdhënia e një përgjigjeje të saktë prej tij ndikon në kryerjen e analizës financiare të subjektit.

40.3.1 Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës: (i) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe gjatë hetimit shpenzimet për mbjelljen e ullinjve dhe vreshtit; (ii) subjekti nuk ka qenë bashkëpunues me Komisionin, pasi nuk ka dhënë përgjigje në lidhje me shpenzimet e kryera për mbjelljen e ullinjve dhe të vreshtit.

40.3.2 Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se Kushtetuta, si subjekt rivlerësimi, e ka ngarkuar me detyrim të deklarojë pasurinë dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave, dhe jo të shpenzimeve. Edhe ligjet nr. 84/2016, datë 30.8.2016 dhe nr. 9049, datë 10.4.2003, të dala në zbatim të Kushtetutës për interpretimin e fjalës pasuri, nuk përcaktojnë se shpenzimet janë pasuri dhe e ardhur. Detyrimi i tij ligjor në zbatim të nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, është deklarimi i pasurisë sipas specifikimit të bërë në formularin e deklaratës “Vetting”, në të cilin referohet te pika 11, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, nen i cili referon te ligji nr. 9049, datë 10.4.2003. Në këtë deklaratë dhe në këto ligje nuk pasqyrohet detyrimi i tij ligjor të deklarojë shpenzimet, në ndryshim nga deklarimi vjetor para ILDKPKI-së që është një detyrim i tillë. Evidentimi i shpenzimeve është një e drejtë e Komisionit nëpërmjet hetimit administrativ, të cilën mund ta shfrytëzojë, por jo të ngarkojë subjektin me barrë prove. Në këto kushte, barra e provës e lënë prej Komisionit, për të deklaruar shpenzimet e mbjelljes së vreshtit dhe ullinjve, vjen në kundërshtim me nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjeve në zbatim të këtij neni. Subjekti, me tej, deklaroi se është në pamundësi të dhënies së një përgjigjeje për këto shpenzime, pasi janë realizuar në një kohë që ai nuk ishte subjekt, që të duhet të deklaronte këto shpenzime në bazë të ligjit të kohës, as edhe familja e tij. Nga ana tjetër ka kaluar një kohë shumë e gjatë dhe as me memorie nuk është në gjendje të mbajë mend

¹⁶ Sipas deklarimeve të subjektit 80 rrënjë ullinj janë mbjellë në fillim vitit 1995 dhe vreshti është mbjellë në vitin 2000.

se sa kanë qenë këto shpenzime. Nga ana e tij është kryer një aktekspertimi agronomik nëpërmjet ekspertës R. M., e cila ka nxjerrë të ardhurat nga toka, vreshti dhe ullinjët, shpenzimet e nevojshme për krijimin e vreshtit dhe të ullinjve dhe shpenzimet vjetore, si dhe rezultatin e fitimit *neto* për çdo vit.

40.3.3 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentin “vlerësim i të ardhurave nga pasuria tokë arë dhe ullishte në pronësi të z. Rr. H.”, të përgatitur nga agronomi i përgjithshëm, znj. R. M., vlerëson se subjekti nuk ka qenë i saktë përgjatë hetimit administrativ, por edhe në deklaratën “Vetting”, pasi nuk ka deklaruar vlerën e investimit/shpenzimeve të kryera për mbjelljen e 150 rrënjëve ullinj dhe kthimin e 1500 m² sipërfaqeje në vresht, në zbatim të neneve 30-32, të Aneksit D të Kushtetutës, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, ku në seksionin deklarimi i pasurive në pjesën “përshkruani hollësisht ...” parashikohet deklarimi i shumës së shpenzimeve në mungesë të dokumenteve.

Subjektit, gjatë hetimit administrativ, i është kërkuar të plotësojë këtë pasaktësi të bërë në deklaratën “Vetting”, por ka vijuar të mos deklarojë vlerën e shpenzimeve për transformimin e pasurisë së tij të paluajtshme në vresht, si dhe për investimin në këtë pasuri, pasi ka mbjellë 150 rrënjë ullinj. Në lidhje me dokumentin “vlerësim i të ardhurave nga pasuria tokë arë dhe ullishte në pronësi të z. Rr. H.” të depozituar nga subjekti, Komisioni vlerëson se të dhënat e prezantuara në këtë akt nuk provojnë vlerën e shpenzimeve të kryera, në funksion të detyrimit që ka subjekti i rivlerësimit në këtë proces, për të provuar me dokumentacion vlerën e krijimit të pasurisë së tij.

40.3.4 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me vreshtin dhe mbjelljen e 150 rrënjëve ullinj, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germa “a” e nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni çmon se sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, nuk ka qenë bashkëpunuese, pasi nuk ka deklaruar vlerën e saktë të shpenzimeve për mbjelljen e ullinjve dhe të vreshtit, duke vështirësuar punën e organeve në kryerjen e procesit të rivlerësimit, pasi nga Komisioni është e pamundur të bëhet një analizë financiare e saktë në lidhje me këtë pasuri. Gjithashtu, Komisioni çmon se kjo sjellje duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe të mbahet në vëmendje të Komisionit, në përputhje me nenin 48 të po këtij ligji.

40.4 Subjekti, në deklaratën “Vetting”, ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore në shumën 2.140.000 lekë për periudhën 2005 – 2016 dhe i është kërkuar të vërë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për shumën e përfituar prej tij nga përdorimi i tokës bujqësore, ku të dalë qartë edhe pagimi i detyrimeve tatimore. Në përgjigje të pyetësorit nr.1, nga subjekti është deklaruar se shuma e përfituar nga të ardhurat e tokës bujqësore, vreshtit dhe ullinjve nuk është e dokumentuar. Për këto të ardhura nuk ka dokumentacion tatimor, pasi veprimtaria është ushtruar si fermer.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi janë thjesht deklarative të pashoqëruar me dokumentacion për të provuar shitjen e produkteve bujqësore të prodhuara, sasinë e tyre, mënyrën e shitjes, si dhe shumën e përfituar nga shitja e tyre.

40.4.1 Për sa më sipër, subjektit iu kalua barra e provës: (i) subjekti nuk ka vendosur në dispozicion të Komisionit asnjë dokumentacion për të vërtetuar të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore; (ii) subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues për pagimin e taksave/tatimeve përkatëse sipas legjislacionit në fuqi për shfrytëzimin e tokës bujqësore, për rrjedhojë këto të ardhura nuk do të merren në konsideratë në analizën financiare.

40.4.2 Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi se për përdoruesit e tokës bujqësore si fermerë, për nevojat e tyre familjare, rezulton se nuk klasifikohen si tregtarë, nuk janë subjekte të ligjit për

procedurat tatimore dhe nuk paguajnë tatim mbi të ardhurat sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Referuar legjislacionit në fuqi, duke filluar nga viti 1994 e deri më sot, objekt taksimi është vetëm sipërfaqja e tokës që zotëron dhe jo të ardhurat që gjeneron toka bujqësore. Subjekti ka parashtruar se veprimtaria e shfrytëzimit të tokës bujqësore, ullinjve dhe vreshtit është drejtuar nga babai i tij Rr. H. dhe nuk ka pasur asnjëherë natyrë si veprimtari ekonomike për të nxjerrë fitim.

40.4.3 Subjekti, së bashku me prapësimet, ka depozituar dokumentin “vlerësim i të ardhurave nga pasuria tokë arë dhe ullishte në pronësi të z. Rr. H.”, të përgatitur nga agronomi i përgjithshëm, znj. R. M.. Në lidhje me këtë dokument, Komisioni vlerëson se të dhënat e prezantuara, nuk provojnë dhe as kuantifikojnë të ardhurat nga përdorimi i kësaj pasurie, në funksion të detyrimit që ka subjekti i rivlerësimit në këtë proces, për të provuar me dokumentacion burimet e krijimit të pasurisë së tij. Subjekti, në parashtrimet e tij, ka deklaruar se të ardhurat nga toka nuk janë të sakta dhe se veprimtaria e shfrytëzimit të tokës bujqësore, ullinjve dhe vreshtit është drejtuar nga babai i tij Rr. H. dhe nuk ka pasur asnjëherë natyrë si veprimtari ekonomike për të nxjerrë fitim. Madje në seancë, subjekti ka pretenduar se edhe sot, e gjithë sipërfaqja e tokës prej 25.000 m² punohet dhe administrohet vetëm nga prindërit e tij, 74 dhe 75-vjeçarë.

40.4.5 Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka qenë i saktë në deklaratën “Vetting” në lidhje me deklarimin e burimit të shumës 2.140.000 lekë, si shumë e përfutur nga toka bujqësore, pasi, siç deklaroi edhe subjekti, shfrytëzimi i tokës bujqësore nuk ka pasur asnjëherë natyrë si veprimtari ekonomike për të nxjerrë fitim. Nga subjekti nuk është provuar që toka bujqësore të ketë prodhuar produkte, që më pas të jenë shitur, duke krijuar të ardhura monetare, për t’u përdorur si burim për pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme, për rrjedhojë këto të ardhura nuk do të përfshihen në analizë financiare. Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, kontradiktor, të paplotë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “a” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

40.5 Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me pasurinë tokë bujqësore, pasi shqyrtoi dhe vlerësoi provat dhe shpjegimet e paraqitura, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e deklarimit të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “a”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016 pasi:

i) Nuk provoi me dokumentacion provues të ardhurat e përfutura nga toka bujqësore në shumën 2.140.000 lekë.

ii) Nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, por dhe gjatë hetimit administrativ vlerën e saktë të shpenzimeve/investimit të kryer për mbjelljen e 150 rrënjëve ullinj dhe për transformimin e një sipërfaqeje prej 1500 m² të pasurisë së tij të paluajtshme, tokë arë në vresht.

iii) Nuk ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” përfitimin e tokës bujqësore në pronësi të tij, si dhe nuk ka depozituar dokumentin e saktë (AMTP-ja lëshuar në emër të gjyshit të tij) të përfitimit të kësaj pasurie së bashku me deklaratën “Vetting”.

41. Apartament¹⁷ 2+1 me sip. 86.18 m², nr. pasurie *, z.k. *** me adresë: rr. “****”, lagjja nr. ***, p. ***, k. ***, Durrës. Vlera: 1.500.000 lekë. Koha e përfitimit datë 27.1.2002. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të ardhura të ndodhura në ProCredit Bank (FEFAD) nga paga si gjyqtar për periudhën 19.11.1999 – 27.1.2002, paga si ndihmësgjyqtar për periudhën 22.8.1996**

¹⁷ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 17.1.2002; deklaratë personale e datës 21.1.2017, greqisht dhe shqip; shkresë nr. ***, datë 27.12.2016, e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

– 19.11.1999, puna si emigrant në Greqi, të ardhura nga toka bujqësore, të ardhura të tjera familjare të asaj kohe. Pjesa takuese: 100 %.

Konstatimi i ILDKPKI-së:

- Lidhur me të ardhurat nga emigracioni, subjekti ka paraqitur deklaratë personale të punëdhënësit grek për punë të përegjistruar nga ana e tij. Nuk është deklaruar nga subjekti dhe as nga punëdhënësi, shuma totale e të ardhurave të përfituara dhe dokumentacion justifikues me terma financiare. Emigracioni në vitet 1991, 1992 dhe 1995 është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratën e dekriminalizimit, ndërsa në vitet 1996 – 2001 ka dokumentuar të ardhura nga paga në shumën rreth 1.660.000 lekë.
- Dyshime lidhur me çmimin 1.500.000 lekë të blerjes së apartamentit, me sip. 86.18 m², në Durrës, në vitin 2002. Në deklaratën e interesave private “para fillimit të detyrës në vitin 2003” apartamenti është deklaruar në vlerën 3.500.000 lekë. Në këtë deklaratë edhe tokës së përfituar nga ligji nr. 7501 i është vënë vlerë. Në vlerësimin e pasurisë *Vetting* dhe në krahasimin me pasurinë “para fillimit të detyrës në vitin 2003”, do të llogaritet me vlerën sipas kontratës së shitblerjes.

Arsyetimi ligjor

41.1 Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 17.1.2002, subjekti ka blerë apartamentin me sip. 86.18 m², nr. pasurie ***, z.k. ***, në adresën: rr. “****”, lagjja ***, Durrës, kundrejt çmimit 1.500.000 lekë. Komisioni ka konstatuar se në DVP/2003, subjekti e ka deklaruar vlerën e këtij apartamenti 3.500.000 lekë dhe ka sqaruar këtë mospërputhje midis çmimit në kontratë dhe çmimit të deklaruar në DVP/2003. Në lidhje me këtë deklaram, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr.1, sqaron se në momentin që e ka plotësuar vlerën 3.500.000 lekë, duke menduar se kjo banesë kishte këtë vlerë në atë moment. Mbetet fakt se ka një mospërputhje midis deklarameve të tij në DVP/2003 dhe në deklaratën “*Vetting*”.

41.2 Në deklaratën “*Vetting*” si burim për blerjen e këtij apartamenti subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura të ndodhura në ProCredit Bank (FEFAD) nga paga si gjyqtar datë 19.11.1999 – 27.1.2002, paga si ndihmës gjyqtar datë 22.8.1996 – 19.11.1999, puna si emigrant në Greqi, të ardhura nga toka bujqësore, të ardhura të tjera familjare të asaj kohe*”.

Ndërkohë në DVP/2003 ka deklaruar si burim: “... të ardhurat nga puna si refugjat, trashëgimi dhe firmat piramidale.”

41.2.1 Në lidhje me këtë mospërputhje, subjekti ka sqaruar se në deklaramin e parë të pasurisë për vitin 2003 ka deklaruar vetëm ato burime të ardhurash personale, të cilat nuk kanë qenë të një natyre të veçantë, për të cilat nuk kishte një dokumentacion zyrtar. Në deklaratën “*Vetting*” subjekti pretendon se ka deklaruar të gjitha burimet e mundshme që kanë krijuar të ardhura deri në momentin e blerjes. Subjekti pretendon se ka deklaruar aq burime sa ka mbajtur mend, pasi lista e burimeve nuk mund të jetë shteruese për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.

41.2.2 Bazuar në Aneksin D të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë si dhe në nenet 30-32 të ligjit nr. 84/2016 subjekti ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar saktë pasurinë dhe për të paraqitur dokumente që vërtetojnë vërtetësinë e deklarameve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Për sa më sipër, subjektit iu kalua barra e provës për mospërputhjet midis deklarameve në deklaratën “*Vetting*” dhe deklarameve në DVP/2003 në lidhje me burimin e ligjshëm të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti.

41.2.3 Në parashtrimet e tij, subjekti pranon se ka mospërputhje midis këtyre dy deklarameve në lidhje me burimin e kësaj pasurie, por pretendon se detyrimi i tij ligjor është të deklarojë saktë burimin e pasurisë në deklaratën “*Vetting*”, detyrim të cilin e ka realizuar me korrektësi.

41.2.4 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se nuk janë bindëse, pasi, në deklaratën “Vetting” subjekti ka përfshirë burime të tjera, të cilat nuk rezultojnë të cituara prej tij në DVP/2003, deklaratë e cila është plotësuar vetëm një vit nga blerja e apartamentit. Në këtë këndvështrim, Komisioni çmon se mospërputhja në deklaratimet e subjektit për sa i përket burimeve, duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

41.3 Subjektit¹⁸ i është kërkuar të vërë në dispozicion të Komisionit:

a. Dokumentacion provues për të ardhurat nga firmat piramidale

a.1 Subjekti ka deklaruar se nuk mban mend sa janë të ardhurat nga firmat piramidale, si dhe nuk ka dokumentacion justifikues.

a.2 Për sa kohë subjekti nuk ka deklaruar vlerën e të ardhurave nga firmat piramidale në deklaratën “Vetting”, por dhe gjatë hetimit, si dhe nuk i ka provuar me dokumentacion provues, këto të ardhura nuk do të përfshihen në analizë financiare. Për këtë, subjektit iu kalua barra e provës.

a.3 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti sqaroi se ende nuk ka siguruar të dhëna dokumentare për krijimin e këtyre të ardhurave. Kjo ka ndodhur për shkak se ka kaluar një kohë e gjatë nga krijimi i këtyre të ardhurave dhe nuk është vlerësuar nga ana e tij se një dokument i tillë do t’i duhej pas 23 vjetësh.

Komisioni vlerëson se për sa kohë subjekti nuk i ka deklaruar këto të ardhura në deklaratën “Vetting” dhe nuk provoi me dokumentacion provues këto të ardhura ato nuk do të përfshihen në analizë financiare.

b. Dokumentacion provues¹⁹ për të ardhurat e tjera familjare të deklaruar nga ana e tij si burim për blerjen e kësaj shtëpie

b.1 deklaratën “Vetting” subjekti nuk i ka deklaruar të ardhurat e prindërve të tij, si dhe sa ka qenë shuma e të ardhurave të dhënë nga ana e tyre për blerjen e apartamentit, gjithashtu nuk rezulton që në DVP/2003 subjekti të ketë deklaruar si burim këto të ardhura. Nga verifikimi i deklaratimeve të subjektit në DVP/2003, por edhe në vijim konstatohet se nuk ka deklaruar se ka në përbërjen e tij familjare prindërit, si dhe të ketë deklaruar të ardhurat e tyre. Rrjedhimisht, nuk provohet se të ardhurat e prindërve të subjektit kanë shërbyer si burim për blerjen e këtij apartamenti. Për këtë arsye, këto të ardhura nuk u përfshinë në analizën financiare.

b.2 Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, sqaroi se në deklaratën “Vetting”, si burim krijimi të apartamentit, ka deklaruar edhe “të ardhura të tjera familjare të asaj kohe” dhe me këtë burim të deklaruar përfshihen edhe të ardhurat e krijuara nga prindërit para datës së blerjes së apartamentit. Për shumën e të ardhurave të krijuara nga prindërit, është i vërtetë fakti se në deklaratën “Vetting” nuk ka dorëzuar dokumentacion, por kjo gjë është plotësuar gjatë hetimit administrativ, ku subjekti ka paraqitur të ardhurat nga paga të prindërve dhe njëkohësisht pretendimin se ata kanë nxjerrë të ardhura edhe nga toka bujqësore. Në DVP/2003 e në vazhdim nuk ka deklaruar të ardhurat nga prindërit, pasi në vitin 2003 e në vazhdim subjekti nuk ka qenë në një certifikatë familjare me prindërit dhe ka jetuar së bashku me ta deri më 6.5.2002 dhe ka qenë së bashku në trung familjar me prindërit deri në këtë datë. Duke qenë në një familje

¹⁸ Shihni pyetësor nr. 1.

¹⁹ Nga subjekti është vënë në dispozicion: (i) përgjigje e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Drejtoria Rajonale Fier nr. *** prot., datë 10.5.2018 drejtuar znj. Gj. H.; (ii) përgjigje e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Drejtoria Rajonale Fier nr. *** prot., datë 26.4.2018, drejtuar znj. Gj. H.; (iii) përgjigje e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Drejtoria Rajonale Fier nr. *** prot., datë 10.5.2018, drejtuar z. Rr. H.; (iv) përgjigje e Institutit të Sigurimeve Shoqërore Drejtoria Rajonale Fier nr. *** prot., datë 25.4.2018, drejtuar z. Rr. H..

dhe në një certifikatë trangu, subjekti kërkoi që prindërit të vlerësohen si persona të lidhur për shkak të përbërjes familjare deri më 6.5.2002 dhe çdo e ardhur e krijuar deri në këtë datë prej tij dhe familja e tij, duhet të llogaritet si burim i pasurisë së krijuar prej tij.

b.3 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se nuk përputhen me deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ, ku në përgjigje të pyetësorit të datës 3.4.2020, në pikën 28/c ka deklaruar se duke filluar nga maji i vitit 1998 nuk ka jetuar me prindërit e tij. Gjithashtu, subjekti në deklaratën “Vetting” nuk ka përcaktuar sa ka qenë shuma e dhënë nga prindërit e përdorur prej tij për blerjen e apartamentit. Nga subjekti, në deklaratën “Vetting”, te seksioni “angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhura të krijuara prej tyre” nuk rezulton të jenë deklaruar të ardhurat nga prindërit e tij. Këto të ardhura nuk rezulton të jenë deklaruar si burim nga subjekti as në DVP/2003.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se të ardhurat e prindërve të subjektit nuk do të përfshihen në analizë financiare.

Në lidhje me mospërputhjet në deklaratime të subjektit për sa i përket jetesës me prindërit, Komisioni vlerëson se kjo mospërputhje duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

c. Dokumentacion provues për të ardhurat nga trashëgimia

c.1 Nga subjekti është sqaruar se kanë qenë pasuri të luajtshme, kursime, sende me vlerë, etj., që ka lënë gjyshja pas vdekjes në vitin 1992. Gjyshja e tij ka pasur vëllanë, z. R. V., me vendbanim në SHBA, i cili është arratisur pas vitit 1945 nga Shqipëria dhe gjatë viteve të diktaturës i ka dërguar dollarë nëpërmjet rrugëve zyrtare, të cilët janë këmbyer në lekë në momentin e mbërritjes.

Për momentin nuk ka dokumentacion. Ka përdorur termin trashëgimi, pasi kanë hyrë në familjen që jetonte (trashëgimtar babai i tij).

c.2 Shpjegimet e subjektit janë deklarative, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues për të provuar deklaratimet e tij, për më tepër nuk ka deklaruar sa ka qenë shuma e përfutur prej tij. Në deklaratën “Vetting” nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar si burim apo si të ardhura, të ardhurat nga trashëgimia e gjyshes. Për më tepër, për sa kohë ato janë të babait të tij, nuk mund të konsiderohen si të ardhura nga trashëgimia, si dhe nuk mund të jenë të ardhura të subjektit, sepse në DVP/2003 nuk ka deklaruar se ka në përbërjen e tij familjare prindërit e tij, si dhe të ketë deklaruar këto të ardhura. Për këtë arsye, këto të ardhura nuk do të përfshihen në analizë financiare, deri sa të provohet e kundërta.

c.3 Në lidhje me këtë rezultat, subjekti prapësoi se të ardhurat nga trashëgimia nuk janë të specifikuar si burim më vete në deklaratën “Vetting”, por kjo nuk do të thotë se ky burim nuk është deklaruar. Në deklaratën “Vetting” subjekti është shprehur për njërin nga burimet: “*të ardhura të tjera familjare të asaj kohe*”, burim i cili përfshin edhe të ardhurat e lëna nga gjyshja L. H. pas vdekjes. Babai i tij është trashëgimtar i saj i radhës së parë dhe ka përfutur nga këto të ardhura dhe, për këtë shkak, është shprehur duke i klasifikuar këto si të ardhura të tjera familjare. Në lidhje me mungesën e dokumentacionit për këto të ardhura, është një konstatim i drejtë, parashtron subjekti, pasi ende nuk ka siguruar të dhëna dokumentare për krijimin e këtyre të ardhurave. Dokumenti i dërgimit të dollarëve nga z. R. V. për znj. L. H. është i vitit 1990 e më përpara. Një dokumentacion i tillë nuk gjendet në arkivat shtetërore për kohën e gjatë që ka kaluar, afërsisht 30 vjet e më shumë.

c.4 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se nuk janë bindëse dhe nga subjekti nuk rezulton që të jenë deklaruar në deklaratën “Vetting” të ardhurat e lëna trashëgim nga gjyshja e tij, si dhe nuk është depozituar dokumentacion provues për këto të ardhura. Nga subjekti nuk është deklaruar as sa ka qenë shuma e përfutur nga znj. L. H. dhe sa nga kjo

shumë i është dhënë subjektit për ta përdorur për blerjen e këtij apartamenti. Për sa më sipër, Komisioni nuk do të përfshijë në analizë financiare këto të ardhura.

d. Dokumentacion provues për të ardhurat nga emigracioni

d.1 Në lidhje me këto të ardhura, subjekti ka sqaruar se shuma totale e përfituar është 1.950.000 dhrahmi minimumi dhe 2.340.000 dhrahmi maksimumi. Përveç deklaratimit të z. H. K., punëdhënësit të tij në Greqi, të bërë përpara policisë vendore Thivë, të cilin e ka dorëzuar së bashku me deklaratën “Vetting” nuk ka dokumentacion tjetër. Subjekti sqaron se ka punuar në Platea, Thiva Greqi dhe se ka punuar në periudhat qershor-tetor 1991, korrik-shtator 1992 dhe korrik-shtator 1995.

d.2 Për të provuar të ardhurat nga emigracioni, subjekti ka vënë në dispozicion deklaratë personale të datës 21.1.2017, greqisht dhe shqip, sipas së cilës shtetasi grek H. K. deklaroi se z. Tritan Hamitaj, gjatë kohës së verës për vitet 1991, 1992 dhe 1995 ka punuar në arat e tij dhe pagesa ishte 5.000 – 6.000 dhrahmi, pa marrëveshje. Ka banuar në shtëpinë e prindërve të tij, së bashku me vëllezërit.

d.3 Komisioni vlerëson se deklarata e depozituar nga subjekti nuk përbën provë në kuptim të Aneksit D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 84/2016 dhe të praktikës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pasi në të nuk pasqyrohet asnjë e dhënë për kohën e punës, pagesat e përfituara çdo vit, si dhe për pagimin e detyrimeve tatimore. Për pasojë, të ardhurat e deklaruara nga emigracioni nuk u përfshinë në analizën financiare, duke i kaluar subjektit barrën e provës.

d.4 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se në deklaratën e datës 21.1.2017, të z. H. K. është pasqyruar saktë periudha që ka punuar, e cila ka qenë vera e vitit 1991, 1992 dhe 1995 dhe vlera e pagesës për ditë punë prej 5.000 deri në 6.000 dhrahmi. Në këtë deklaratë, subjekti sqaron më tej se janë të dhënat e kohës së punës, vlera e pagesës dhe konstatimi i Komisionit se këto mungojnë, nuk qëndron. Për të provuar besueshmërinë e deklaratës, subjekti ka vënë në dispozicion:

- përgjigjen e Konsullatës së Përgjithshme të Greqisë në Gjirokastrë e datës 23.6.2020 e ardhur me e-mail, sipas së cilës subjekti është pajisur me vizë greke në datën 13.6.1995, shoqëruar me dokument;
- fotografinë e bërë në banesën e prindërve të tij në datën 19.1.1992, ku ka dalë z. H. K. me familjen e tij;
- fotografinë e bërë në banesën e tij në Platea, Greqi, datë 21.1.2017, në të cilën ka dalë z. H. K. së bashku me subjektin.

d.5 Komisioni vlerëson se në lidhje me të ardhurat nga emigracioni, nga subjekti nuk është depozituar asnjë dokumentacion provues në kuptim të ligjit nr. 84/2016, si dhe praktikës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për të provuar të ardhurat e pretenduara prej tij. Për më tepër, nuk rezulton që në deklaratën “Vetting” subjekti të ketë deklaruar se sa ka qenë shuma konkrete e të ardhurave të përfituara prej tij në emigracion.

Për sa më sipër, Komisioni nuk do të përfshijë në analizë financiare të ardhurat e subjektit të pretenduar si të përfituara nga emigracioni.

41.4 Subjektit i është kërkuar të informojë mbi burimin për depozitat bankare në ProCredit/FEFAD Bank gjatë viteve 2000 dhe 2001. Në përgjigjen e tij, në pyetësin nr.1, subjekti ka sqaruar se burimi i depozitës bankare janë të ardhurat e tij dhe të familjes, para depozitimit në bankë, konkretisht: (i) paga si ndihmësgjyqtar dhe gjyqtar; (ii) të ardhurat nga emigracioni në Greqi; (iii) paga e marrë nga nëna e tij në Komunën Hekal Mallkastër nga viti 1991 e në vazhdim; (iv) paga e babait të tij në Komunën Hekal Mallkastër, që nga viti 1991;

(v) të ardhurat nga toka bujqësore në Hekal Mallkastër të familjes së tij; (vi) të ardhura nga toka bujqësore e gjyshes së tij, L. H., pas vdekjes, si dhe të ardhura të tjera që babai i tij ka përfituar pas vdekjes së saj; dhe (vii) të ardhura nga interesi i depozitave.

41.4.1 Deklarimet e subjektit, në lidhje me burimin e depozitave bankare, nuk janë të sakta, pasi referuar deklaratën “Vetting” nuk i ka deklaruar si të ardhura pagat e familjarëve, si dhe nuk ka provuar me dokumentacion provues të ardhurat nga emigracioni dhe tokat bujqësore. Për pasojë, në analizë financiare nuk do të përfshihen të ardhurat nga emigracioni, nga toka bujqësore e tij dhe e gjyshes së tij, si dhe nga familjarët e subjektit.

41.4.2 Nga Komisioni është evidentuar gjendja e likuiditeteve të subjektit deri në vitin 2001, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Gjendja e likuiditeteve	2000	2001
ProCredit Bank depozita në lekë	1,839,386	2,198,181
ProCredit Bank depozita në dollarë amerikanë	\$3,930	\$12,179
ProCredit Bank depozita në euro		€ 1,627
Totali në lekë²⁰	2,399,917	4,065,750

Komisioni, mbështetur në gjendjen e likuiditeteve më sipër, ka kryer një analizë financiare mbi mundësinë e subjektit për të krijuar këto likuiditete, sipas së cilës ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e depozitave bankare gjatë viteve 2000 dhe 2001. Për këtë, subjektit iu kalua barra e provës.

	deri 2000	2000	2001
PASURI	0	2 799 917	1 665 833
Automjet tip “Volkswagen Golf”, me targa ***		400 000	
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>		2 399 917	1 665 833
Likuiditete gjendje		2 399 917	4 065 750
Të ardhura të dokumentuara	870 035	421 320	612 974
Të ardhura nga paga e subjektit	870 035	421 320	457 780
Të ardhura nga interesa bankare		.	155 194
SHPENZIME	200 000	108 000	108 000
Shpenzime jetese	200 000	108 000	108 000
Mundësia për kursime kumulative	670 035	-1 816 562	-2 977 421

41.4.3 Pas kalimit të barrës së provës subjekti prapësoi se ka jetuar së bashku me prindërit deri në datën 6.5.2002 dhe ka qenë së bashku me ta në trung familjar deri në këtë datë. Duke qenë në një familje dhe në një certifikatë trangu, prindërit vlerësohen si persona të lidhur për shkak të përbërjes familjare deri më 6.5.2002 dhe çdo e ardhur e krijuar deri në këtë datë prej tij dhe familja e tij duhet të llogaritet si burim i pasurisë së krijuar prej tij. Mungesa e pasqyrimit të burimit të këtyre llogarive në deklaratën “Vetting” ka ardhur për shkak të metodologjisë së

²⁰ Kurset e këmbimit, sipas Bankës së Shqipërisë në datën 31 dhjetor të vitit përkatës:

31.12.2000, kursi 1 USD=142.64 lekë; 31.12.2001, kursi 1 USD=142.64 lekë dhe 1 euro = 122,01lekë; 31.12.2002, kursi 1 USD=134.97 lekë; 31.12.2003, kursi 1 USD=108.69 lekë.

përdorur prej tij në plotësimin e saj dhe se si e ka kuptuar detyrimin ligjor për të plotësuar burimin e pasurisë.

41.4.4 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se nuk përputhen me deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ, ku në përgjigje të pyetësorit të datës 3.4.2020, në pikën 28/c ka deklaruar se duke filluar nga maji i vitit 1998 nuk ka jetuar me prindërit. Gjithashtu, subjekti, në deklaratën “Vetting” nuk ka përcaktuar sa ka qenë shuma e dhënë nga prindërit, e përdorur prej tij për blerjen e apartamentit apo për krijimin e depozitave. Nga subjekti, në deklaratën “Vetting” te seksioni “angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhura të krijuara prej tyre” nuk rezulton të jenë deklaruar të ardhurat nga prindërit e tij. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se të ardhurat e prindërve të subjektit nuk do të përfshihen në analizë financiare. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 2.977.421 lekë për krijimin e depozitave në vitet 2000-2001, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit.

41.5 Subjekti është pyetur në lidhje me vlerën e mobilimit të këtij apartamenti, duke specifikuar shpenzimet përkatëse për çdo vit. Nga ana e tij nuk është kthyer përgjigje. Subjekti nuk ka qenë bashkëpunues me Komisionin, bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka dhënë përgjigje në lidhje me vlerën e mobilimit të apartamentit, duke krijuar vështirësi në kryerjen e analizës financiare.

41.5.1 Në lidhje me këtë rezultat, subjekti ka prapësuar se mobilimi i apartamentit ka ndodhur në një kohë të largët dhe është përditësuar me një pjesë ndër vite dhe nuk ka asnjë mundësi të mbajë mend vlerën e saktë të këtij mobilimi. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se nuk ka pasur asnjë arsye t’i shmanget pohimit për këtë vlerë, por e ka pasur të pamundur të shprehë një të tillë. Disa prej tyre janë bërë dhuratë nga familjarët e tij në momentin e blerjes dhe të tjera nga familjarët e bashkëshortes në momentin që filloi bashkëjetesa në vitin 2003. Subjekti prapëson se detyrimi i tij është të deklarojë saktë orenditë që ndodhen në apartament, detyrim të cilin e ka realizuar me fotot e dërguara në Komision. Për të mos e lënë pa vlerë dhe për të ndryshuar statusin e tij “jo bashkëpunues”, subjekti deklaroi një shumë prej 500.000 lekësh, por kjo sipas tij nuk do të thotë se mobilimi është bërë në këtë vlerë.

41.5.2 Komisioni, pasi analizoi përgjigjet e subjektit vlerëson se prej tij, sërish, është ndryshuar deklarim. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në parashtrimet e tij përfundimtare se disa nga orenditë i janë dhuruar nga familjarët e tij dhe të bashkëshortes. Komisioni vlerëson se subjekti, me qëllim shmangien e një analize të mirëfilltë financiare, fillimisht, nuk ka deklaruar vlerë mobilimi, ndërsa më pas ka deklaruar, pas kalimit të barrës së provës, se familjarët e tij dhe të bashkëshortes i kanë dhuruar orendi për mobilimin e apartamentit, por pa specifikuar cilat prej tyre. Në lidhje me mosdeklarimin gjatë procesit të hetimit të vlerës së mobilimit dhe më pas deklarimit se një pjesë e mobilimit i është dhuruar nga familjarët e tij dhe të bashkëshortes, Komisioni vlerëson se këto ndryshime në deklarim duhet të jenë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga subjekti janë bërë përpjekje për të mos pasqyruar saktë vlerën e mobilimit.

41.6 Analizë²¹ financiare

Nga Komisioni është bërë një analizë financiare për blerjen e apartamentit nga subjekti në datën 17.1.2002.

	17.1.2002
--	------------------

²¹ Analiza financiare bazohet në: metodologjinë kumulative, pasi periudha e analizuar është para deklarimit të parë; të ardhurat dhe shpenzimet vetëm për subjektin, që nga fillimi i detyrës.

PASURI	3 294 858
Apartament 2+1, sip. 81.16 m ² , Rr. “****”, Durrës	1 500 000
Automjet tip “Volkswagen Golf”, targa ***	400 000
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>	<i>1 394 858</i>
Likuiditete gjendje	1 394 858
Të ardhura të dokumentuara	1 945 451
Të ardhura nga paga e subjektit	1 790 257
Të ardhura nga interesa bankare	155 194
SHPENZIME	423 825
Shpenzime jetese	423 825
Mundësia për kursime	-1 773 231

41.6.1 Nga analiza financiare më sipër konstatohet se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti dhe krijimin e likuiditeteve. Për këtë, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

41.6.2 Subjekti ka prapësuar në lidhje me këtë rezultat, duke përdorur të njëjtat argumente si për krijimin e depozitave në vitet 2000-2001. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se apartamenti është blerë nga të ardhura të krijuara në mënyrë të ligjshme, duke vërtetuar mundësinë për të krijuar likuiditetet në bankë me të ardhura të ligjshme. Këto likuiditete janë përdorur për blerjen e apartamentit në shumën 1.500.000 lekë.

41.6.3 Komisioni, pasi analizoi sqarimet e subjektit, çmon se nuk janë bindëse dhe vlerëson se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme, të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie dhe krijimin e likuiditeteve në shumën 2.273.231 lekë, duke pasur parasysh shtimin e shpenzimeve për mobilim në vlerën prej 500.000 lekësh.

Në përfundim të analizës së fakteve dhe provave, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e apartamentit, krijimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve në shumën 2.273.231 lekë; (ii) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 2.977.421 lekë për krijimin e depozitave në vitet 2000-2001, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit; (iii) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” në mënyrë të plotë dhe të saktë burimet në lidhje me këtë pasuri. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

42. Apartament 1+1²², me sip. 78.24 m², me adresë: Rr. “**”, k. 2 banim me nr. *** në projekt, i ndodhur në pallat 12-katësh, i ndërtuar nga firma “****”, kulla perëndimore, pa hipotekë, Durrës. Blerës rezulton z. Tritan Hamitaj. Vlera: 48.000 euro. Koha e përfitimit datë 5.3.2014. Pjesa takuese: 50 %, në bashkëpronësi me znj. R. H.. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: zgjidhja e kontratës me shoqërinë “****” sh.p.k., duke përfituar një shumë *cash* prej 51.000 euro.**

Arsyetimi ligjor

42.1 Në datën 5.3.2014, subjekti ka lidhur kontratë paraprake shitjeje nr. *** nëpërmjet së cilës i është premtuar shitja e një apartamenti²³, me sip. 78.24 m² me çmim 48.000 euro. Në kontratë është përcaktuar se çmimi është likuiduar dhe burimi i pagesës prej 48.000 euro, vjen nga

²² Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: kontratë paraprake shitjeje nr. *** , datë 5.3.2014.

²³ Deklaruar në DVP/2014.

zgjidhja e kontratës së sipërmarrjes datë 10.1.2011, me palë porositëse Tritan Hamitaj dhe palë sipërmarrëse/investitore shoqërinë “****” sh.p.k. Gjithashtu është deklaruar se dorëzimi fizik i apartamentit bëhet me dorëzimin e çelësave në zyrën noteriale.

Komisioni ka trajtuar në mënyrë të detajuar në pikën 52.2.2 të këtij vendimi burimin e deklaruar nga subjekti të këtij apartamenti shumë prej 51.000 euro, të kthyer nga shoqëria “****” sh.p.k.

42.2 Analizë financiare

	5.3.2014
PASURI	7 081 259
Apartament 1+1, ***, sip.78,24 m ² , Rr. “****” DR	6 725 280
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>	355 979
Likuiditete gjendje	1 299 637
Të ardhura dokumentuar	849 204
Të ardhura nga paga e subjektit	329 307
Të ardhura nga bashkëshortja	206 610
Të ardhura si kujdestare e paaftësisë për fëmijën	87 000
Të ardhura nga pensioni i paaftësisë së djalit	39 000
Të ardhura nga qiratë	180 000
Interesa bankare	7 287
SHPENZIME	452 473
Shpenzime jetese	192 875
Shpenzime të posaçme për djalin (sipas kontratës së donacionit)	200 000
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	59 598
Mundësia për kursime	-6 684 528

42.3 Në analizën financiare nuk është përfshirë kthimi i shumës 41.000 euro dhe 10.000 euro penalitete, në datën 10.1.2014, pasi subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion provues marrjen e shumës 51.000 euro, si dhe aftësinë financiare të shoqërisë “****” sh.p.k. për dhënien e kësaj shume ndaj tij (trajtuar në pikën 52.2 të këtij vendimi). Në përfundim, ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën 6.684.528 lekë për blerjen e këtij apartamenti. Për këtë rezultat, iu kalua barra e provës, me qëllim që të provojë të kundërtën.

42.4 Pas kalimit të barrës së provës, Komisioni shqyrtoi provat dhe shpjegimet e subjektit, të cilat i konsideron jobindëse. Ndërkohë, Komisioni korrigjoi analizën financiare, duke reduktuar shpenzimet e udhëtimit për janar 2014 në shumën 17.565 lekë dhe duke përfshirë të ardhurat nga qiraja në shumën 200.000 lekë. Sërish subjekti rezulton në pamundësi financiare në shumën 6.646.963 lekë.

42.5 Në përfundim të analizës së fakteve dhe provave, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e apartamentit në shumën 6.646.963 lekë. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

43. Apartament²⁴ me sip. 103.82 m², nr. pasurie *, z. k. ***, Tiranë dhe ambiente të përbashkëta me sip. 13.8 m².** Blerës: R. dhe Tritan Hamitaj. Vlera: 134.435 euro. Koha e përfitimit të pronës datë 13.8.2014. Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: 50.000 euro kredi tek Alpha Bank; 5.028 euro depozita e mbyllur në Credins Bank; 3.000 euro të mbetura nga penaliteti i zgjidhjes së kontratës me shoqërinë “****” sh.p.k.; 1.100.000 lekë kthim huaje nga shtetasi G. H. (dhënë pas mbylljes së llogarisë në ProCredit Bank dhe Tirana Bank, si dhe të ardhura të akumuluar deri në momentin e dhënies së huas); 900.000 lekë kthim huaje nga shtetasja M. G. (dhënë pas mbylljes së llogarive bankare), të ardhura të vitit të blerjes dhe gjendje në llogari; hua marrë shtetasit A. H. në vlerën 2.800 euro. Përfituar pjesa e shtetasës M. G. me shkëmbim apartamenti të ndodhur në rr. “****”, lagjja ***, p. ***, Durrës. Pasuria me nr. ***, z. k. *** me sip. 75.58 m². Vlera: 134.435 euro. Pjesa takuese: 33.3 % Tritan Hamitaj dhe 66.6 % R. H..

Arsyetimi ligjor

43.1 Me kontratë shitblerjeje nr. 606/335/2, datë 13.8.2014, bashkëshortja e subjektit, së bashku me znj. M. G.²⁵ kanë blerë apartament me sip. 103.82 m², nr. pasurie ***, z.k. *** me çmim 134.435 euro, shumë e cila, bazuar në nenin me emërtim “mënyrat dhe afatet e pagesës së çmimit” është kryer totalisht nga blerësi në llogarinë bankare të shitësit.

43.2 Nga nxjerrja e llogarisë së përbashkët të shtetasve A. G., Tritan Hamitaj, M. G. dhe R. H. rezulton se:

- i. në datën 13.8.2014 është depozituar shuma prej 24.435 euro nga subjekti i rivlerësimit, shumë e cila është transferuar te znj. A. G. (shitësja e apartamentit);
- ii. në datën 14.8.2014 është depozituar shuma 10.000 euro nga subjekti i rivlerësimit, shumë e cila është transferuar te znj. A. G. (shitësja e apartamentit);
- iii. në datën 19.8.2014 është *disbursuar* kredia në shumën 50.000 euro, e cila i është transferuar znj. A. G..

43.3 Analizë financiare për pagesat e kryera nga subjekti

	13-19.8.2014
PASURI	10 961 063
Apartament sip.103,82 m ² , Tiranë (paguar 13/8 shuma 24,435 euro)	3 423 588
Apartament sip.103,82 m ² , Tiranë (paguar 14/8 shuma 10,000 euro)	1 401 100
Apartament sip.103,82 m ² , Tiranë (paguar me kredi 19/8 shuma 50,000 euro)	7 005 500
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>	-869 125
Likuiditete gjendje	430 512
Të ardhura dokumentuar	8 690 802
Të ardhura nga paga e subjektit	654 029
Të ardhura nga bashkëshortja	229 295
Të ardhura bashkëshortja si kujdestare e fëmijës	48 750
Të ardhura nga pensioni i paaftësisë së djalit	48 750
Marrë hua nga vëllai Alket Hamitaj 5,000 euro në gusht	700 550

²⁴ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 13.12.2016 për apartament me sip. 103.82 m², nr. pasurie ***, z.k. ***; (ii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 13.8.2014; deklaratë noteriale nr. ***, datë 20.8.2014; (iii) kontratë huaje nr. ***, datë 14.8.2014, me nr. ***, datë 19.8.2014; (iv) kontratë shkëmbimi nr. ***, datë 4.11.2016; (v) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 21.8.2014, për apartament me sip. 103.82 m² në Rr. “****” në bashkëpronësi të shtetasve M. G., Tritan dhe R. H.; (vi) certifikatë për vërtetim pronësie e datës 13.12.2007 për apartament me sip. 78.58 m², me nr. pasurie *** në Durrës; (vii) kontratë dhurimi nr. ***, datë 9.11.2007; (viii) kontratë shitblerjeje e datës 22.2.1994; dëshmi trashëgimie nr. ***, datë 25.8.1994; (ix) deklaratë noteriale nr. ***, datë 9.11.2016.

²⁵ Motra e saj.

Kthyer huaja nga vëllai G. H. 1,100,000 lekë	0
Kthyer huaja nga M. G. 900,000 lekë	0
Interesa bankare	3 929
Kredi MTG në Alpha Bank 50,000 eur-20 Yrs	7 005 500
SHPENZIME	1 065 885
Shpenzime jetese	485 201
Shpenzime të posaçme për djalën (sipas kontratës së donacionit)	550 000
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	30 684
Mundësia për kursime	-3 336 145

Në analizë:

- nuk është përfshirë shuma 51.000 euro e kthyer nga shoqëria “****” sh.p.k.
- nuk është përfshirë shuma 1.100.000 lekë e kthyer nga vëllai, pasi subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion burimet e ligjshme të mjaftueshme të z. G. H. për kthimin e kësaj shume.

43.3.1 Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën 3.336.145 lekë për blerjen e këtij apartamenti. Për këtë, subjektit iu kalua barra e provës.

43.3.2 Pas kalimit të barrës së provës subjekti prapësoi²⁶ se:

a. Në lidhje me huan e kthyer nga z. G. H.

Komisionit i rezulton se, pasi analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me personin tjetër të lidhur, z. G. H., ai ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të kthyer huan në shumën 1.100.000 lekë.

	2007 deri 2014
Të ardhura	10 932 386
Te ardhura nga paga e G.	6 854 535
Të ardhura nga bashkëshortja E.	3 311 184
Shitur apartament në bashkëpronësi 1/6 secili	766 667
Shpenzime	4 651 010
Shpenzime jetese	3 551 010
Kthyer huaja te vëllai	1 100 000
Mundësia për kursime	6 281 376

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson që shuma 1.100.000 lekë të përfshihet në analizën financiare për blerjen e këtij apartamenti.

²⁶ Subjekti ka depozituar këto prova: përgjigje e Drejtorisë së Policisë Tiranë nr. ***, datë 6.7.2020 në të cilën pasqyrohet paga e z. G. H. për periudhën qershor 2005 – nëntor 2015; përgjigje nga Drejtoria Arsimore Tiranë në të cilën pasqyrohet paga e znj. E. H. për periudhën maj 2006 – maj 2020; kontratë pune datë 15.10.2007 me afat dyvjeçar e lidhur midis punëdhënësit “****” sh.p.k. dhe z. A. G. në cilësinë e punëmarrësit, në të cilën pasqyrohet paga e marrë prej 30.000 lekësh/muaj nga data 15.10.2007 e në vazhdim deri në ndërprerjen e marrëdhënies së punës datë 3.9.2013; vërtetim nr. *** prot., datë 16.4.2020 i ISSh-së Tiranë, në të cilën pasqyrohet paga e z. A. G. për periudhën shkurt 2005 - dhjetor 2006; librezë e punës e z. A. G. që pasqyron periudhën e punës për periudhën 16.8.2002 –13.8.2014; vërtetim i *** sh.p.k. datë 17.7.2020; kontratë qiraje apartament z. A. G., datë 1.10.2012; kontratë qiraje apartament z. A. G., datë 7.1.2007; deklaratë noteriale znj. M. G. nr.*** rep., nr. *** kol., datë 21.7.2020; shkresë nr. *** prot., datë 13.7.2020, të Ministrisë së Brendshme; certifikatë pasurie nr. ***, z. k. ***.

b. Në lidhje me huan e kthyer nga znj. M. G.

b.1 Nga kontrata e punës e bashkëshortit të saj, z. A. G., me punëdhënësin shoqërorinë “***”, rezulton se është paguar me një pagë prej 30.000 lekësh/muaj, duke filluar nga data 15.10.2007 e në vazhdim deri në ndërprerjen e marrëdhënies së punës datë 3.9.2013. Ndërkohë gjatë këtyre viteve ka marrë një pagë shpërblim për çdo fundviti dhe orët jashtë orarit, bazuar në vërtetimin e lëshuar nga kjo shoqëri, datë 17.7.2020.

Mungesa e pagesës së tatimit dhe sigurimeve shoqërore nga punëdhënësi, si dhe mospagimi i këtyre sigurimeve jo sipas pagës së marrë realisht për periudhën 15.10.2007 e në vazhdim deri në ndërprerjen e marrëdhënies së punës datë 3.9.2013, subjekti deklaron se është një përgjegjësi e punëdhënësit dhe nuk mund të penalizojë në këtë proces rivlerësimi subjektin, pasi nuk mund të mbajë përgjegjësi për detyrime të personave që nuk janë as persona të lidhur.

Z. A. G. zotëron një apartament (dhomë e kuzhinë) në Tiranë në rr. “****” me nr. ***, z.k. **, të cilin pasi ka ardhur me banim në Durrës e ka dhënë me qira. Në datën 7.1.2007, z. A. G. i ka dhënë me qira apartamentin me një vlerë prej 30.000 lekësh/muaj shtetases K. M., kontratë e cila ka vazhduar deri në datën 30.6.2011. Nga kjo kontratë z. A. G. ka përfituar të ardhura në shumën 1.620.000 lekë.

Në datën 1.10.2012, z. A. G. i ka dhënë me qira apartamentin me një vlerë prej 30.000 lekësh/muaj shtetases I. B., kontratë e cila ka vazhduar deri në datën 13.8.2014 e më pas. Nga kjo kontratë z. A. G. ka përfituar të ardhura në shumën 630.000 lekë.

Lidhur me shumën 900.000 lekë, si hua e kthyer nga znj. M. G., nuk ka detyrim për të deklaruar burimin e ligjshëm sipas ligjit nr. 84/2016, pasi kjo shumë nuk është hua e dhënë nga ana e saj, por është kthim i detyrimit të krijuar në vitin 2007 nga marrëveshja e pjesëtimit.

b.2 Në lidhje me të ardhurat e znj. M. G., Komisioni analizoi dokumentacionin e depozituar nga subjekti. Në këtë dokumentacion rezultojnë mospërputhje, pasi bazuar në kontratën individuale të punës së datës 15.10.2007, lidhur midis z. A. G. dhe shoqërisë “****” sh.p.k. rezulton se ai ka filluar punë në këtë datë, ndërkohë bazuar në librezën e punës të plotësuar nga kjo shoqëri rezulton se ka filluar punë në datën 1.11.2009. Libreza rezulton e vulosur dhe e firmosur nga shoqëria. Komisioni vlerëson të marrë në konsideratë të dhënat e pasqyruara në librezën e punës.

b.3 Në lidhje me dy kontratat e qirasë datë 1.10.2012 dhe 7.1.2008, të depozituar nga subjekti rezulton se apartamenti i dhënë me qira nga z. A. G. është në pronësi të tij dhe familjarëve të tij dhe ka 1/3 pjesë takuese bazuar në certifikatën e pasurisë nr. ***, z.k. **. Mbrapa kontratave të qirasë ka disa rinovime me shkrim dore të tyre për periudhën 2008 – 2020. Komisioni vlerëson të përfshijë në analizë financiare të ardhurat nga qiraja me 1/3 pjesë.

b.4 Në lidhje me shumën 900.000 lekë, subjekti, për herë të parë, deklaron se nuk është hua, por kthim i detyrimit të krijuar në vitin 2007 nga marrëveshja e pjesëtimit. Për këtë qëllim subjekti ka depozituar edhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.7.2020, të znj. M. G., e cila deklaron²⁷ se shuma prej 900.000 lekësh që pasqyrohet në deklaratën vjetore të pasurisë së z. Tritan Hamitaj si e marrë borxh prej saj në vitin 2007, nuk rezulton të jetë e tillë.

²⁷ “Në vitin 2007 nuk kam marrë asnjë lekë borxh nga Tritan dhe R. H.. Kjo shumë është detyrim i krijuar nga unë tek R. për shkak të marrëveshjes së pjesëtimit për apartamentin me sipërfaqe 78.58 m² në bashkëpronësi të L., M. dhe R. dhe nga krahu tjetër të shumës 6,000,000 lekë të depozituar në Intesa Sanpaolo Bank. Nga kjo marrëveshje pjesëtimi unë përfitova më shumë pasuri dhe për të barazuar pjesën duhet të kompensoja R. me 900,000 lekë”.

Ky deklarami i motrës së bashkëshortes së subjektit nuk përputhet me deklaramet e subjektit në DPV-në përkatëse, të cilat kanë fuqi provuese, bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në deklaratën “Vetting”. Po ashtu, edhe në përgjigje të pyetësorit të parë subjekti nuk ka deklaruar se shuma prej 900.000 lekësh nuk është hua, por një detyrim që znj. M. G. kishte ndaj bashkëshortes së subjektit. Më konkretisht në lidhje me shumën 900.000 lekë subjekti ka deklaruar, si vijon:

- i. në DPV/2007 subjekti deklaroi se znj. R. H. i jep borxh motrës M. H. shumën 900.000 lekë;
- ii. në DPV/2014 subjekti deklaroi kthimin e shumës 900.000 lekë në favor të znj. R. H., marrë borxh nga znj. M. H. G.;
- iii. në deklaratën “Vetting” deklaroi si burim shumën 900.000 lekë kthim huaje nga znj. M. G.;
- iv. gjatë hetimit administrativ subjekti, në asnjë moment, nuk ka deklaruar se shuma prej 900.000 lekësh është një detyrim i lindur si pasojë e pjesëtimit të pretenduar prej tij të apartamentit dhe llogarisë bankare në shumën 6.000.000 lekë.

Për sa më sipër rezulton se subjekti ka ndryshuar deklaram gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me huanë në shumën 900.000 lekë. Deklarata noteriale e znj. M. G. është bërë pas kalimit të barrës së provës dhe bie ndesh me atë çfarë subjekti ka deklaruar ndër vite, si dhe në deklaratën “Vetting”. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, pasi nuk përputhen me deklaramet e tij në deklaratat periodike, por edhe në deklaratën “Vetting”. Subjekti, i gjendur në kushtet e pamundësisë për të justifikuar me të ardhura të ligjshme dhënien e huasë në shumën 900.000 lekë znj. M. G., është përpjekur të deklarojë në mënyrë të pasaktë marrëdhënien e krijuar midis bashkëshortes dhe znj. M. G.. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 900.000 lekë dhe, rrjedhimisht, pavarësisht faktit se znj. M. G. ka pasur të ardhura për kthimin e kësaj huaje, shuma prej 900.000 lekësh do të konsiderohet si e ardhur jo e ligjshme, duke ndikuar në analizën financiare të subjektit për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2014.

b.5 Analiza financiare për mundësinë e dhënies së kësaj huaje nga subjekti është trajtuar në pikën 53.2.2 të këtij vendimi. Ndërkohë, pas analizimit të provave të depozituar nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, rezulton se znj. M. G. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për kthimin e huas në shumën 900.000 lekë.

*c. Në lidhje me shumën 51.000 euro kthyer nga shoqëria “****” sh.p.k. më 10.1.2014 subjekti deklaroi se ka shërbyer për blerjen e apartamentit 1+1, në vlerën 48.000 euro në datën 5.3.2014 dhe pjesa e mbetur prej 3.000 euro për blerjen e apartamentit tjetër në datën 13.8.2014. Subjekti kërkon përfshirjen në analizën financiare të vitit 2014 të të ardhurave të tokës bujqësore prej 150.000 lekësh.*

Në lidhje me këto të ardhura Komisioni ka vendosur që të mos përfshihen në analizë financiare sipas arsyetimit në pikën 52.2.2 dhe pikën 40.4 të këtij vendimi.

d. *Në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat*

d.1 Subjekti ka pretenduar që shpenzimet për djalin (sipas kontratës së donacionit) në shumën 550.000 lekë, të përfshira në analizën financiare deri në datën 13.8.2014, të hiqeshin, pasi sipas tij këto shpenzime të llogaritura nga Komisioni mbulohen nga kontrata e donacionit.

Në lidhje me këtë pretendim, Komisioni vlerëson se për sa kohë nga subjekti janë kryer shpenzime mujore për djalin, për të cilat nuk ka deklaruar vlerën e saktë të tyre, këto të llogariten në shumën e donacionit pjesëtuar për 12 muaj, për rrjedhojë në analizën financiare këto shpenzime do të barazohen me vlerën e donacionit vetëm në fund të vitit.

d.2 Subjekti ka kërkuar që në analizën financiare të vitit 2014 zëri të ardhurat nga Instituti i Kulturës Italiane të ndryshohet nga 18.000 lekë në shumën 46.000 lekë.

Komisioni vlerëson se pretendimi i subjektit nuk qëndron, pasi nuk provohet pagimi i detyrimeve tatimore. Në analizë financiare janë përfshirë vetëm ato të ardhura, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore dhe figurojnë në bankë ose konfirmohen nga ISSh-ja, në vlerën 18.000 lekë.

d.3 Subjekti ka kërkuar të hiqen shpenzimet e udhëtimit për z. J. H. në janar të vitit 2014.

Komisioni vlerëson se pretendimi i subjektit është i drejtë duke u korrigjuar në këtë mënyrë analiza financiare për sa i përket shpenzimeve të udhëtimit, por ky korrigjim nuk ndikon në analizën financiare të blerjes së apartamentit.

43.3.3 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, kreu një analizë të re financiare në përfundim të së cilës konstatohet se subjekti sërish është në mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.236.145 lekë.

43.4 Nga nxjerrja e llogarisë së znj. M. G. në Intesa Sanpaolo Bank evidentohet se në datën 28.8.2014 ka transferuar shumën 8.368.900 lekë (sipas kursit të këmbimit të datës së transaksionit 60.039 euro²⁸) te znj. A. G..

43.4.1 Në tabelën më poshtë është ecuria e krijimit të shumës së paguar vetëm nga znj. M. G..

Intesa Sanpaolo Bank	Shuma e tërhequr	Shuma e depozituar	Përshkrimi i veprimit
2.7.2007		6,000,000	Transferuar nga R. H., investuar në Bono Thesari 1-vjeçare, për 2 vjet radhazi deri 16.7.2009
2.7.2009		2,000,000	Cash, M. H.
16.7.2009	8,000,000		2 shumat më sipër bashkohen dhe investohen në bono thesari 1-vjeçare, për 5 vjet radhazi, deri më 28.8.2014
28.8.2014		8,400,000	Maturimi i fundit i Bonove të Thesarit
28.8.2014	8,368,900		Transferohet në llogari të shitësit A. G.

43.4.2 Shuma prej 6.000.000 lekësh e transferuar nga llogaria e znj. R. H. te motra e saj, znj. M. G. në datën 2.7.2007, e ka burimin te shuma 4.000.000 lekë, si pjesë e depozitimit të parë në datën 9.4.2006, të shumës 6.000.000 lekë në llogarinë triemërore L.-R.-M. H. në Intesa Sanpaolo Bank²⁹. Shuma 2.000.000 lekë është e depozituar *cash* nga nëna, L. H. në datën 9.8.2006 dhe më vonë është transferuar te R., pastaj te M. H..

Subjekti ka arritur të provojë me dokumentacion burimin e ligjshëm vetëm për shumën 4.000.000 lekë. Për rrjedhojë, në analizën financiare të mëposhtme, është konsideruar si e ardhur vetëm shuma 4.000.000 lekë.

43.4.3 Analiza³⁰ për mundësinë e krijimit të burimit për pagesën e znj. M. G.

	2007	2009
PASURI	7 168 269	106 846
Shtesa/Pakësime/Likuiditete	7 168 269	106 846
Likuiditete gjendje	7 168 269	8 000 017
Të ardhura të dokumentuara	4 688 568	1 041 550

²⁸ 1 euro = 139.39 lekë, kursi i këmbimit datë 28.9.2014, Banka e Shqipërisë.

²⁹ Shuma 4.000.000 është përftuar nga shitja e një trualli të znj. L. H., në datën 5.4.2006.

³⁰ Analiza financiare është bërë duke përdorur metodologjinë kumulative, pasi znj. M. G. nuk është subjekt deklarimi.

Të ardhura nga paga e M. G.	245 513	328 838
Të ardhura nga interesa bankare	443 055	712 712
Dhënë znj. G. nga familja (nëna dhe motra)	4 000 000	
SHPENZIME	136 620	2 228 709
Shpenzime jetese (për një person)	136 620	136 620
Transferuar te R. H. 15.000 euro		2 092 089
Mundësia për kursime kumulative	-2 380 086	-3 791 521

Në këtë analizë, të ardhurat e znj. M. G. të dokumentuara³¹ janë konsideruar që nga qershori i vitit 2004, sepse të ardhurat para kësaj date, subjekti i ka deklaruar si burim për krijimin e depozitës në shumën 6.000.000 lekë, në datën 9.6.2004, kryer nga nëna L. H..

43.4.4 Nga analiza financiare rezulton se znj. M. G. nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të krijuar likuiditetet në vitin 2007, për rrjedhojë, nuk ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pjesës së saj takuese të apartamentit në vitin 2014. Për këtë, subjektit iu kalua barra e provës.

43.4.5 Subjekti prapësoi se e ndjera, znj. L. H. (T.), në vitin 2003, nga vendimi gjyqësor i fazës së dytë të pjesëtimit nr. *** vendimi, datë 9.4.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ka përfitur shumën 3.500.000 lekë³². Nga dosja gjyqësore nuk rezulton të jetë bërë aktëkspertimi ku të pasqyrohej vlera e kompensimit për bashkëpronarë që kanë marrë pjesë fizike më të vogël, por vetëm një hartë që tregon pjesëtimin fizik të firmosur nga ekspertja. Subjekti pretendon se në mungesë të këtij akti ka kontaktuar bashkëpronarët që janë gjallë, të cilët i kanë konfirmuar faktin se znj. L. H. ka marrë shumën 3.500.000 lekë.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit konstaton se janë në nivel deklarativ dhe jo të mbështetur në prova. Nga ana e tij nuk u provua që znj. L. H. të ketë marrë shumën 3.500.000 lekë, për rrjedhojë Komisioni në analizë financiare të znj. M. G. nuk do të përfshijë këtë shumë.

43.4.6 Në përfundim, pas analizës financiare, Komisioni konkludon se znj. M. G. ka qenë në pamundësi mjetesh financiare për të kryer pagesën prej 8.368.900 lekësh te shitësi A. G..

43.5 Nga pagesat e evidentuara, kryer në favor të shitëses A. G., rezulton se janë paguar 144.435 euro. Kjo do të thotë se apartamenti është blerë 10.000 euro më shumë se çmimi i deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”. Për këtë, subjektit iu kalua barra e provës, i cili shpjegoi³³ se kjo ka ndodhur pasi sendet jo të domosdoshme dhe të luksit të apartamentit janë blerë nga znj. M. G.. Komisioni i konsideron bindëse provat dhe shpjegimet e subjektit.

43.6 Në datën 20.8.2014, me deklaratë noteriale nr. ***, deklaruesit R. H. dhe M. G. deklarojnë se: *“Kanë blerë pasurinë apartament me sip. 103.82 m² në r. ‘***’, për të cilin M. G. ka paguar 50.000 euro ose 37.1 %, ndërsa R. H. ka dhënë 84.435 euro, ose 62.9 %, si pasuri e ardhur gjatë martesës me z. Tritan Hamitaj. Një pjesë e kësaj shume 50.000 euro janë marrë kredi në*

³¹ Vërtetimi i ISSh-së Durrës për vitet 1986 – 2012 dhe ISSh-së Tiranë për vitet 2004 – 2006.

³² Subjekti ka depozituar këto prova: procesverbal i seancës për vendimin nr. ***, datë 9.4.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; certifikatë vdekjeje e të ndjerit Sh. T, lëshuar nga Njësia Administrative Tiranë ***, datë 4.10.2017; dorëzim banese nga Bashkia Lushnje n.*** prot, datë 13.5.1993; përgjigje e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor nr. *** prot., datë 14.7.2020; deklaratë noteriale J. T. para noter S. Sh. nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.7.2020; deklaratë noteriale A. T. para noter R. K. nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.7.2020; deklaratë noteriale E. I, E. S., Gj. T., datë 14.7.2020 (është hartuar në SHBA dhe dërguar me e-mail. Ende nuk më ka ardhur fizikisht).

³³ Subjekti ka depozituar “kontratë shitje e sendeve të luajshme, sendet të cilat nuk futen në çmimin e apartamentit” datë 13.8.2014 lidhur midis shtetasve M. G. dhe A. G.. Në këtë kontratë është përcaktuar se: *“...apartamenti me nr. pasurie *** do të shitet me një çmim 134.435 euro, në të cilin përfshihet edhe mobilimi i zakonshëm, ndërkohë një pjesë e sendeve që nuk janë përfshirë në çmim do të blihen nga znj. M. G. për shumën 9.800 euro, e cila do të paguhet së bashku me shumën 50.000 euro.”*

Alpha Bank. Ata pranojnë që pjesë e kësaj prone të jetë dhe subjekti në 62.9 % të pronës së bashkëshortes së tij.”

Komisioni ka konstatuar se ky deklaram nuk përputhet me të dhënat e administruara nga banka, nga ku rezulton se znj. M. G. ka paguar shumën 60.000 euro. Duket sikur subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale që përmban të dhëna që nuk përputhen me faktet.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka depozituar dokumentacion provues nëpërmjet së cilës vërtetohet se znj. M. G., për blerjen e apartamentit, ka paguar shumën 50.000 euro (shihni pikën 43.5 të vendimit).

43.7 Si burim për blerjen e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar:

43.7.1 Kredi te Alpha Bank në shumën 50.000 euro. Në datën 19.8.2014 me kontratë huaje³⁴ nr. ***, subjekti, bashkëshortja e tij dhe znj. M. G. kanë marrë hua nga Alpha Bank shumën 50.000 euro, me afat 20 vjet me qëllim blerjen e një apartamenti në Durrës.

Për sa më sipër, rezulton se kredia nuk është marrë vetëm nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, për rrjedhojë edhe kontributi i znj. M. G. në blerjen e apartamentit nuk është 37 %.

Në lidhje me këtë konstatim, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se për marrjen e kredisë në shumën 50.000 euro nga Alpha Bank u vendos si kusht që kredia do të akordohej për të gjithë bashkëpronarët e apartamentit dhe bashkëshortët e tyre, pavarësisht se cili nga bashkëpronarët kërkonte kredi.

Pavarësisht se nga ana formale në kredimarrje rezultojnë shtetasit M. dhe A. G., kredia është marrë nga shtetasit R. dhe Tritan Hamitaj, e cila është shlyer vetëm nga subjekti. Komisioni i konsideron bindëse shpjegimet e subjektit.

43.7.2 Mbyllur depozita në Credins Bank në shumën 5.028 euro.

43.7.3 Shuma 3.000 euro e mbetur nga penaliteti i zgjidhjes së kontratës me shoqërinë “****” sh.p.k.

Komisioni vlerëson se kjo shumë nuk do të konsiderohet si burim, pasi subjekti nuk ka provuar aftësinë financiare të shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe nuk ka dokumentuar lëvrimin e kësaj shume. Subjektit iu kalua barra e provës në lidhje me këtë. Vlerësimi i Komisionit në lidhje me marrëdhënien ndërmjet subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k. është bërë në pikën 52.2 të këtij vendimi, për pasojë shuma prej 3.000 euro nuk do të përfshihet në analizën financiare.

43.7.4 Kthim huaje nga z. G. H. (dhënë pas mbylljes së llogarisë në ProCredit Bank dhe Tirana Bank dhe të ardhura të akumuluar deri në momentin e dhënies së huas) në shumën 1.100.000 lekë.

Trajtuar në pikën 43.3.2 të këtij vendimi.

43.7.5 Kthim huaje nga znj. M. G. (dhënë pas mbylljes së llogarive bankare) në shumën 900.000 lekë.

43.7.5.1 Komisioni, në tabelën e mëposhtme, ka kryer një analizë financiare për të parë mundësinë e znj. M. G. për të kthyer shumën 900.000 lekë.

	6/2004 deri 2014
PASURI	8 408 643
Ap. 103,82 me sip. m ² , Rr. “****”, TR 37.1 %	8 406 600
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>	2 043
Të ardhura dokumentuar	11 574 792

³⁴Garanci vendoset apartamenti me sip. 103.82 m² në Rr. “****” Tiranë, në pronësi të znj. A. G. (shitësja).

Të ardhura nga paga e M. G.	3 170 410
Të ardhura nga bashkëshorti	641 267
Të ardhura nga interesa bankare	3 763 115
Dhënë znj. M. G. nga familja (nëna dhe motra)	4 000 000
SHPENZIME	4 948 218
Shpenzime jetese	1 956 128
Transferuar te znj. R. H. 15.000 euro	2 092 089
Kthimi i huas	900 000
Mundësia për kursime	-1 782 069

- Analiza financiare është bërë duke përdorur metodologjinë kumulative nga qershori i vitit 2004 e në vijim.
- Të ardhurat e znj. M. G. nga viti 2008 dhe të bashkëshortit të saj duke filluar nga 2/2012³⁵ në bazë të dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti.
- Shpenzimet e jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së: për 1 person deri në vitin 2011 kur kemi të dhëna vetëm për pagën e znj. M. H. dhe nga viti 2012 për 2 persona pasi kemi të dhëna për pagat e të dy bashkëshortëve.

Nga analiza financiare rezulton se znj. M. G. nuk ka pasur burime të mjaftueshme të ligjshme për të kthyer huan në shumën 900.000 lekë.

Prapësimet e subjektit, në lidhje me këtë rezultat, janë trajtuar në pikën 43.3.2/germa b.5 të këtij vendimi, nga ku ka rezultuar se subjekti ka provuar që znj. M. G. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për kthimin e huas.

43.7.5.2 Subjekti, dhënien e kësaj huaje znj. M. G., e ka deklaruar në DVP/2007.

Nga analiza financiare për vitin 2007 rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje.

Prapësimet e subjektit në lidhje me këtë rezultat janë trajtuar në pikën 43.3.2 germa b.4 të këtij vendimi.

43.7.6 Të ardhura të vitit të blerjes (2014) dhe gjendje në llogari. Subjekti nuk ka detajuar se sa është kjo shumë.

43.7.7 Marrë hua nga z. A. H. në shumën 2.800 euro.

Në lidhje me këtë hua, në DVP/2014, subjekti deklaroi se është marrë në gusht të vitit 2014 shuma 5.000 euro dhe mbetur borxh në fund të vitit shuma 2.800 euro.

Analiza financiare

Alket Hamitaj (në euro) ³⁶	11.5.2001	2014	2015
Të ardhura nga paga ³⁷	5 449	15 516	
Kthyer huaja nga subjekti		2 200	
Shpenzime³⁸	7 258	12 255	4 400
Depozitë ProCredit Bank	4 918		

³⁵ Vërtetim nr. *** nga ISSh-ja Durrës datë 6.4.2020 që fillon nga data 2/2012.

³⁶ Vëllai z. A. H. jeton dhe punon në Itali, të ardhurat, shpenzimet dhe veprimet e huas janë bërë në euro, kështu tabela mbi mundësinë e tij të kursimit është në euro.

³⁷ Totali i të ardhurave periudha 1996 -2015 234 608 euro

³⁸ Totali i shpenzimeve periudha 1996 -2015 139 111 euro

Dhënë hua subjektit të rivlerësimit		5 000	4 400
Shpenzime jetese	2 340	9 455	
Mundësia për kursime	-1 809	3 261	-4 400
Mundësia për kursime kumulative	5 151	87 780	83 380

Analiza financiare është bazuar:

- të ardhurat janë marrë nga Istituto Nazionale di Previdenza Sociale (ISSh) nga viti 1996 deri në vitin 2014;
- shpenzimet e jetesës³⁹ janë përlogaritur për 1 person. Në ato vite ku shpenzimet e jetesës janë më të larta se të ardhurat, ato janë barazuar me të ardhurat;
- është përfshirë në analizë shuma prej 600.000 lekësh e depozituar në datën 11.5.2001, në llogarinë e z. A. H., në ProCredit Bank. Kjo shumë është transferuar tek Subjekti në datë 7.1.2002 dhe ai e ka tërhequr atë. Subjekti është firmë e autorizuar në këtë llogari.

Nga analiza financiare rezulton se z. A. H. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huave.

43.7.8 Përfituar pjesa e znj. M. G. me shkëmbim apartamenti me sip. 75.58 m², nr. pasurie ***, z.k. ***, të ndodhur në Rr. “****”, lagjja ***, p. nr. ***, Durrës.

i. Në datën 4.11.2016, me kontratë shkëmbimi nr. ***, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka shkëmbyer apartament me sip. 78.58 m², nr. pasurie ***, z.k. ***, me pjesën takuese të znj. M. G. në apartamentin me sip. 103.82 m².

ii. Origjina e pasurisë me sip. 78.58 m², në pronësi të bashkëshortes së subjektit është, si vijon:

- me kontratë shitblerjeje të datës 22.2.1994, shtetasit S., L., M. dhe R. H. (sot H.) blejnë nga Ndërmarrja Komonale Banesa, apartament me sip. 78.58 m² në rr. “****” Durrës, kundrejt çmimit 19.318 lekë;
- në datën 25.8.1994 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë nr. *** e trashëgimlënësit, z. S. H., sipas së cilës shtetasit M., R. dhe L. H. trashëgojnë nga 1/3 pjesë;
- me kontratë dhurimi⁴⁰ nr. ***, datë 9.11.2007, shtetasit L. H. dhe M. G. (H.) dhurojnë pjesët e tyre takuese (secila nga 1/3) në apartamentin me sip. 78.58 m² në rr. “****” Durrës, shtetasit R. H. (H.), e cila zotëronte gjithashtu 1/3 pjesë.

iii. Subjekti, në lidhje me dhurimin, sqaron se nuk ka qenë një dhurim, por një marrëveshje për pjesëtim pasurie. Apartamenti me sipërfaqe 78.58 m² ishte në bashkëpronësi të bashkëshortes së tij, motrës dhe nënës së saj. Njëkohësisht edhe shuma prej 6.000.000 lekësh ishte e familjes e depozituar në Intesa Sanpaolo Bank. Nga kjo marrëveshje u realizua kontrata e “dhurimit” me të cilën u bë pronare e vetme në apartament znj. R. H., e cila bëri kalimin e shumës prej 6.000.000 lekësh në llogarinë bankare të znj. M. G..

iv. Nga hetimi ka rezultuar se:

- a. pjesa që i është dhuruar bashkëshortes së subjektit ka vlerën 1.990.000 lekë, e cila është 3-fish më e vogël se shuma e transferuar te znj. M. G.;
- b. shuma prej 6.000.000 lekësh përdoret nga znj. M. G. për blerjen e 37 % të apartamentit në Tiranë, pjesë e cila më pas shkëmbehet me këtë apartament;
- c. subjekti ka deklaruar se apartamenti i blerë nga bashkëshortja dhe motra e saj është dhënë me qira dhe të ardhurat janë përfituar vetëm prej tij pasi znj. M. G. ka pasur në zotërim apartamentin që ka pasur në pronësi bashkëshortja e tij (i cili është dhuruar);

³⁹ <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

⁴⁰ Ky dhurim është deklaruar edhe në DVP/2007.

d. kontrata e shkëmbimit është bërë më 4.11.2016, ndërkohë që nuk kishte arsye që të mos bëhej që në vitin 2014 për sa kohë znj. M. G. e zotëronte këtë apartament.

v. Për sa më sipër, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës dhe ka ngritur dyshime:

- për dhurimin e këtij apartamenti nga znj. M. G. te znj. R. H. dhe më pas shkëmbimin e këtij apartamenti me pjesën e saj takuese në apartamentin në Tiranë (për të cilin sipas deklarimeve të subjektit ka paguar shumën 50.000 euro dhe është bashkëkredimarrëse në kreditë në shumën 50.000 euro);
- se veprimet e dhurimit dhe shkëmbimit janë bërë për të fshehur pronësinë reale mbi këtë apartament të subjektit të rivlerësimit dhe për të justifikuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të subjektit në vitin 2014.

vi. Subjekti ka prapësuar se kontrata e shkëmbimit nuk mund të bëhej në vitin 2014, vit kur u ble apartamenti, pasi në këtë kohë ka qenë gjallë e ndjera L. H., e cila jetonte në banesën e znj. R. H.. Pas vdekjes së saj, të dyja motrat duhet të zgjidhnin problemin e banesës, e cila ishte në pronësi të znj. R. H. dhe zotërohej nga znj. M. G.. Ky është shkaku që është realizuar marrëveshja e shkëmbimit dhe jo qëllime të tjera për të rritur fiktivisht pasurinë.

vii. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe nuk përputhen me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit dhe në lidhje me këtë marrëdhënie konstaton se:

- Shuma prej 6.000.000 lekësh e transferuar nga bashkëshortja e subjektit në vitin 2006 te znj. M. G. është përdorur për pagesën e apartamentit në vitin 2014.
- Apartamenti i blerë në vitin 2014, sipas deklarimeve të subjektit, është shfrytëzuar gjithmonë nga familja e tij, pasi ka përfutur të ardhura nga dhënia me qira, ndërkohë që znj. M. G., sipas deklarimeve të tij, kishte në zotërim apartamentin në Durrës në pronësi të bashkëshortes së tij.
- Kontrata e shkëmbimit të pjesës takuese të znj. M. G., me apartamentin në pronësi të bashkëshortes së subjektit, është bërë në datën 4.11.2016 pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016.

Si rrjedhojë e konstatimeve të mësipërme ngrihen dyshime të arsyeshme për marrëdhënien e krijuar midis motrës së bashkëshortes së subjektit dhe familjes së tij për blerjen e këtij apartamenti me qëllim justifikimin e burimeve të ligjshme të subjektit.

43.8 Në përfundim të analizës së fakteve dhe provave për këtë pasuri, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e apartamentit në shumën 2.236.145 lekë; (ii) subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

44. Automjet tip “Mercedes Benz C220 CDI”⁴¹ me targa ***. Vlera: 600.000 lekë.

Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat e vitit 2015. Pjesa takuese: në bashkëpronësi me znj. R. H. në ½ pjesë.

Arsyetimi ligjor

44.1 Me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë. 9.6.2015 subjekti ka blerë automjetin tip “Daimler Chrysler” në shumën 600.000 lekë.

⁴¹ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 9.6.2015; shkresë nr. ***, datë 24.10.2016, e Degës së Doganave Durrës.

Nga analiza financiare⁴² konstatohet se subjekti i rivlerësimi ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

45. Garazh me sip. 48 m²⁴³, nr. 8, me dy vende parkimi, ndodhur në Rr. “****”, pallati i firmës “****”, blerës z. Tritan Hamitaj. Vlera: 24.000 euro. Koha e përfitimit viti 2011. Pjesa takuese: në bashkëpronësi me znj. R. H. në ½ pjesë. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: një pjesë e shumës së kthyer nga shoqëria “****” sh.p.k.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- Nuk është deklaruar nga subjekti kontrata e raportuar nga DPPPP-ja, e datës 21.8.2009 për blerje apartamenti me vlerë 12.000 euro, nga shtetasi V. C.. Subjekti ka deklaruar këtë vlerë për blerje garazhi, në vitin 2011.

Arsyetimi ligjor

45.1 Me kontratë shitjeje me kusht nr. ***, datë. 24.12.2011, subjekti ka blerë garazh nr. *** nga z. V. Xh. (pjesa fundore e garazhit, pasi pjesën në hyrje të tij e ka blerë nga pronarët V. dhe V. Ç.) me sip. totale 24 m², në pallatin në rr. “****”, lagjja nr. ***, në çmimin 12.000 euro, nga ku 10.000 euro janë likuiduar sipas kontratës⁴⁴ së shitjes me kusht nr. ***, datë 5.7.2011 dhe pjesa tjetër prej 2.000 euro u likuiduan me nënshkrimin e kësaj kontrate.

45.2 Analiza financiare

	2011
PASURI	1 855 796
Garazh 48 m ² , 2 vende parkimi te pall. Rr. “****”, Durrës	1 659 600
Apartament 51m ² , Rrashbull, Durrës (nga “****”)	5 720 000
Dhënë hua te shoqëria “****” sh.p.k.	-5 720 000
Shlyer huaja nga shoqëria “****” sh.p.k.	0
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>	<i>196 196</i>
Likuiditete gjendje	214 968
Të ardhura dokumentuar	1 685 034
Të ardhura nga paga e subjektit	1 194 908
Të ardhura nga bashkëshortja	490 126
SHPENZIME	1 234 573
Shpenzime jetese	683 100
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	499 473
Shpenzime shkollimi	52 000
Mundësia për kursime	-1 405 335

Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e garazhit në vitin 2011. Për këtë, subjektit iu kalua barra e provës.

45.3 Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, prapësoi se blerja e garazhit me sip. prej 48 m² në vlerën 24.000 euro duhet të llogaritet si pasuri e krijuar në vitin 2011 dhe, njëkohësisht, në

⁴² Shihni analizën financiare.

⁴³ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: kontratë shitjeje me kusht nr. ***, datë 24.12.2011; kontratë shitjeje e thjeshtë e datës 10.6.2011.

⁴⁴Administruar nga noteri publik F. A..

këtë vit duhet të futen si të ardhura shuma e marrë prej 3.500.000 lekë nga shoqëria “****” sh.p.k. në datën 10.1.2011.

Shuma prej 3.500.000 lekë rezulton të jetë marrë në përmbushje të kontratës së huas së lidhur në datën 5.1.2010, e cila maturohej më 28.12.2010 dhe që nuk është përmbushur në këtë datë, por në fillim të vitit tjetër në datën 5.1.2011. Për këtë përmbushje është realizuar shkresa e thjeshtë “shlyerje detyrimi kontraktor”. Nga kjo shkresë rezulton i qartë përfitimi më 10.1.2011 i shumës 3.500.000 lekë, shumë e cila duhet të futet si e ardhur për vitin 2011. Në datën 6.1.2011 shoqëria “****” sh.p.k. ka arkëtuar nga F.P.M., shumën prej 138.696 euro, kësti i fundit i pagesës për blerje toke arë. Administratori B. Dh. ka tërhequr pa përshkrim në datat 6.1.2011 dhe 7.1.2011 shumën prej 48.500 euro. Subjekti ka pretenduar se tërheqja e kësaj shume nga administratori i shoqërisë “****” sh.p.k. tregon se ka pasur aftësi pagueuse për të shlyer detyrimin prej 3.500.000 lekësh. Mungesa e përshkrimit në tërheqjen e kësaj shume vjen në harmoni me shlyerjen e detyrimit të kontratës së huas. Tërheqja e shumës prej 138.696 euro dhe mospasqyrimi i saj në bilanc, ka pretenduar subjekti, tregon se sa të rremë janë në përmbajtje bilancet e shoqërisë “****” sh.p.k. dhe në bazë të nenit 273 të Kodit të Procedurës Civile nuk kanë vlerën e provës në këtë proces.

Subjekti, gjithashtu ka pretenduar se në vitin 2011, së bashku me familjen e tij, kanë udhëtuar në Savona Itali, të ftuar nga djali i dajës së tij, z. V. Xh., që jeton aty. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit në Itali janë paguar nga z. V. Xh.. Si rrjedhojë, këto shpenzime nuk duhet t'i ngarkohen subjektit dhe duhet të zbriten nga analiza financiare.

45.4 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet subjektit, konstaton se nuk janë bindëse. Për sa i përket aftësisë financiare të shoqërisë “****” sh.p.k. për të kthyer huan, Komisioni ka bërë një analizë të detajuar në pikën 52.2 të këtij vendimi. Nga analiza rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huave shoqërisë “****” sh.p.k. dhe rrjedhimisht kthimi i huave nga kjo shoqëri edhe sikur të konsiderohet se ka aftësi pagueuse për këto të ardhura, nuk mund të quhen të ardhura të ligjshme. Komisioni çmon se duhet të zbriten shpenzimet e udhëtimit në Itali në vitin 2011.

Për sa më sipër rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e pasurisë garazh nga z. V. Xh., në shumën 1.255.459 lekë.

45.5 Për të vërtetuar blerjen e një prej garazheve me sipërfaqe 24 m², subjekti ka depozituar, së bashku me deklaratën “Vetting”, kontratën e shitjes (e cila nuk është bërë para noterit) datë 10.6.2011, me palë shitëse z. V. Ç. dhe palë blerëse z. Tritan Hamitaj për blerjen e pjesës së z. V. Ç. me sip. prej 24 m² në garazhin nr. ***, në pallatin në lagjen nr. ***, rr. “****” Durrës, në vlerën 12.000 euro. Nga hetimi ka rezultuar se për këtë garazh është lidhur kontrata e shitjes me kusht nr. ***, në datën 21.8.2009 përpara noterit publik F. S.⁴⁵, me palë shitëse shtetasit V. dhe V. Ç. dhe palë blerëse shtetasit Tritan dhe R. H.. Në këtë kontratë përcaktohet se shuma prej 12.000 euro është likuiduar totalisht nga pala blerëse duke marrë në dorëzim garazhin. Për këtë kontratë ka dhënë pëlqimin edhe shoqëria “****”.

45.6 Subjektit iu kalua barra e provës:

- i. Subjekti ka depozituar së bashku me deklaratën “Vetting” një kontratë shitjeje që nuk pasqyron realitetin e blerjes së pasurisë së paluajtshme garazh, pasi kjo pasuri është blerë në vitin 2009 nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, si dhe nga ana e tyre është paguar edhe shuma prej 12.000 euro.
- ii. Për të njëjtën pasuri, subjekti ka depozituar dy kontrata të ndryshme me të dhëna të njëjta, por me data të ndryshme.

⁴⁵ Shihni shkresën datë 6.6.2020 të noterit publik F. S.

45.7 Në parashtrimet e tij, subjekti sqaron se pas blerjes së garazhit ka pasur probleme në përdorimin e tij nga bashkëpronari tjetër z. V. Xh., prandaj në dhjetor të vitit 2009 ra dakord me z. V. Ç. që të anulojë kontratën e shitblerjes.

Subjekti ka vënë në dispozicion: (i) zgjidhjen e kontratës së shitjes së garazhit me z. V. Ç. datë 26.12.2009; (ii) deklaratë noteriale e z. V. Ç. nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.7.2020 me noter znj. F. A..

45.8 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar prej tij vlerëson se nuk janë bindëse, sepse:

- i. në datën 21.8.2009, përpara noterit publik F. S. është lidhur kontratë shitjeje me kusht nr. ***, me palë shitëse shtetasit V. dhe V. Ç. dhe palë blerëse shtetasit Tritan dhe R. H.. Në këtë kontratë përcaktohet se shuma prej 12.000 euro është likuiduar totalisht nga pala blerëse duke marrë në dorëzim garazhin. Për këtë kontratë ka dhënë pëlqimin edhe shoqëria ****;
- ii. kontrata e lidhur përpara noterit publik nuk rezulton e deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”, por edhe në DVP/2009. Kjo kontratë ka rezultuar vetëm nga hetimi administrativ i Komisionit;
- iii. për të vërtetuar blerjen e një prej garazheve me sip. 24 m², së bashku me deklaratën “Vetting”, subjekti ka depozituar kontratë shitjeje (e cila nuk është bërë para noterit) datë 10.6.2011, me palë shitëse z. V. Ç. dhe palë blerëse subjektin për blerjen e pjesës së z. V. Ç. prej 24 m² në garazhin nr. ***, në pallatin në lagjen ***, Rr. **** Durrës, në vlerën 12.000 euro. Në këtë kontratë nuk rezulton që shoqëria **** sh.p.k. të ketë dhënë pëlqimin për shitjen e kësaj pasurie;
- iv. dokumenti me emërtim zgjidhje e kontratës së shitjes me kusht e datës 26.12.2009 është një dokument, që nuk është depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, pavarësisht se është pyetur specifikisht në lidhje me kontratën me kusht nga Komisioni në datën 11.6.2020 dhe në përgjigjen e tij, nuk ka deklaruar se ekzistonte kjo zgjidhje kontrate;
- v. deklarata noteriale e z. V. Ç. është në nivel deklarativ dhe është hartuar pas kalimit të barrës së provës së subjektit dhe, si e tillë, nuk mund të ketë të njëjtën vlerë provuese si kontrata e shitjes me kusht e lidhur në vitin 2009;
- vi. nga subjekti, në deklaratën “Vetting”, nuk është deklaruar saktësisht kjo marrëdhënie që ka pasur me këtë garazh. Gjithashtu, Komisioni i ka dhënë mundësi që të qartësojë këtë situatë, por subjekti sërish ka refuzuar.

Komisioni vlerëson se subjekti duhet të kishte deklaruar në deklaratën “Vetting” rrethanat faktike të pasurisë garazh, për të cilat ka qenë në dijeni të plotë, duke shfaqur vullnetin e tij për deklarim të saktë. Subjekti nuk duhej të kishte lënë zbulimin ose jo të tyre në kuadër të hetimit administrativ, me qëllim shmangien e përgjegjësisë disiplinore për deklarim të pasaktë në kundërshtim me ligjin.

45.9 Në analizën financiare shuma 12.000 euro do të përfshihet si shpenzim në vitin 2009.

	21.8.2009
PASURI	2 268 568
Garazh 48 m ² , 2 vende parkimi te pallati Rr. ****, Durrës	1 646 040
Dhënë hua te shoqëria **** sh.p.k.	7 800 000
Shlyer huaja nga shoqëria **** sh.p.k.	-4 600 000
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>	-2 577 472
Likuiditete gjendje	63 839

Të ardhura dokumentuar	1 062 975
Të ardhura nga paga e subjektit	748 789
Të ardhura nga bashkëshortja	267 461
Të ardhura nga puna <i>part-time</i> për Institutin e Kulturës Italiane	40 800
Interesa bankare	5 925
Të ardhura nga dhënia e parave me interes	0
SHPENZIME	468 328
Shpenzime jetese	347 352
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	120 976
Mundësia për kursime	-1 673 921

Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e garazhit në vitin 2009 dhe për të provuar të kundërtën, iu kalua barra e provës.

45.10 Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, prapësoi se për të blerë garazhin në vitin 2009 nuk e zotëronte shumën prej 12.000 euro nga të ardhurat e tij. Për këtë shkak ka marrë hua te shoqëria “****” sh.p.k. në datën 20.8.2009, bazuar në kontratën e marrjes hua të kësaj date⁴⁶. Meqenëse në fund të vitit kontrata e shitjes së garazhit me z. V. Ç. u anulua dhe prej tij iu ktheu shuma prej 12.000 euro, këtë shumë ia ktheu mbrapsht shoqërisë “****” sh.p.k. në datën 26.12.2009 me mandatarëkëtimin nr. ***. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se në vitin 2009 ka udhëtuar për në Egjipt nëpërmjet Athinës dhe ky udhëtim ka qenë zyrtar dhe i paguar nga shteti egjiptian. Për këtë, ka vënë dispozicion praktikën e përgjigjes së KLD-së me shkresën nr. *** prot., datë 8.4.2019 për udhëtimin në Egjipt, duke kërkuar zbritjen e shpenzimeve nga analiza financiare.

45.11 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se nuk janë bindëse. Subjekti për herë të parë, pas kalimit të barrës së provës, deklaroi se për blerjen e pasurisë garazh në vitin 2009 ka marrë hua nga shoqëria “****” sh.p.k., duke vënë në dispozicion dhe një dokument me objekt “dhënie hua”, sipas të cilit bashkëshortja e subjektit ka marrë hua nga shoqëria “****” sh.p.k., shumën prej 12.000 euro.

Nga subjekti marrëdhënia e mësipërme nuk rezulton të jetë deklaruar as në deklaratën “Vetting”, por edhe as gjatë procesit administrativ. Komisioni ngre dyshime që këto dokumente janë hartuar gjatë procesit të rivlerësimit me qëllim justifikimin e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit për blerjen e garazhit.

Në lidhje me huan e marrë nga shoqëria “****” sh.p.k., subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues për të provuar se kjo shoqëri ka pasur të ardhura të ligjshme për dhënien e huas. Ky detyrim i buron subjektit nga neni 32/4 i ligjit nr. 84/2016, si dhe nga fakti se këtë hua e ka deklaruar për herë të parë pas mbylljes së hetimit administrativ dhe kalimit të barrës së provës. Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion provues aftësinë paguese të shoqërisë “****” sh.p.k.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti duhet të kishte deklaruar rrethanat faktike të pasurisë garazh, për të cilat subjekti ka qenë në dijeni të plotë, duke shfaqur vullnetin e tij për deklarim të saktë e duke mos e lënë zbulimin ose jo të tyre në kuadër të hetimit administrativ, me qëllim shmangien e përgjegjësisë disiplinore për deklarim të pasaktë në kundërshtim me ligjin.

⁴⁶ Për të provuar marrjen dhe kthimin e kësaj huaje, subjekti ka depozituar mandatarëkëtimin të datës 20.8.2009 dhe mandatarëkëtimin e datës 26.12.2009.

Nga analiza financiare për vitin 2009, pasi u zbritën shpenzimet e udhëtimit, rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë garazh në vlerën 1.552.945 lekë.

45.12 Në DVP/2011 dhe në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar blerjen e këtyre 2 garazheve, duke deklaruar si burim shumën e kthyer nga shoqëria “****” sh.p.k. të dhënë hua prej tij dhe kjo shumë e kthyer nuk mund të shërbejë si burim të ardhurash, pasi subjekti nuk ka provuar aftësinë financiare të kësaj shoqërie, trajtuar në mënyrë të hollësishtme në pikën 52.2 të këtij vendimi.

Në përfundim të analizës së fakteve dhe provave, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e 2 garazheve në shumën 2.808.404 lekë; (ii) subjekti është përpjekur të mos deklarojë në mënyrë të saktë dhe të plotë blerjen e pasurisë garazh nga z. V. Ç..

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

46. Apartament⁴⁷ (ka qenë njësi shërbimi në projekt) 2x126 m², k. ***, nr. ***, *** në projekt, ndodhur në rr. “****” në lagjen ***, pallat shumëkatësh, pa hipotekë, Durrës. Vlera: 88.200 euro. Koha e përfitimit, datë 14.11.2015. Paguar shuma prej 24.400 euro më 17.11.2015, në BKT, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., pa paguar diferencën e vlerës prej 63.800 euro. Blerë nga znj. R. H.. Pjesa takuese: në bashkëpronësi me z. Tritan Hamitaj në ½ pjesë. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: shuma prej 20.000 euro nga të ardhurat e vitit dhe shuma prej 4.400 euro hua nga z. A. H. (vëllai i z. Tritan Hamitaj).

Konstatimi i ILDKPKI-së:

- Është i dyshimtë çmimi i blerjes prej 88.200 euro, i apartamentit me sip. 252 m², në Rr. “****” në Durrës në vitin 2015 (rezultojnë 350 euro/m²).
- Është i dyshimtë fakti i kryerjes së një pagese të vetme me nënshkrimin e kontratës në vitin 2015 (pagesë e padokumentuar nga subjekti në “Vetting”, përveç paraqitjes së kontratës së premtimshitjes) dhe i pjesës më të madhe të pagesës së pakryer dhe me afat deri në regjistrimin e objektit në ZVRPP.

Arsyetimi ligjor

46.1 Me kontratë premtimshitje⁴⁸ datë 14.11.2015, bashkëshortja e subjektit ka blerë nga shoqëria ndërtimore “****” sh.p.k. dhe nga shoqëria porositëse “****” sh.p.k. dy ambiente me sip. totale 252 m² (me nga 126 m² secili) në katin e parë të objektit me nr. *** dhe *** në rr. “****” Durrës, me çmim 88.200 euro. Pagesa do të kryhej me dy këste:

- a. Kësti i parë në shumën prej 24.400 euro (27 % e çmimit të blerjes) do të kryhej me lidhjen e kontratës, në llogari bankare në BKT të shoqërisë “Pepa Group” sh.p.k.

Në datën 17.11.2015⁴⁹ subjekti ka depozituar shumën prej 24.400 euro në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., në BKT, me emërtim “njësi shërbimi kati i parë banimi ***, *** Pallati ***, ndërtues “****” për “****” sh.p.k.

⁴⁷ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) kontratë premtimshitje e datës 14.11.2015; (ii) leje ndërtimi për shoqërinë “****” sh.p.k.

⁴⁸ Deklaruar në DVP/2015.

⁴⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.10.2019, të BKT-së.

b. Kësti i dytë në shumën prej 63.800 euro do të kalonte në të njëjtën llogari në ditën e lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes, pas regjistrimit të objektit në ZVRPP-në Durrës.

Nga hetimi rezulton se subjekti, deri më sot, nuk ka paguar ende vlerën e mbetur të detyrimit, pavarësisht faktit që i përdor dhe i zotëron këto njësi që nga viti 2015, si dhe nga ndërtuesit janë kryer të gjitha punimet e brendshme me shpenzimet e tij.

46.2 Komisioni ka ngritur dyshime që subjekti mund të ketë paguar vlerën e plotë të këtyre njësive, për sa kohë i ka marrë në dorëzim, i shfrytëzon dhe i ka në zotërim të dyja njësitë, që nga viti 2015. Për këtë, subjektit iu kalua barra e provës.

46.3 Në parashtrimet e tij, subjekti prapësoi se lënia e shumës prej 63.800 euro për t'u paguar në momentin e regjistrimit të pallatit në ASHK nuk është një parashikim kontraktor fiktiv, por real. Ky kusht kontraktor ka ndodhur për faktin se shoqëria “***” ka imazh negativ në regjistrimin e pallateve të ndërtuar prej saj. Blerja e një apartamenti pa certifikatë pronësie ka një rrezik të lartë që ndërtuesi ta rishesë shumë herë.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se mund të konsideroheshin bindëse në rast se nga subjekti kjo pasuri nuk do të merrej në zotërim dhe nuk do të shfrytëzohej prej tij që në vitin 2015. Ky pretendim i subjektit duket qartazi i pabazuar, pasi nuk përputhet me asnjë logjikë ekonomike fakti që një ndërtues të marrë vetëm 27 % të pagesës dhe megjithatë t'i japë mundësinë blerësit/subjektit ta marrë në zotërim këtë pronë e ta shfrytëzojë duke përfituar të ardhura nga dhënia me qira për 5 vjet rresht. Parashtrimet nuk e bindin Komisionin dhe duket sikur subjekti nuk ka arritur të rrëzojë dyshimet e ngritura. Për Komisionin, gjithashtu, mbetet e paqartë arsyeja pse subjekti i referohet shoqërisë “***” në lidhje me këto njësi, ndërkohë i ka blerë nga shoqëria “***” sh.p.k.

46.4 Konstatohet se në deklaratën “Vetting”, subjekti i ka deklaruar këto njësi si apartamente. Në lidhje me këtë deklaram subjektit ka sqaruar në përgjigje të pyetësorit nr.1 se në projektin e miratuar në lejen e ndërtimit, i gjithë kati i parë ka qenë njësi ... ndërtuesi pati vështirësi në shitjen e këtij kati dhe ka ndryshuar zbatimin e projektit, duke i kthyer në apartamente, ndryshoi njëkohësisht edhe hyrjen në këtë kat duke e zhvendosur nga përpara që ishte në rrugën “***” (ish-Rr. “***”), prapa te hyrja e banimit. Këto apartamente janë blerë me planimetri të përshtatur dhe gjendja e faktit në përputhje me këtë planimetri.

46.5 Ndërkohë, subjekti deklaron se arsyeja e blerjes së kësaj pasurie ka qenë për t'u përdorur për ushtrimin e veprimtarisë së bashkëshortes së tij. Aktualisht, një nga ambientet përdoret nga shoqëria e thjeshtë “***”⁵⁰ për ushtrimin e aktivitetit të saj, nga viti 2016 e në vazhdim. Ndërkohë, ambienti tjetër bazuar në kontratat e qirasë⁵¹ të dorëzuara nga subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr.1, rezulton se është dhënë me qira si ambient dhe jo si apartament.

Në lidhje me pasuritë e mësipërme, shoqëria “***”⁵² ka sqaruar se në datën 14.11.2015 ka lidhur një kontratë shitjeje për prenotimin e dy apartamenteve, të cilët janë shitur me një çmim të tillë, pasi shoqëria u detyrua të modifikonte ambientet që ishin projektuar për zyra në apartamente banimi, që të ndodhura edhe në katin e parë, nuk shiteshin si zyra apo apartamente. Ndryshimi i destinacionit është kërkuar dhe në ASHK. Përveç sa më sipër, shoqëria ka qenë në vështirësi të mëdha likuiditeti.

Në lidhje me faktin e ndryshimit të destinacionit, nga shoqëria nuk është depozituar asnjë dokument për të provuar se këto pasuri janë kthyer në apartament, si dhe ndonjë kërkesë drejtuar ASHK-së për këtë qëllim. Nga hetimi ka rezultuar se këto ambiente përdoren si njësi

⁵⁰ Ku ortake është bashkëshortja e subjektit.

⁵¹ Kontrata qiraje nr. ***, datë 9.5.2018; nr. ***, datë 22.9.2018; nr. ***, datë 6.7.2017.

⁵² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2020, e protokolluar nga Komisioni.

nga subjekti dhe në kontratën e lidhur midis shoqërisë dhe bashkëshortes së subjektit nuk përcaktohet që kemi të bëjmë me apartament, si dhe nuk parashikohet detyrimi i shoqërisë për të bërë ndryshimin e destinacionit të tyre në ASHK. Në këtë kontratë parashikohet shitja e dy ambienteve, si dhe në asnjë pikë të saj nuk përcaktohet që kemi të bëjmë me apartamente.

Deklarimet e shoqërisë “****” nuk përputhen me kushtet e përcaktuara në kontratën e nënshkruar në datën 14.11.2015, pasi në këtë kontratë më shumë se 70 % e vlerës së këtyre ambienteve është përcaktuar se do të paguhet kur të bëhet regjistrimi i pasurisë.

Duket e palogjikshme që, megjithëse shoqëria pretendon se ishte në mungesë likuiditetesh, ka pranuar të parashikojë në kontratë se, më shumë se 70 % e vlerës së kontratës do të paguhet kur të regjistrohet pasuria. Gjithashtu, pagesa nuk i është kryer shoqërisë “****”, por shoqërisë “****” sh.p.k., duke e bërë të paqartë se si ka përfituar nga kjo shitje shoqëria “****”.

46.6 Në analizë të sa më sipër, duket se ndryshe nga sa ka deklaruar subjekti, njësitë nuk kanë humbur destinacionin e tyre (njësi), pasi janë dhënë me qira dhe përdoren si njësi shërbimi. Për këtë arsye, subjektit iu kalua barra e provës, pasi nuk ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” pasuritë e paluajtshme “njësi”, të cilat i ka deklaruar si apartament.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, prapësoi që ka kryer deklaram se ka blerë apartament, duke u bazuar në gjendjen e faktit të blerjes, dokumentacionit shoqëruar nga shitësi në kontratën e rënë dakord me shitësin dhe nuk ka asnjë dokument që të provojë të kundërtën se këto apartamente në momentin e blerjes kanë qenë njësi. Përdorimi i këtyre apartamenteve për qëllime biznesi dhe qëllimi i blerjes është një gjë tjetër, që nuk duhet të ngatërrohet me atë se çfarë blen.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se nuk mbështeten në prova, por janë në nivel deklarativ dhe nga hetimi ka rezultuar se të dy apartamentet e pretenduar nga subjekti janë përdorur që në momentin e blerjes si njësi, duke e vënë subjektin në kushtet e deklaramit të pasaktë të kësaj pasurie në deklaratën “Vetting”. Subjekti duhej që në deklaratën “Vetting” të shpjegonte qartë pasuritë e tij, ndërkohë që për këto pasuri ka deklaruar se janë apartamente ku në fakt të dy këto pasuri janë shfrytëzuar dhe vazhdojnë të shfrytëzohen si njësi shërbimi.

46.7 Bazuar në udhëzim nr. 4, datë 30.9.2015, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2015”, vlera mesatare e shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për qytetin e Durrësit është 68.540 lekë. Nëse llogarisim vlerën e njësave sipas tregut të lirë të çmimit për apartament është 17.272.080 lekë (të konvertuara 125.478⁵³ euro), ndërkohë çmimi për njësi shërbimi është sa 1.5 vlera e apartamentit 25.908.120 lekë (188.217 euro).

Për sa më sipër, duket se subjekti i ka blerë këto njësi në një çmim më të ulët se çmimi i referencës së tyre. Në lidhje me këtë konstatim subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr.1, sqaron se: *“... arsyet e shitjes poshtë çmimit të referencës për mua është se pallati nuk ishte i regjistruar në ZVPP-në Durrës dhe se ky ndërtues ka imazh jo pozitiv në regjistrimin e pallateve, pasi nuk ka të regjistruar asnjë me sa di unë. Po të paregjistruar kishte edhe shumë pallate të tjerë në Durrës të ndërtuar prej tij. Ditët kalonin dhe me z. A. H. jemi takuar për procedurën e regjistrimit të pallatit te rruga “****”, për të cilën na premtonte vazhdimisht se do ta regjistronte shumë shpejt. Prej tij m’u ofrua çmim joshës pasi ishte më i ulët se tregu. Pasi e diskutova me bashkëshorten këtë ofertë dhe duke ditur faktin se ajo do ta posedonte përditë këtë ambient (për zhvillimin e kurseve të gjuhës së huaj, aktivitet të cilin do ta hapte bashkëshortja), rreziku që ndërtuesi t’ia shiste atë një personi tjetër ishte i vogël, pasi çdo blerës do të shohë pronën më parë se ta blejë dhe do të binte në kontakt me ne”.*

⁵³ 1 euro = 137.65 lekë, Kursi i këmbimit datë 31.12.2015, Banka e Shqipërisë.

Shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe nuk përputhen me deklaratimet e tij për sa i përket destinacionit të kësaj pasurie, e cila është përdorur gjithmonë si njësi shërbimi.

46.8 Analizë financiare

	1/1 deri 17.11.2015
PASURI	3 782 012
Benz C220 CDI DR ****	600 000
Apartament 2x126 m ² , K.***, L.***, Rr. *****, Durrës, bashkëshorten	3 358 660
Shtesa/Pakësime/Likuiditete	-176 648
Likuiditete gjendje	77 267
Të ardhura dokumentuar	5 730 361
Të ardhura nga paga e subjektit	1 412 466
Të ardhura nga bashkëshortja	507 985
Të ardhura nga puna <i>part-time</i> për Institutin e Kulturës Italiane	118 000
Të ardhura si kujdestare e paaftësisë për fëmijën	99 260
Marrë hua nga vëllai A. H. (2014 dhe 2015)	605 660
Të ardhura nga pensioni i paaftësisë së djalit	111 210
Të ardhura nga kontrata e donacionit për djalin	600 000
Të ardhura nga qiratë	969 000
Interesa bankare	3 367
Të trashëguara/të dhuruara	994 331
Të ardhura nga vizita ngushëllimi për nënën e bashkëshortes	200 000
Të ardhura nga toka bujqësore	109 083
SHPENZIME	2 770 859
Shpenzime jetese	983 128
Shpenzime të posaçme për djalin (sipas kontratës së donacionit)	1 100 000
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	179 257
Shpenzime shkollimi	63 000
Paguar kredia tek Alpha Bank 50.000 euro	439 474
Shpenzime të tjera (për trashëgiminë ligjore)	6 000
Mundësia për kursime	-822 509

Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtyre pasurive.

Nga shoqëria **** është sqaruar se në datën 14.11.2015 ka lidhur një kontratë shitjeje për prenotimin e dy apartamenteve, të cilët janë shitur me një çmim të tillë pasi shoqëria u detyrua të modifikonte ambientet që ishin projektuar për zyra në apartamente banimi, që të ndodhura edhe në katin e parë nuk shiteshin si zyra apo apartamente.

Shoqëria ka depozituar kontratë dorëzimi të datës 19.1.2016, ku deklarohet se janë dorëzuar apartamente me nr. I- *** dhe I-***.

Për të justifikuar çmimin, shoqëria ka depozituar kontrata të ngjashme, si vijon:

Kontratë	Lloji i pasurisë	Çmimi	Çmimi/m ²
***	Apartament 131.8 m ²	6,000,000 lekë	45,523.5 lekë
***	Apartament 79.6 m ²	30.000 euro	376 euro

2559/879	Apartament 79.6 m ²	30.000 euro	376 euro
Kontratë datë 23.8.2010 Konstruksion ***	Apartament 150 m ²	60.000 euro Paguat 51.553 euro	400 euro
Kontratë datë 5.11.2016 Konstruksion ***	Njësi 134.85 m ²	21.000 euro	155.7 euro
*** *** Konstruksion	Njësi 91.96 m ²	30.000 euro	326 euro

Pavarësisht argumentimit të mësipërm është e paqartë se për çfarë arsyeje shoqëria “***” ka deklaruar se ka pasur mungesë likuiditetesh, prandaj e ka shitur me një çmim më të ulët, duke marrë në konsideratë faktin që nuk është përfituesja e çmimit të paguar, për më tepër që deri tani është paguar vetëm 27 % e çmimit.

46.9 Në përfundim të hetimit, Komisioni konstaton se:

- i. subjekti i rivlerësimit i ka blerë dy pasuritë e mësipërme me një çmim më të ulët se vlera e tregut;
- ii. duket sikur kemi të bëjmë me një veprimi financiare të pajustificuar dhe të pambështetur në parimet e ekonomisë së tregut (parimi i fitimit), përderisa shitësi shet mallin me një çmim shumë më të ulët;
- iii. subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e pasurive të mësipërme.

46.10 Pas kalimit të barrës së provës subjekti prapësoi se:

a. Çmimi i referencës nuk është çmim tregu, por orientues i nxjerrë nga shteti për qëllime fiskale dhe nuk mund të ketë vlerë të paracaktuar. Arsyet e tjera janë të lidhura me shitësin. Nga përgjigja rezulton se shoqëria “***” ka pasur vështirësi financiare, çka provon faktin se çmimi është përcaktuar nga tregu dhe nga nevojat e palëve.

Komisioni konstaton se subjekti në të gjitha prapësimet e tij i referohet shoqërisë “***”, ndërkohë që nuk rezulton që kjo shoqëri të jetë përfituese e pagesës së çmimit të blerjes së këtyre njësive, pasi bazuar në kontratën e premtimshitjes, si dhe në lëvizjen e llogarive bankare rezulton se pagesa është bërë në favor të shoqërisë shoqërisë “***” sh.p.k., e cila ka qenë edhe porositiesja fillestare e këtyre apartamenteve. Shoqëria “***” sh.p.k. këto dy njësi i ka fituar në formën e *kleringut*, pasi ka kryer punime në kantierët e shoqërisë “***”. Në kontratë thuhet shprehimisht se shoqëria “***” sh.p.k. ia shet bashkëshortes së subjektit këto njësi. Për sa më sipër, shpjegimet e subjektit në lidhje me çmimin e këtyre njësive nuk qëndrojnë.

Nga shqyrtimi i të gjitha kontratave të përmendura nga subjekti për të justifikuar vlerën e çmimit të ulët, në asnjërën prej tyre nuk është përcaktuar se do të parapaguhet vetëm 27 % e çmimit të blerjes, fakt ky që nuk mbështet nevojën për likuiditete të shoqërisë “***” sh.p.k.

b. Në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare, subjekti ka prapësuar se:

b.1 Në analizën financiare të momentit të blerjes së apartamenteve në datën 17.11.2015 rezulton se është futur si e ardhur nga kontratë donacioni për djalin shuma 600.000 lekë dhe shpenzim prej 1.100.000 lekë, duke krijuar një diferencë prej 500.000 lekësh si shpenzim i kryer më tepër nga ana e tij.

Në lidhje me këtë pretendim Komisioni e ka analizuar në pikën 43.3.2 germa “d.1” të këtij vendimi.

b.2 Të ardhurat *bruto* nga qiratë janë në shumën 6.000 euro dhe 300.000 lekë. Gjatë këtij viti nuk është paguar tatimi i kësaj shume dhe kjo e ardhur duhet të përfshihet *bruto* në këtë analizë.

Shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe në analizë është përfshirë e gjithë shuma. Tatimi i paguar për këto të ardhura është përlllogaritur në vitin 2016.

b.3 Në lidhje me shpenzimet e udhëtimit në Itali të shtetasve R. dhe J. H., në vitin 2015 është llogaritur si shpenzim shuma prej 526 euro. Në këtë udhëtim, duke u bazuar në të dhënat e sistemit *TIMS*, rezulton se bashkëshortja e tij ka udhëtuar e vetme pa djalin J. H.. Bashkëshortja e subjektit ka qëndruar në banesën e znj. O. B. dhe, për këtë, ka paraqitur si provë deklaratën noteriale të kësaj shtetaseje, në Pisa Itali, datë 20.7.2020. Ky pretendim i subjektit është marrë në konsideratë, duke e zbritur në analizën financiare.

Komisioni, pasi analizoi prapësimet e subjektit, ka zbritur nga analiza financiare shpenzimet e udhëtimit, si dhe ka përfshirë në vlerë të plotë të ardhurat nga qiraja. Subjekti i rivlerësimit, sërish, rezulton në pamundësi financiare në shumën 605.834 lekë.

46.11 Në lidhje me mobilimin, subjekti ka deklaruar se njësia I-A1 ka shpenzime mobilimi në funksion të ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë “****” në shumën, afërsisht 1.000.0000 lekë, të kryera në vitin 2016.

46.12 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit në lidhje me këto njësi dhe provat e administruara, çmon se:

- i. Subjekti nuk ka qenë i saktë në deklaratimet e tij në lidhje me këto pasuri, pasi e ka deklaruar si apartament, ndërkohë janë përdorur si njësi.
- ii. Subjekti ka referuar gjithmonë se këto apartamente i ka blerë nga shoqëria “****”, ndërkohë që i ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k.
- iii. Të dy njësitë janë marrë në dorëzim nga subjekti dhe shfrytëzohen prej tij, duke përfituar edhe të ardhura, ndërkohë që sipas dokumentacionit është paguar vetëm 27 % e vlerës së tyre.
- iv. Në të gjitha kontratat e depozituara, që janë administruar për efekt krahasimor nuk rezulton që të jetë paguar vetëm 27 % e vlerës së çmimit të apartamentit/njesisë së blerë.
- v. Subjekti nuk provoi se vlera e ulët e blerjes ka ardhur si pasojë e mungesës së likuiditeteve, ky pretendim i tij bie ndesh me faktin e parapagesës së vetëm 27 % të çmimit që nga viti 2015 e deri sot.

Për sa më sipër krijohen dyshime se subjekti nuk ka deklaruar saktë këtë pasuri në deklaratën “Vetting”.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtyre njësive në shumën 605.834 lekë; (ii) subjekti është përpjekur të mos deklarojë në mënyrë të saktë dhe të plotë pasuritë njësi/apartament; (iii) mbeten dyshimet që subjekti mund të ketë fshehur faktin e pagesës së një vlere më të lartë se ajo që ka paguar sipas kontratës.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarin të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

47. Dy vende parkimi të blerë nga znj. R. H., nr. *** dhe ***, ndodhur në rr. “****”, lagjja ***, pallat i ndërtuar nga shoqëria “****”, pa hipotekë Durrës. Vlera: 8.000 euro. Koha e përfitimit datë 23.1.2016. Pjesa takuese: në bashkëpronësi me z. Tritan Hamitaj në ½ pjesë. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat e vitit 2016.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- Subjekti ka deklaruar sa është parashikuar në kontratë, e cila është kontratë e thjeshtë, jonoteriale, ku nuk është përcaktuar sipërfaqja e garazheve, por vendndodhja, numri dhe çmimi. Shuma nga Alpha Bank rezulton të jetë tërhequr një ditë para kontratës së sipërmarrjes.

Arsyetimi ligjor

47.1 Me kontratën e sipërmarrjes datës 23.1.2016 bashkëshortja e subjektit ka porositur dy vende automjetesh me nr. *** dhe ***, në objektin në lagjen ***, rr. “***” Durrës, çmimi 8.000 euro.

Pagesa për këto parkime në shumën 8.000 euro vërtetohet me mandatarkëtimin nr. ***, datë 30.5.2016, nga znj. R. H. në shoqërinë “***” sh.p.k.

47.2 Duke krahasuar çmimin e dy vendeve të parkimit të blerë në vitin 2011 (blerë për shumën 24.000 euro) me vlerën e blerjes së këtyre vendparkimeve rezulton se janë blerë në një vlerë 3-fish më të ulët. Në lidhje me këtë konstatim subjekti sqaron: “*Postet e parkimit të përcaktuara në kontratë me nr. *** dhe *** nuk kanë asnjë krahasim me garazhin e blerë në rrugën ‘***’.* Në të parin kemi poste parkimi në një plate betoni pa ndarje dhe të pashtruar, ndërsa në të dytin është ambient i mbyllur me mur dhe qepen, i cili mund të kryejë shumë funksione jo vetëm për parkim makine; sipërfaqja e dy posteve është 30.26 m², ndërsa i garazhit është 48 m², pra 17.74 m² më pak; vendndodhja e tyre është e ndryshme; koha e ndryshme e blerjes dhe, si rrjedhim çmimi i tregut ndryshon; shitës të ndryshëm, çka do të thotë se arritja e marrëveshjes është e ndryshme.”

47.3 Nga subjekti, në deklaratën “Vetting”, nuk është deklaruar sipërfaqja e këtyre dy vendparkimeve dhe në përgjigje të pyetësorit nr.1, ka sqaruar se sipërfaqja e tyre është 30.26 m², e cila është përcaktuar në aktin e dorëzimit.

47.4 Analizë financiare

	30.5.2016
PASURI	1 662 662
2 poste parkimi L.***, rr. ***, Durrës, bashkëpronësi 1/2 mbashkëshorten	1 082 160
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>	580 502
Likuiditete gjendje	764 270
Të ardhura dokumentuar	2 753 166
Të ardhura nga paga e subjektit	818 122
Të ardhura nga bashkëshortja	231 843
Të ardhura nga puna <i>part-time</i> për Institutin e Kulturës Italiane	126 000
Të ardhura si kujdestare e paaftësisë për fëmijën	40 120
Të ardhura nga pensioni i paaftësisë për vete fëmijën	40 120
Të ardhura nga kontrata e donacionit për djalin	250 000
Të ardhura nga qiratë	163 200
Interesa bankare	1 600
Të ardhura të tjera	1 082 160
SHPENZIME	991 642
Shpenzime jetese	483 066
Shpenzime të posaçme për djalin (sipas kontratës së donacionit)	250 000
Paguar këste për kredinë tek Alpha Bank	258 577
Mundësia për kursime	98 861

47.5 Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

Në përfundim, deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

48. Posedues i apartamentit me sip. 146.3 m², të ndodhur në rr. “****”, lagjja ***, kati i dytë banim me nr. *** në projekt, ndërtuar nga shoqëria “****”, kulla perëndimore, pa hipotekë, Durrës. Apartamenti është i kontraktuar me kontratë me kusht nga z. Rr. H.. Burimi sipas deklaratës “Vetting”: nuk deklarohet.

Konstatimi i ILDKPKI-së:

- Apartamenti i deklaruar nuk është konfirmuar nga ZVRPP-ja, pasi është deklaruar në emër të babait të subjektit, i cili nuk ka deklaruar arsyeja e posedimit dhe as burimin financiar të babait për blerjen e tij. Gjithashtu, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues ligjor lidhur me këtë pasuri, fitimin e saj dhe burimin e krijimit.

Arsyetimi ligjor

48.1 Subjekti, në DVP/2016, deklaroi që zotëron së bashku me bashkëshorten apartamentin me sip. 146.3 m², të ndodhur në rr. “****”, lagjja nr. ***, kati i dytë i banimit Durrës. Apartamenti është i kontraktuar me kontratë me kusht nga z. Rr. H..

48.2 Nga hetimi ka rezultuar se ky apartament është blerë në datën 31.12.2016 me kontratën nr. *** nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. Rr. H., nga shtetasi B. Dh., i cili ka qenë njëkohësisht ortak dhe administrator i shoqërisë “****” sh.p.k. Çmimi i blerjes është përcaktuar 73.150 euro, nga të cilat 7.000 euro janë likuiduar, ndërsa pjesa tjetër do të likuidohet jo më vonë se 3 vjet nga data e nënshkrimit të kontratës.

48.3 Analizë financiare për babanë e subjektit

	para 2016	2016	2017	2018	2019
PASURI	2 147 822	946 875	-367	616 520	6 184 151
Ap. sip.146,3 m ² , rr. ***, Durrës		946 890		2 617 926	6 330 185
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>	2 147 822	- 15	-367	-2 001 406	-146 034
Likuiditete gjendje		2 147 807	2 147 440	146 034	0
Të ardhura dokumentuar	12 144 780	619 743	640 015	639 766	639 766
Të ardhura nga paga e nënës	3 744 286	271 580	280 744	280 744	280 744
Të ardhura nga babai	7 446 856	347 248	359 022	359 022	359 022
Interesa bankare	105 271	915	249		
Nga shitja e pasurive/dëmshpërblime	848 366				
SHPENZIME	4 987 356	470 184	476 108	492 551	492 551
Shpenzime jetese	4 987 356	470 184	476 108	492 551	492 551
Mundësia për kursime	5 009 602	-797 316	164 275	-469 306	-6 036 936
Mundësia për kursime kumulative	5 009 602	4 212 286	4 376 561	3 907 255	-2 129 681

Metodologjia e përdorur është ajo kumulative.

- vlera e apartamentit për vitet 2016 dhe 2018 janë vendosur vlerat e paguara sipas mandatpagesave dhe kontratës së vënë në dispozicion nga subjekti. Pjesa e mbetur është konsideruar si e paguar në vitin 2019⁵⁴;
- të ardhurat e prindërve nga pagat⁵⁵ dhe pensionet⁵⁶. Të ardhurat e viteve 2018 dhe 2019 janë barazuar me ato të vitit 2017;
- shpenzimet e jetesës për 2 persona: deri në fund të vitit 1999, përlllogaritur si 50 % e të ardhurave familjare; nga viti 2000 e në vijim sipas standardit të ILDKPKI-së.

Nga analiza financiare rezulton se babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën 2.129.681 lekë për blerjen e këtij apartamenti.

48.4 Në lidhje me këtë apartament subjektit të rivlerësimit i është kërkuar informacion i detajuar, i cili në përgjigje të pyetësorit nr.1 ka sqaruar se *apartamenti ndodhet në të njëjtin kat me apartamentin që ka në pronësi subjekti në të njëjtën godinë dhe kanë mure të përbashkëta, por nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën. Në lidhje me arsyen e blerjes subjekti sqaron se prindërit donin të jetonin në Durrës. Aktualisht ata posedojnë apartamentin e tij me sipërfaqe 86 m², pasi kanë nevojë për sipërfaqe banimi me më pak metra katror.*

48.4.1 Shpjegimet e subjektit, në lidhje me këtë apartament, nuk janë bindëse. Duke iu referuar hetimit rezulton se:

- babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti;
- ky apartament nuk është përdorur asnjëherë nga babai i subjektit, pavarësisht se është blerë prej tij;
- ky apartament është në të njëjtin kat dhe lidhet me apartamentin tjetër në pronësi të subjektit të rivlerësimit;
- ky apartament është përdorur gjithmonë nga subjekti i rivlerësimit;
- prindërit e subjektit, sipas deklaramentit të tij, nuk kanë nevojë për sipërfaqe banimi me më shumë metra katror;
- prindërit e subjektit jetojnë në një apartament tjetër në pronësi të subjektit;
- ky apartament është blerë nga z. B. Dh. ish-ortak dhe administrator i shoqërisë “***” sh.p.k., me të cilën subjekti ka një marrëdhënie huamarrje për një periudhë të gjatë kohore (trajtuar më poshtë).

48.4.2 Për sa më sipër ngrihen dyshime që ky apartament është në pronësi të fshehur të subjektit të rivlerësimit. Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën.

48.4.3 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti prapësoi se:

a. Në lidhje me pagesat e kësteve të blerjes së apartamentit nga z. Rr. H.:

Në datën 31.12.2016, moment kur është lidhur kontrata e shitblerjes nga blerësi Rr. H., është paguar shuma prej 7.000 euro, si vijon:

- në datën 4.1.2018 është paguar nga z. Rr. H. shuma prej 2.000.000 lekë;
- në datën 26.3.2018 është paguar nga z. Rr. H. shuma prej 5.000 euro;
- në datën 26.3.2020 është paguar nga z. Rr. H. shuma prej 5.200 euro;

⁵⁴ Subjekti në përgjigjet e pyetësorit të datës 30.4.2020 deklaroi se: “Kontrata ka të parashikuar pagesën me këste brenda tre vjetëve nga dita e lidhjes së saj. Tani, vlera e plotë është shlyer”, por pa specifikuar se kur është shlyer.

⁵⁵ Shkresat nr. ***, datë 10.5.2018, për pagën për nënën nga 1/1994 – 8/2001, nga ISSh-ja Fier dhe nr. ***, datë 10.5.2018 për pagën për babanë 1/1994 – 6/2011, nga ISSh-ja Fier.

⁵⁶ Shkresat nr. *** +***+***, datë 26.4.2018 nga pensioni i nënës për periudhën 9/2001 – 4/2018, nga ISSh-ja Fier; nr. *** +***, datë 25.4.2018 pensioni i babait nga 7/2011 – 4/2018, nga ISSh-ja Fier.

- në datën 25.3.2020 është paguar nga z. Tritan Hamitaj shuma prej 40.940 euro.

b. Në lidhje me dyshimet për pasuri të fshehur:

Prindërit e subjektit vendosën të jetojnë në Durrës dhe në këtë qytet nuk dispononin banesë, ky ka qenë shkaku që babai i tij vendosi të blejë këtë apartament. Duke qenë se kishte nevojë për sipërfaqe banimi më të madhe se apartamenti që dispononte, pasi tashmë ishte me tre fëmijë dhe në moshë jo të vogël, do duhej të blinte një apartament me sipërfaqe më të madhe dhe të shiste atë që kishte në pronësi, veprime këto që kanë kosto fiskale dhe noteriale. Nga ana tjetër babai i subjektit do të blinte apartamentin e nevojshëm për të, po përsëri do të kishte kosto noteriale etj.

Për të shmangur kostot e tepërta ranë dakord që babai të jetonte te banesa e subjektit, pasi kishte sipërfaqe të mjaftueshme për dy veta dhe ai të blinte një apartament me sipërfaqe të nevojshme për të (kuptohej se sipërfaqja e tepërt do të vlerësohej me mirëkuptim më vonë, pasi çmimi nuk do të jepej i gjithi nga babai në momentin e blerjes).

Subjekti ka depozituar, së bashku me prapësimet, dy mandatarkëtime si vijon:

- i. datë 25.3.2020, paguar shuma prej 40.940 euro në favor të z. B. Dh. me referencë z. Tritan Hamitaj për z. D. B. kalim për përmbushje të detyrimit të babait të tij z. Rr. H., kjo shumë i jepet hua babait pa interes;
- ii. datë 26.3.2020 paguar shuma prej 5.200 euro në favor të z. B. Dh. nga z. Rr. H..

48.4.4 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se:

- i. subjekti, ndryshe nga sa ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, pas prapësimeve ka pranuar faktin se apartamenti i porositur nga babai i tij është blerë realisht për nevojat e subjektit të rivlerësimit;
- ii. subjekti, në deklaratën “Vetting”, nuk ka deklaruar faktin se prindërit e tij kanë në përdorim apartamentin në pronësi të tij;
- iii. subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, edhe pse është pyetur nga Komisioni në lidhje me këtë apartament, ka fshehur faktin se i ka dhënë hua babait të tij shumën 40.940 euro për shlyerjen e plotë të pagesës së këtij apartamenti;
- iv. ky apartament nuk është përdorur asnjëherë nga babai i subjektit, pavarësisht se është blerë prej tij;
- v. ky apartament është në të njëjtin kat dhe lidhet me apartamentin tjetër në pronësi të subjektit të rivlerësimit;
- vi. ky apartament është përdorur gjithmonë nga subjekti i rivlerësimit.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti duhet të kishte deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit rrethanat faktike të pasurisë apartament, për të cilat ka qenë në dijeni të plotë, duke shfaqur vullnetin e tij për deklarim të saktë e duke mos e lënë zbulimin ose jo të tyre në kuadër të hetimit administrativ, me qëllim shmangien e përgjegjësisë disiplinore për deklarim të pasaktë në kundërshtim me ligjin.

Komisioni çmon se sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, nuk ka qenë bashkëpunuese, pasi nuk ka deklaruar saktë burimet që kanë shërbyer për shlyerjen e këtij apartamenti, si dhe faktin që ka paguar shumën 40.950 euro për këtë apartament. Komisioni çmon se kjo sjellje duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të analizës së fakteve dhe provave, Komisioni vlerëson se subjekti është përpjekur të mos deklarojë në mënyrë të saktë dhe të plotë pasurinë apartament. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në

kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germave “a” dhe “b” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

49. Subjekti ka deklaruar gjendje në llogaritë bankare:

- gjendje⁵⁷ në llogarinë rrjedhëse nr. ***, në Alpha Bank në datën 23.1.2017, shuma 53.912 lekë në emër të z. Tritan Hamitaj;
- gjendje në llogarinë rrjedhëse nr. ***, në Alpha Bank në datën 23.1.2017, shuma 25.7 euro në emër të z. Tritan Hamitaj;
- gjendje në llogarinë rrjedhëse nr. ***, e znj. R. H., në BKT, shuma 987 lekë, datë 23.1.2017;
- gjendje në llogarinë rrjedhëse e z. A. H., në Raiffeisen Bank në datën 23.1.2017, shuma 76 lekë;
- gjendje në llogarinë rrjedhëse e znj. R. H., në Raiffeisen Bank, datë 23.1.2017, shuma 86 lekë;
- gjendje në llogarinë rrjedhëse në Raiffeisen Bank të shoqërisë së thjeshtë “****” (R. H. zotëron 50 % të saj). Gjendja në datën 31.12.2016, shuma prej 1.050.250 lekësh.

Konstatimi i ILDKPKI-së:

- Subjekti nuk ka deklaruar depozitën me gjendje në shumën 146.418 lekë, në datën 27.1.2017, në Alpha Bank.

Arsyetimi ligjor

49.1 Bazuar në shkresën e Alpha Bank rezulton se subjekti ka llogari:

- në euro gjendja 25.7 euro;
- në lekë gjendja 53.913.33 lekë;
- depozitë me gjendje 146.418 lekë, kjo depozitë nuk rezulton e deklaruar në deklaratën *Vetting*.

49.2 Bazuar në shkresën e BKT-së rezulton se bashkëshortja e subjektit ka llogari me gjendje në shumën 987.25 lekë.

49.3 Bazuar në shkresën e Raiffeisen Bank rezulton se:

- djali i subjekti ka llogari me gjendje në shumën 76.13 lekë;
- bashkëshortja e subjektit ka llogari me gjendje në shumën 86.6 lekë;
- bazuar në nxjerrjen e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në Raiffeisen Bank rezulton se nga shoqëria “****”: në datën 27.2.2017 i është transferuar shuma 500.000 lekë, e cila përfaqëson fitimin e vitit 2016; dhe në datën 22.10.2018 i është transferuar shuma prej 562.659 lekësh, e cila përfaqëson fitimin e vitit 2017.

50. Gjendje *cash* në shumën 860.000 lekë.

Në fund të vitit 2016 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* shumën prej 980.000 lekësh. Shuma 860.000 lekë në deklaratën *Vetting* vjen si pakësim i kursimeve *cash* nga dhjetori i vitit 2016.

⁵⁷Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: vërtetim nr. ***, datë 23.1.2017, nga Alpha Bank; vërtetim nr. ***, datë 23.1.2017 i BKT; nxjerrje llogarie e z. A. H., në Raiffeisen Bank, datë 14.10.2016, për periudhën 24.5.2013 – 14.10.2016, për kalimin e pagesës së paaftësisë, me gjendje 76 lekë; nxjerrje llogarie e z. A. H., në Raiffeisen Bank, e datës 23.1.2017, për periudhën 1.1.2017 – 23.1.2017, për kalimin e pagesës së paaftësisë, me gjendje 76 lekë; nxjerrje llogarie e znj. R. H., në Raiffeisen Bank e datës 14.10.2016, për periudhën 2.11.2006 – 14.10.2016, llogari page, me gjendje 45 lekë; nxjerrje llogarie e znj. R. H., në Raiffeisen Bank e datës 26.1.2017, për periudhën 15.10.2016 – 26.1.2017, llogari page me gjendje 86 lekë; nxjerrje llogarie e tatimpaguesit “****”, në Raiffeisen Bank, e datës 26.1.2017, për periudhën 28.1.2016 – 31.12.2016, me gjendje 1.050.044 lekë.

Për sa i takon mundësisë që subjekti ka pasur për të krijuar gjendjen *cash* në fund të vitit 2016, rezulton se nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme (shihni analizën e vitit 2016 te tabela përmbledhëse në fund).

51. Në lidhje me shoqërinë e thjeshtë “****”

Rezultatet e hetimit⁵⁸

51.1 Referuar shkresës së QKB-së rezulton se bashkëshortja e subjektit figuron ortake me 50 % të kuotave në shoqërinë “****” me formë ligjore shoqëri e thjeshtë.

51.2 Bazuar në shkresën e DRT-së Durrës rezulton se tatimpaguesi “****” me NIPT ***, ka adresë: Rr. “****”, p. “****”, nr. ***, k. ***, ap. ***, z.k. ***. Objekti i aktivitetit: kurse të gjuhëve të huaja. Statusi aktiv që prej datës 21.1.2016. Vendi ku ushtron aktivitetin bashkëshortja e subjektit është njësia me sip. 252 m² e blerë me kontratë premtimshitje të datës 14.11.2015.

51.3 Tatimpaguesi, shoqëria “****”, është i regjistruar në përgjegjësi tatimore tatim- fitimi i thjeshtuar, si vijon:

Viti	Fitimi në lekë
2016	1,328,345
2017	1,143,319
2018	1,490,217
2019	856,636

51.4 Për vitin 2016, sipas Vendimit të Asamblesë së shoqërisë së thjeshtë “****”, i datës 2.2.2017, vendoset ndarja e fitimit të kësaj shoqërie prej 1.000.000 lekësh, duke përfituar znj. Iliriana Kupe shumë prej 500.000 lekësh dhe znj. R. H. shumë prej 500.000 lekësh. Kështu, fitimi i shoqërisë nuk është përfshirë në të ardhurat e vitit 2016, pasi është derdhur në llogarinë e bashkëshortes së subjektit në shkurt të vitit 2017.

52. Në lidhje me të ardhurat

Hetimi i kryer nga Komisioni⁵⁹

52.1 Të ardhurat nga qiraja

52.1.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti deklaron të ardhura nga qiraja e apartamentit me nr. pasurie ***, në shumë 14.283 euro. Subjekti ka vënë në dispozicion:

- i. kontratë qiraje datë 13.8.2014, nëpërmjet së cilës subjekti ka dhënë me qira apartamentin me nr. pasurie ***, me sip. 103.82 m² për një afat 1-vjeçar, për shumë 500 euro;
- ii. shkresë të thjeshtë me emërtim “pagesë qiraje”, datë s’ka, ku deklarohet se znj. F. J. ka marrë me qira apartamentin në Rr. “****” në pronësi të z. Tritan Hamitaj dhe i ka dhënë në dorë qiradhënësit shumë 6.000 euro për vitin 2015;
- iii. shkresë të thjeshtë me emërtim “pagesë qiraje”, ku deklarohet se znj. F. J. ka marrë me qira apartamentin në Rr. “****” në pronësi të z. Tritan Hamitaj dhe të tjerë, me shënimin “sot më 23.12.2014 i jap qiradhënësit shumë totale për vitin 2014, 2283 euro.”;

⁵⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 17.9.2019, drejtuar QKB-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.9.2019, nga QKB-ja; shkresë nr. *** prot., datë 9.3.2020, drejtuar DRT-së Durrës; kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 26.3.2020, nga DRT-ja Durrës.

⁵⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 9.3.2020, drejtuar DRT-së Durrës; kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 2.4.2020, nga DRT-ja Durrës.

iv. kontratë qiraje datë 1.1.2016, nëpërmjet së cilës subjekti ka dhënë me qira apartamentin me nr. pasurie ***, me sip. 103.82 m² për një afat 1-vjeçar për shumën 6.000 euro/vit. Pagesa vërtetohet nga nxjerrja e llogarisë në Alpha Bank të shtetasve Tritan Hamitaj, A. G., R. H. dhe M. G., nga ku rezulton se në datën 28.9.2016 është depozituar shuma 6.000 euro e plotë.

52.1.1.1 Komisioni ka konstatuar se në të njëjtën ditë që bashkëshortja e tij së bashku me motrën e saj ka blerë apartamentin, subjekti e ka dhënë me qira, pa qenë bashkëpronar.

52.1.1.2 Në lidhje me këtë pikë, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr.1, ka sqaruar se: *“Shitësi i kishte premtuar se do të realizonim shitblerjen më herët se data 13 gusht, por u vonua në marrjen e certifikatën e pronësisë së apartamentit. Ndërkohë ai kishte siguruar qiramarrësin, dhe i kisha premtuar se do ta merrte atë me qira më herët se data e shitjes, duke besuar në fjalën e shitësit. Me realizimin e kontratës së shitblerjes dhe pagesën e një pjese të mirë të çmimit të apartamentit, dhe njëkohësisht kredia ishte miratuar, nga shitësi nuk u prit edhe pagesa e fundit, por iu dorëzua apartamenti në datën 13.8.2014”*.

52.1.1.3 Ky deklaram i subjektit nuk përputhet me dokumentacionin e administruar nga ku rezulton se certifikata e pronësisë së apartamentit është lëshuar në emër të shitësit të tij, znj. A. G., që në datën 10.7.2014, pra, gati një muaj para se të lidhej kontrata e shitblerjes, duke bërë të pavlefshëm deklaramin e subjektit.

52.1.1.4 Në këto kushte, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për dyshimet se:

- i. subjekti ka kryer deklaram të rremë përpara Komisionit në lidhje me shkakun e lidhjes së kontratës së qirasë në të njëjtën ditë me kontratën e shitblerjes;
- ii. subjekti, në mënyrë fiktive me qëllim justifikimin e të ardhurave të tij, ka deklaruar se e ka dhënë me qira apartamentin që në momentin e blerjes.

Pas kalimit të barrës së provës subjekti prapësoi se data 10.7.2014 është e vërtetë që pasqyron datën e lëshimit të certifikatës së pronësisë në emër të shitësit, por kjo nuk do të thotë se shitësi ka marrë dijani po në këtë datë për nxjerrjen e saj. Edhe pasi shitësja ka marrë informacionin për nxjerrjen e certifikatës së pronësisë janë vonuar disa ditë për të rakorduar me njëri-tjetrin për t’u paraqitur te noteri. Subjekti ia kishte premtuar qiramarrësit se apartamentin do ta merrte me qira më herët se data e shitjes.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se nuk janë bindëse. Nga subjekti nuk është depozituar asnjë provë për të vërtetuar deklaramet e tij, si dhe për të vërtetuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

52.1.2 Në deklaramen “Vetting” subjekti deklaroi të ardhura nga qiraja e apartamentit *** me sipërfaqe 78.24 m², duke filluar nga data 5.3.2014, në shumën 820.000 lekë. Subjekti ka vënë në dispozicion:

- kontratë qiraje datë 5.3.2014, nëpërmjet së cilës subjekti ka dhënë me qira apartamentin me sip. 78 m², kati i dytë i banimit me pamje nga Vila *** për shumën 25.000 lekë/muaj, me afat 1 vit;
- shkresa e thjeshtë me emërtim “pagesë qiraje” datat: 20.8.2016; 20.1.2016; 10.9.2015; 10.1.2015; 1.12.2014 dhe 5.3.2014 për të vërtetuar shlyerjen e vlerës së qirasë.

52.1.2.1 Nga hetimi ka rezultuar se në po të njëjtën datë që subjekti ka blerë këtë apartament e ka dhënë me qira. Në lidhje me këtë konstatim subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr.1, sqaron se: *Ndërkohë që ishte arritur marrëveshja e blerjes dhe pritej formalizimi te noteri ndodhën vonesa të rëndomta në përcaktimin e datës që mund të ishin të lirë të dy palët për të vajtur te noteri dhe lidhur kontratën, dhe shkaqe neglizhence të cilat tani nuk i kujtohen. Nga momenti i arritjes së marrëveshjes me gojë për çmimin ai mbliidhte informacion se kush mund ta merrte*

me qira. Rezultoi se kishte kërkesa për qira dhe ai pati mundësinë të zgjedhë dhe ta jap menjëherë nga momenti i blerjes.

52.1.2.2 Këto deklarime të subjektit nuk janë bindëse dhe nuk shoqërohen me prova, për më tepër që janë përpara një rasti të përsëritur. Komisioni ngriti dyshime se subjekti në mënyrë fiktive, me qëllim justifikimin e të ardhurave të tij, ka deklaruar se e ka dhënë me qira apartamentin që në momentin e blerjes, duke i kaluar barrën e provës.

Në përgjigje të barrës së provës, subjekti prapësoi se ka pasur mundësi të jepte me qira apartamentin që në ditën që e ka blerë.

Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar deklarinimin e tij. Nga ana tjetër, subjekti, në mënyrë të përsëritur për dy pasuri, rezulton t'i ketë dhënë me qira në të njëjtën ditë që i ka blerë. Në shpjegimet e tij, në lidhje me pasurinë e parë, është përpjekur të deklarojë në mënyrë të pasaktë faktin e dhënies me qira në të njëjtën ditë me nënshkrimin e kontratës së blerjes, ndërkohë nga ana e tij, si gjatë hetimit, por edhe pas kalimit të barrës së provës nuk është depozituar asnjë provë për të vërtetuar faktin se kishte gjetur përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes persona që dëshironin të merrni me qira këto pasuri.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti, në lidhje me dy kontratat e qirasë të mësipërme, është përpjekur të deklarojë në mënyrë të pasaktë të ardhurat e përfituara nga qiraja me qëllim justifikimin e të ardhurave të tij duke e vënë në kushtet e deklarinimit të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016.

52.1.3 Në deklaratën “Vetting” subjekti deklaron të ardhura nga qiraja e dy vendparkimeve në shumën 42.000 lekë. Subjekti ka depozituar:

- kontratë qiraje datë 23.1.2016, nëpërmjet së cilës bashkëshortja e subjektit i ka dhënë z. A. H. dy vendparkime të ndodhur në rr. “***”, me afat 1-vjeçar dhe shuma e qirasë 6.000 lekë /muaj;
- shkresë të thjeshtë me emërtim “pagesë qiraje” datë 23.1.2016, ku deklarohet se është paguar shuma prej 42.000 lekësh, duke u shlyer qiraja për 7 muaj në lidhje me kontratën e mësipërme.

52.1.4 Tabelë përmbledhëse për të ardhurat nga qiratë

Të ardhura nga qiratë	2014	2015	2016	Total
Ap.103,82 m ² , Tiranë	€ 2,283	€ 6,000	€ 6,000	€ 14,283
Ap. *** 78,24 m ² , Durrës	220,000	300,000	300,000	820,000
2 poste parkimi, Durrës			42,000	42,000
Shuma në lekë	539,871	1,125,900	1,153,620	2,819,391
Tatimi paguar ⁶⁰	53,962	171,000	175,859	400,821
Të ardhurat neto nga qiratë lekë	485,884	969,000	980,577	2,435,461

52.2 Të ardhurat nga zgjidhja e kontratës së sipërmarrjes në datën 10.1.2014 me shoqërinë “***” sh.p.k., si dhe të ardhura nga interesat e huas me shoqërinë “***” sh.p.k. për vitet 2006 – 2010, shuma 2.211.000 lekë.

Konstatimi i ILDKPKI-së:

⁶⁰ Mund të ketë diferenca të vogla midis vlerave të tatimeve të paguara dhe atyre që duhen paguar për shkak të kursit të këmbimit të ndryshëm euro/lekë, që është përdorur nga subjekti dhe nga Komisioni.

- Subjekti ka paraqitur vërtetim nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe zgjidhjen e kontratës. Konstatohet se dokumentet e paraqitura nuk janë noteriale dhe transaksionet e kryera në marrje dhe kthim lidhur me apartamentin janë jashtë sistemit bankar. Shuma është deklaruar si burim për blerjen e apartamentit me sip. 78.24 m², në rr. “****”, Durrës.
- Mungesë në procesin e rivlerësimit e kontratës së sipërmarrjes të vitit 2011 për prenotimin e apartamentit në Rrashbull, Durrës nga shoqëria “****” sh.p.k.
- Kontratat e huas ndërmjet subjektit Tritan Hamitaj dhe shoqërisë “****” sh.p.k. janë të thjeshta, jo përpara noterit, në të cilat nuk është deklaruar qëllimi i marrjes/përdorimit të shumave monetare. Po kështu, me kontratë të thjeshtë është deklaruar shlyerja e detyrimeve ndërmjet palëve, duke kthyer (jo në rrugë bankare) shumën 3.500.000 lekë, ndërsa diferencën prej 5.720.000 lekësh (*principal* 8.400.000 lekë + interes 820.000 lekë – kthimi *cash* 3.500.000 lekë) për ta përdorur për porosinë e apartamentit në Rrashbull, Durrës.

52.2.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të ardhura nga interesat e huas dhënë shoqërisë “****” sh.p.k., për vitet 2006 – 2010 në shumën 2.211.000 lekë. Krijimi i shumës fillestare, e cila është dhënë hua, krijuar nga mbyllja e llogarive bankare dhe të ardhurave vjetore. Për të vërtetuar deklarin e tij subjekti ka depozituar:

- a. Kontratë huaje⁶¹, datë 22.6.2006, për dhënie hua të shumës 2.800.000 lekë nga subjekti Tritan Hamitaj, shoqërisë “****” sh.p.k., me afat nga 22.6.2006 – 23.12.2006, interesi 10 % mbi bazë vjetore ose 140.000 lekë që jepet në fund të afatit bashkë me shumën bazë. Detyrimi tatimor parashikohet të paguhet nga huamarrësi, pa prekur shumën e interesit të huadhënësit.
- b. Kontratë huaje⁶², datë 23.12.2006, për dhënie hua të shumës 3.400.000 lekë nga subjekti Tritan Hamitaj, shoqërisë “****” sh.p.k., me afat nga 23.12.2006 – 23.6.2007, interesi 10 % mbi bazë vjetore ose 170.000 lekë që jepet në fund të afatit bashkë me shumën bazë. Detyrimi tatimor parashikohet të paguhet nga huamarrësi, pa prekur shumën e interesit të huadhënësit.
- c. Kontratë huaje⁶³, datë 23.6.2007, për dhënie hua të shumës 3.600.000 lekë nga subjekti Tritan Hamitaj, shoqërisë “****” sh.p.k., me afat nga 23.6.2007 – 23.12.2007, interesi 10 % mbi bazë vjetore ose 180.000 lekë që jepet në fund të afatit bashkë me shumën bazë. Detyrimi tatimor parashikohet të paguhet nga huamarrësi, pa prekur shumën e interesit të huadhënësit.
- d. Kontratë huaje⁶⁴, datë 25.12.2007, për dhënie hua të shumës 4.200.000 lekë nga subjekti Tritan Hamitaj, shoqërisë “****” sh.p.k., me afat nga 25.12.2007 – 25.6.2008, interesi 10 % mbi bazë vjetore ose 210.000 lekë që jepet në fund të afatit bashkë me shumën bazë. Detyrimi tatimor parashikohet të paguhet nga huamarrësi, pa prekur shumën e interesit të huadhënësit.
- e. Kontratë huaje⁶⁵, datë 27.6.2008, për dhënie hua të shumës 4.600.000 lekë nga subjekti Tritan Hamitaj, shoqërisë “****” sh.p.k., me afat nga 27.6.2008 – 28.12.2008, interesi 10 % mbi bazë vjetore ose 230.000 lekë që jepet në fund të afatit bashkë me shumën bazë. Detyrimi tatimor parashikohet të paguhet nga huamarrësi, pa prekur shumën e interesit të huadhënësit.

⁶¹ Deklaruar në DVP/2006.

⁶² Deklaruar në DVP/2007.

⁶³ Deklaruar në DVP/2007.

⁶⁴ Deklaruar në DVP/2007 dhe 2008.

⁶⁵ Deklaruar në DVP/2008.

- f. Kontratë huaje⁶⁶, datë 5.1.2009, për dhënie hua të shumës 3.000.000 lekë nga subjekti Tritan Hamitaj, shoqërisë “****” sh.p.k., me afat nga 5.1.2009 - 25.12.2009, interesi 10 % mbi bazë vjetore ose 290.000 lekë që jepet në fund të afatit bashkë me shumën bazë. Detyrimi tatimor parashikohet të paguhet nga huamarrësi, pa prekur shumën e interesit të huadhënësit.
- g. Kontratë huaje⁶⁷, datë 5.8.2009, për dhënie hua të shumës 4.800.000 lekë nga subjekti Tritan Hamitaj, shoqërisë “****” sh.p.k., me afat nga 5.8.2009 – 25.12.2009, interesi 10 % mbi bazë vjetore ose 171.000 lekë që jepet në fund të afatit bashkë me shumën bazë. Detyrimi tatimor parashikohet të paguhet nga huamarrësi, pa prekur shumën e interesit të huadhënësit.
- h. Kontratë huaje⁶⁸, datë 5.1.2010, për dhënie hua të shumës 8.400.000 lekë nga subjekti Tritan Hamitaj, shoqërisë “****” sh.p.k., me afat nga 5.1.2010 - 28.12.2010, interesi 10 % mbi bazë vjetore ose 840.000 lekë që jepet në fund të afatit bashkë me shumën bazë. Detyrimi tatimor parashikohet të paguhet nga huamarrësi, pa prekur shumën e interesit të huadhënësit.
- i. Shlyerje detyrimi kontraktor, datë 10.1.2011, sipas së cilës referuar kontratës së huas datë 5.1.2010, shoqëria “****” sh.p.k., duhet të shlyejë më 28.12.2010 huan e marrë shtetasit Tritan Hamitaj në shumën 8.400.000 lekë + interesin 820.000 lekë. Në datën 10.1.2011 i kthen huadhënësit Tritan Hamitaj shumën 3.500.000 lekë, ndërsa pjesa tjetër e shumës prej 5.720.000 lekësh do të përdoret për lidhjen e kontratës së sipërmarrjes për apartament me sip. 51 m², në Rrashbull, Durrës.

52.2.1.1 Pagesat e tatimit në burim janë kryer, si vijon:

- shuma 23.000 lekë është paguar në datën 31.1.2009 për shumën e interesave 230.000 lekë të përfuara në datën 5.1.2009;
- shuma 198.100 lekë është paguar në datën 18.1.2017.

Në total subjekti ka paguar shumën 221.100 lekë tatimin 10 % mbi të ardhurat e përfuara nga huadhënia me shoqërinë “****” sh.p.k., për periudhën 2006 – 2011.

52.2.1.2 Komisioni ka kryer analizën financiare mbi mundësinë e subjektit të rivlerësimit për dhënien e huas te shoqëria “****” sh.p.k., si vijon:

	22-Jun-06	22/6 deri 23.12.2006	23-Jun-07	23/6 deri 25.12.2007	27-Jun-08	5-Jan-09	5/1 deri 5/8	5-Jan-10
PASURI	1 255 645	770 570	404 527	-2 256 327	2 012 697	-16	1 167 955	598 309
Dhënë hua te shoqëria “****”	2 800 000	3 400 000	3 600 000	4 200 000	4 600 000	3 000 000	4 800 000	8 400 000
Shlyer huaja nga shoqëria “****”		-2 800 000	-3 400 000	-3 600 000	-4 200 000	-4 600 000		-7 800 000
Depozituar te nëna e bashkëshortes					1 500 000			
Hua te M. G. 900.000 lekë				900 000				
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	<i>-1 544 355</i>	<i>170 570</i>	<i>204 527</i>	<i>-3 756 327</i>	<i>112 697</i>	<i>1 599 984</i>	<i>-3 632 045</i>	<i>-1 691</i>
Likuiditete gjendje	5 085 944	5 256 513	5 614 593	1 858 266	1 940 920	4 241 294	609 249	266 865
TË ARDHURA, dokumentuar	572 965	822 965	654 054	654 054	835 439	150 358	1 059 347	125 788
Të ardhura nga paga e subjektit	457 814	457 814	547 123	547 123	550 720	109 614	767 300	98 952

⁶⁶ Deklaruar në DVP/2009.

⁶⁷ Deklaruar në DVP/2009.

⁶⁸ Deklaruar në DVP/2010.

Të ardhura nga bashkëshortja	5 670	5 670	82 327	82 327	119 404	35 943	251 603	26 836
Bashkëshortja tek Instituti i Kulturës Italiane					54 000	4 800	36 000	
Interesa Bankare	109 481	109 481	24 604	24 604	111 316		4 444	
Nga shitja e automjetit tip "Mercedes Benz"		250 000						
SHPENZIME	164 336	470 049	341 827	4 251 827	273 240	7 486	438 384	8 110
Shpenzime jetese	164 336	164 336	204 930	204 930	273 240	7 486	317 408	8 110
Shpenzime udhëtimi TIMS		305 714	136 897	136 897			120 976	
Shpenzime të tjera (të evidentuara)				3 910 000				
Mundësia për kursime	-847 016	-417 655	-92 300	-1 341 446	-1 450 498	142 888	-546 992	-480 631

Nga analiza financiare konstatohet se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huave shoqërisë "****" sh.p.k.

52.2.1.3 Komisioni ka kryer një hetim të thelluar në lidhje me aftësinë paguese të shoqërisë "****" sh.p.k., për kthimin e huave, si dhe deklarin e tyre në organet tatimore.

52.2.1.3.1 Nga verifikimi i bilanceve të shoqërisë "****" sh.p.k., konstatohet:

- Në bilancin e vitit 2006:
 - a. te pasivi në zërin II/b hua të tjera, nuk ka deklarim;
 - b. te shpenzimet në zërin III/8 interesa të paguara dhe për t'u paguar, nuk ka deklarim.
- Në bilancin e vitit 2007:
 - a. te pasivi në zërin II/b hua të tjera, nuk ka deklarim;
 - b. te shpenzimet në zërin III/8 interesa të paguara dhe për t'u paguar, nuk ka deklarim.
- Në bilancin e vitit 2008:
 - a. te pasivi në zërin 3/iv hua të tjera është deklaruar shuma 2.772.521 lekë, e cila është më e vogël se vetë huaja e pretenduar si e dhënë në shumën 4.600.000 lekë.
- Në bilancin e vitit 2009:
 - a. te pasivi në zërin 3/iv hua të tjera 0 (zero) lekë.
- Në bilancin e vitit 2010:
 - a. tek pasivi në zërin 3/iv hua të tjera 0 (zero) lekë.

Në bilancin e vitit 2011 shpenzimet në total të deklaruara nga shoqëria "****" sh.p.k., kanë qenë në shumën 6.902.201 lekë, e cila është më e vogël se vetë huaja e pretenduar si e dhënë në shumën 8.400.000 lekë në vitin 2010 dhe që pretendohet se është kthyer në vitin 2011.

Në asnjë prej bilanceve të shoqërisë tek shënimet shpjeguese nuk gjendet emri i subjektit të rivlerësimit, sikundër gjenden emrat e debitorëve të tjerë të shoqërisë.

52.2.1.3.2 Për sa i takon aftësisë paguese të shoqërisë "****" sh.p.k., për kthimin e huas Komisioni ka shqyrtuar bilancet e kësaj shoqërie⁶⁹ për vitet 2006 – 2012 dhe pikërisht dy elemente: zëri i huave afatshkurtra dhe rezultati financiar i shoqërisë.

Në këto bilance gjenden të regjistruara totali i detyrimeve të shoqërisë ndaj të tretëve në datën 31 dhjetor të çdo viti, por nuk mund të evidentohen specifikisht huat e dhëna nga subjekti. Më konkretisht, nga verifikimi i bilanceve rezulton se:

⁶⁹ Shkresën nr. *** prot., datë 2.4.2020, nga DRT-ja Durrës.

- Për vitet 2006 dhe 2007 shuma e huave afatshkurtra të regjistruara në zërat përkatës të pasivit të bilancit është më e madhe se shuma e huave të dhëna nga subjekti. Kjo mund të shërbejë si tregues për dhënien e huave nga subjekti.
- Në vitin 2008 vërehet se shuma në zërin e huave afatshkurtra në pasivin e bilancit është më e vogël se shuma e huas 7.800.000 lekë që është marrë gjatë vitit 2008 dhe që është kthyer në datën 5.1.2009. Zëri i detyrimeve tregon se shuma e huas nuk është e regjistruar në bilanc në zërin e detyrimeve. Po ashtu, ky zë tregon se nuk ka pasur shumë/detyrim për t'u kthyer në datën 5.1.2009 nga ana e shoqërisë.
- Për vitin 2009 vërehet që shuma në zërin detyrime në fund të vitit përfaqësohet nga zëri "parapagime të arkëtuara", ndërsa zëri hua afatshkurtra është 0 (zero). Ky i fundit tregon se shuma e huas nuk është e regjistruar në bilanc në zërin e detyrimeve. Po ashtu, ky zë tregon se nuk ka pasur shumë për t'u kthyer në datën 5.1.2010 nga ana e shoqërisë.
- Në datën 31.12.2010 zëri hua afatshkurtra në pasivin e bilancit është 0 (zero), që tregon se shuma prej 9.220.000 lekësh (8.400.000 hua dhe 820.000 lekë interesa) e maturuar në datën 28.12.2010 sipas marrëveshjes nuk është e regjistruar në bilanc në zërin e detyrimeve. Po ashtu, ky zë tregon se nuk ka pasur shumë për t'u kthyer në datën 10.1.2011 nga ana e shoqërisë.

Pamundësinë financiare për të kthyer huat e tregon edhe performanca e shoqërisë "****" sh.p.k. Siç tregohet në tabelën më poshtë, shoqëria ka qenë me humbje nga viti 2008 e në vijim.

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Rezultati financiar	1 504 000	6 029 705	-4 585 308	-6 485 727	-2 203 384	-6 902 201

52.2.1.4 Komisioni i ka kërkuar informacion të detajuar subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto hua, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 1 është sqaruar se: *"Nuk e di pse '****' i ka marrë hua, atij i është thënë se ka pasur mungesë likuiditeti. Dokumentacion nuk disponon. Ka kontaktuar në telefon me administratorin e '****' z. A. D. dhe i ka thënë se nuk disponon dokumentacion të kësaj kohe dhe nuk i di arsyet pse shoqëria e tij ka kryer këto veprime."*

52.2.1.5 Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të shoqërisë "****" sh.p.k., për kthimin e huave, së bashku me interesin dhe prej tij nuk është vënë në dispozicion dokumentacion provues.

52.2.1.6 Në lidhje me faktin që huat nuk janë marrë dhe kthyer nëpërmjet sistemit bankar, duke marrë në konsideratë se shumatat e tyre kanë qenë mbi kufirin e deklarimit nga legjislacioni për parandalimin e pastrimit të parave, subjekti ka sqaruar se ka qenë dëshira e huamarrësit dhe ai ka respektuar vullnetin e tij. Këtij arsytimi subjekti i ka qëndruar edhe në seancën dëgjimore.

52.2.1.7 Në përfundim të hetimit të kryer nga Komisioni, ka rezultuar se:

- i. Subjekti nuk provon me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të shoqërisë "****" sh.p.k., për kthimin e shumave të huas së bashku me interesin.
- ii. Nga analiza financiare konstatohet se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huave shoqërisë "****" sh.p.k.
- iii. Nga bilancet e shoqërisë "****" sh.p.k., ka *indicie* që shoqëria të ketë marrë hua gjatë viteve 2006 dhe 2007, ndërsa për vitet 2008 – 2011 nga bilancet rezulton se shoqëria nuk ka pasqyruar as marrjen dhe as kthimin e huave. Po ashtu, rezulton se shoqëria nuk ka pasur mundësi financiare që t'i kthejë huat subjektit të rivlerësimit.
- iv. Subjekti nuk provon me dokumentacion provues se i ka dhënë hua dhe ka marrë mbrapsht huan së bashku me interesin.

- v. Subjekti nuk provon se huat janë deklaruar nga shoqëria “****” sh.p.k., në organet tatimore, si dhe në bilancet vjetore.
- vi. Subjekti dhe shoqëria “****” sh.p.k., duket sikur kanë vepruar në kundërshtim me legjislacionin për parandalimin e pastrimit parave, pasi nuk i kanë kryer transaksionet nëpërmjet sistemit bankar, si dhe këto transaksione nuk janë deklaruar nga shoqëria “****” sh.p.k., si detyrim ligjor i parashikuar nga legjislacioni.
- vii. Nga hetimi provohet që vitin 2011 shpenzimet e shoqërisë kanë qenë më të vogla se vetë huaja e marrë.

Për rrjedhojë, Komisioni ka ngritur dyshime se këto kontrata huaje janë fiktive me qëllim justifikimin e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit. Të ardhurat nga interesat, si dhe kthimi i huas nuk do të përfshihen në analizën financiare.

52.2.1.8 Pas kalimit të barrës së provës subjekti prapësoi si vijon:

a. Në lidhje me mungesën e të ardhurave të ligjshme të tij për dhënie e huave:

a.1 Në analizën financiare të datës 22.6.2006 dhe në fund të vitit nuk është përfshirë kthimi i huas nga shtetasi G. H. në shumën 500.000 lekë, të ardhurat nga toka bujqësore në shumën 250.000 lekë, të ardhurat e bashkëshortes nga Instituti i Kulturës Italiane në shumën 280.000 lekë dhe të ardhurat nga interesi i kontratës së huas në shumën 140.000 lekë. Gjithashtu, janë futur si shpenzime udhëtimi në masën 305.714 lekë, që nuk janë kryer prej tij.

a.2 Në analizën financiare të datave 23.6.2007 dhe 25.12.2007 nuk janë përfshirë të ardhurat nga toka bujqësore në shumën 300.000 lekë, të ardhurat e bashkëshortes në shumën 300.000 lekë dhe të ardhurat nga interesi i kontratës së huas në shumën 170.000 lekë. Është vendosur si pasuri shuma prej 900.000 lekësh sikur i janë dhënë hua shtetases M. G.. Gjithashtu, janë futur shpenzime udhëtimi në masën 273.794 lekë, që nuk janë kryer në këtë masë prej tij.

a.3 Në analizën financiare të datës 27.6.2008 nuk janë përfshirë të ardhurat nga toka bujqësore në shumën 150.000 lekë, të ardhurat e bashkëshortes në shumën 210.000 lekë dhe të ardhurat nga interesi i kontratës së huas në shumën 210.000 lekë. Është vendosur si pasuri shuma prej 1.500.000 lekësh, derdhur nga bashkëshortja te nëna e saj, ndërkohë që kjo shumë ka qenë e nënës së bashkëshortes.

a.4 Në analizën financiare të datës 5.8.2009 nuk janë përfshirë të ardhurat nga kthimi i huas nga shtetasja M. G. në shumën 15.000 euro, të ardhurat nga toka bujqësore në shumën 250.000 lekë dhe të ardhurat nga interesi i kontratës së huas në shumën 230.000 lekë. Është përfshirë si pasuri blerja e garazhit në shumën 12.000 euro. Është llogaritur si shpenzim udhëtimi i tij për në Athinë në shumën 882 euro. Udhëtimi ka qenë në Egjipt për arsye zyrtare dhe ka paraqitur përgjigjen e KLD-së nr. *** prot., datë 8.4.2019, sipas së cilës rezulton se shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit në Egjipt janë paguar nga qeveria egjiptiane.

a.5 Në analizën financiare të datës 5.1.2010 nuk janë përfshirë të ardhurat nga toka bujqësore në shumën 200.000 lekë dhe të ardhurat nga interesi i kontratës së huas në shumën 461.000 lekë.

a.6 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se në lidhje me shpenzimet e udhëtimit duhet marrë në konsideratë dokumentacioni i depozituar nga subjekti, duke i ulur këto shpenzime: në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore nuk do të përfshihen në analizë financiare, sipas arsytimit në pikën 40.4 të këtij vendimi; në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes nga Instituti i Kulturës Italiane janë llogaritur vetëm ato të ardhura, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore; në lidhje me interesat e përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k., nuk përfshihen në analizë financiare, sipas arsytimit të trajtuar më poshtë në këtë vendim, në lidhje me shumën 900.000 lekë ajo është përfshirë në analizë financiare, sipas arsytimit në pikën 43.3.2 germa b/4 të këtij vendimi. Gjithashtu, në analizë financiare është përfshirë dhe

shuma prej 1.500.000 lekësh pasi subjekti nuk provoi me dokumentacion provues që kjo shumë i përket nënës së bashkëshortes, e cila për më tepër, në këtë periudhë ka pasur të ardhura vetëm pensionin e saj. Nga subjektit nuk u provua që nëna e bashkëshortes ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e shumës prej 1.500.000 lekësh.

a.7 Komisioni kreu edhe njëherë llogarinë për mundësinë financiare të subjektit për dhënien e këtyre huave, si vijon:

	22-Jun-06	22/6 deri 23.12.2006	23-Jun-07	23/6 deri 25.12.2007	27-Jun-08	5-Jan-09	5/1 deri 5/8	5-Jan-10
PASURI	755 645	770 570	404 527	-2 256 327	2 012 697	-16	1 167 955	598 309
Dhënë hua tek shoqëria “***”	2 800 000	3 400 000	3 600 000	4 200 000	4 600 000	3 000 000	4 800 000	8 400 000
Shlyer huaja nga shoqëria “***”		-2 800 000	-3 400 000	-3 600 000	-4 200 000	-4 600 000		-7 800 000
Depozituar te nëna bashkëshortes					1 500 000			
Hua te M. G.				900 000				
Kthyer nga vëllai G. H.	-500 000							
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	<i>-1 544 355</i>	<i>170 570</i>	<i>204 527</i>	<i>-3 756 327</i>	<i>112 697</i>	<i>1 599 984</i>	<i>-3 632 045</i>	<i>-1 691</i>
Likuiditete/Gjendje	5 085 944	5 256 513	5 614 593	1 858 266	1 940 920	4 241 294	609 249	266 865
TË ARDHURA dokumentuar	572 965	822 965	654 054	654 054	835 439	150 358	1 059 347	125 788
Të ardhura nga paga e subjektit	457 814	457 814	547 123	547 123	550 720	109 614	767 300	98 952
Të ardhura nga bashkëshortja	5 670	5 670	82 327	82 327	119 404	35 943	251 603	26 836
Bashkëshortja tek Instituti Kulturës Italiane					54 000	4 800	36 000	
Interesa bankare	109 481	109 481	24 604	24 604	111 316		4 444	
Nga shitja e mjetit “Mercedes Benz”		250 000						
SHPENZIME	164 336	193 673	228 757	4 138 757	273 240	7 486	317 408	8 110
Shpenzime jetese	164 336	164 336	204 930	204 930	273 240	7 486	317 408	8 110
Shpenzime udhëtimi TIMS		29 338	23 827	23 827				
Shpenzime të tjera (të evidentuara)				3 910 000				
Mundësia për kursime	-347 016	-141 279	20 770	-1 128 377	-1 450 498	142 888	-426 015	-480 631

Sërish subjekti rezulton në pamundësi financiare për dhënien e këtyre huave.

b. Në lidhje me dokumentacionin provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të shoqërisë “***” sh.p.k., për kthimin e shumave të huas së bashku me interesin, subjekti ka prapësuar se këto të ardhura janë siguruar nga tërheqjet që janë bërë në llogarinë e kësaj shoqërisë ose nga të ardhurat e përfituara nga kontrata e shitblerjes.

[...Pasqyrat financiare të “***” sh.p.k. janë deklarime të njëanshme, pasi ato nuk janë verifikuar për vërtetësinë tyre nga aktet e kontrollit të Drejtorisë Tatimore....me provat e depozituara arrij të provoj falsitetin e bilanceve të viteve 2006-2013, pasi pasqyrimi i ngjarjeve ekonomike nuk është bërë i plotë dhe ky fakt tregon përmbajtje të rreme...]. Subjekti sqaron se nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor të kryejë transaksionin nëpërmjet rrugës bankare, pasi nuk është në cilësinë e tregtarit në këto veprime juridike. Drejtoria e Pastrimit të Parave është në dijeni të veprimeve të tij, pasi për shkak të detyrës është person i ekspozuar politikisht dhe veprimet e tij me “***” sh.p.k. janë deklaruar në deklarata vjetore të pasurisë dhe nëpërmjet këtyre deklaratave kjo drejtori është vënë në dijeni.

b.1 Komisioni, pasi analizoi përgjigjet e subjektit së bashku me provat e depozituar prej tij, konstaton se ato nuk janë bindëse dhe nuk provojnë aftësinë paguese të shoqërisë “****” sh.p.k. për kthimin e huave. Subjekti është në dijeni të faktit që shoqëria “****” sh.p.k. kishte detyrimin ligjor t’i kryente veprimet në këto shuma nëpërmjet sistemit bankar, ndërkohë ka pranuar që nga ana e saj të mos respektohet një detyrimi i tillë, duke pretenduar se huan e ka dhënë dhe e ka marrë *cash*. Subjekti ka depozituar një numër të konsiderueshëm kontratash shitblerjeje të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe të personave të tretë, por të ardhurat e përfituara nga këto kontrata, për sa kohë nuk rezultojnë të deklaruara në organet tatimore dhe për të cilat nuk janë paguar detyrimet tatimore, nuk mund të konsiderohen si të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Gjithashtu, subjekti ka pasur të gjitha mundësitë që dhënia dhe kthimi i huasë të bëhej nëpërmjet sistemit bankar, pasi siç pretendon subjekti, ish-administratori i kësaj shoqërie e ka tërhequr këtë shume nga banka për t’ia dhënë subjektit *cash*. Subjekti, për efekt provueshmërie, duke qenë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së, duhej të kryente të gjitha veprimet nëpërmjet sistemit bankar për sa kohë kishim të bënim me një marrëdhënie që ka zgjatur në kohë. Subjekti ka pasur njohuritë e duhura ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe ka qenë në dijeni të faktit që këto marrëdhënie duhej të deklaroheshin, për sa kohë kanë qenë mbi limitin e shumës që kishin detyrim për të deklaruar, si dhe nuk ka pasur asnjë pengesë për të kryer transfertat, të paktën prej tij.

Moskryerja e këtyre veprimeve nga subjekti e ngarkon me përgjegjësi, pasi ka ndihmuar shoqërinë “****” sh.p.k., për të mos zbatuar legjislacionin përkatës për parandalimin dhe pastrimin e parave. Subjekti nuk ka provuar që të ardhurat e përfituara nga kontratat e shitblerjes janë përdorur për shlyerjen e detyrimeve ndaj tij, pasi shoqëria “****” sh.p.k., mund të ketë pasur edhe detyrimeve ndaj palëve të treta. Komisioni në konsideratë ka marrë vetëm të dhënat e konfirmuar nga organet tatimore për sa kohë në bazë të nenit D të Aneksit të Kushtetutës të ardhura të ligjshme quhen vetëm ato për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të dhënë hua, shoqëria “****” sh.p.k. nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për kthimin e huave, huat nuk janë dhënë dhe marrë nëpërmjet sistemit bankar detyrim ligjor i parashikuar nga legjislacioni tatimor, por dhe ai i pastrimit të parave, subjekti nuk ka treguar kujdesin e duhur në lidhje me këtë marrëdhënie, pasi ka pranuar që veprimet të kryhen në kundërshtim me legjislacionin e sipërcituar, Komisioni vlerëson se subjekti është në kushtet e deklarimit të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë marrëdhënie huaje, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të germave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

52.2.2 Në deklaratën “Vetting” subjekti deklaroi se ka përfituar nga shoqëria “****” sh.p.k., shumën 51.000 euro, e cila përbëhet nga shuma 41.000 euro, kthimi i shumës së apartamentit të porositur dhe shuma 10.000 euro, penalitetet për mospërbushje kontrate. Për të vërtetuar deklarin e tij subjekti ka depozituar:

a. Vërtetim të datës 27.12.2016, të shoqërisë “****” sh.p.k., sipas të cilit z. Tritan Hamitaj ka lidhur kontratë sipërmarrjeje për një apartament në pallatin e ndërtuar nga kjo shoqëri tek “****”, Durrës. Kontrata është zgjidhur për mosrespektim të kushteve nga ana e shoqërisë. Nuk disponohet kopje e kontratës së sipërmarrjes së datës 10.1.2011, me porositës Tritan Hamitaj, sipërmarrës në shoqërinë “****” sh.p.k., për apartament me sip. 51 m².

a.1 Nga hetimi ka rezultuar se bazuar në procesverbalin e datës 22.4.2015⁷⁰ në lidhje me këtë apartament subjekti ka deklaruar në ILDKPKI se: “*Pagesa është kryer cash dhe nuk disponon*

⁷⁰ Shihni procesverbal shkresë nr. *** prot., datë 25.2.2020, kthim-përgjigjeje të ILDKPKI-së.

mandatpagesë. Nuk është i banueshëm nga ana e tij dhe nuk është kryer mobilimi i tij. Nuk është i regjistruar dhe nuk disponon certifikatë pronësie.”

a.2 Subjekti, pasi u pyet për të qartësuar këtë deklaram, ka sqaruar⁷¹: *“Sipas kontratës së huas datë 5.1.2010, huamarrësi ‘***’ sh.p.k. duhet të përmbushte detyrimin e kontratës në datën 25.12.2010. Huamarrësi pati vështirësi në përmbushjen e detyrimit dhe arriti të më kthejë një pjesë të shumës prej 3.500.000 lekësh. Për pjesën tjetër më propozoi shkëmbim me apartamentin në fjalë. Nga shoqëria ‘***’ sh.p.k. m’u premtua se mund të anulohet kontrata e sipërmarrjes nëse ai arrinte të siguronte shumën e mbetur të detyrimit për një kohë të shkurtër. U detyrova të lidh këtë kontratë për të pasur një mundësi më shumë për të marrë paratë e mia... Paga është kryer cash, d.m.th. jashtë rrugës bankare. ...”*

a.3 Në analizë të sa më lart, subjekti rezulton të ketë paguar *cash* shoqërinë “***” sh.p.k., për blerjen e një apartamenti, ndërkohë ka deklaruar se shuma e huas që kjo shoqëri i kishte subjektit u konvertua në apartament. Duket se ka mospërputhje të deklarameve të subjektit në lidhje me mënyrën e pagesës së apartamentit. Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2010 të shoqërisë “***” sh.p.k., nuk rezulton që shuma 3.500.000 lekë të jetë deklaruar si e marrë hua, pasi zëri detyrime/hua është 0 (zero). Për këto, subjektit iu kalua barra e provës.

a.4 Në përgjigje të barrës së provës subjekti prapësoi se:

Në deklaramin e tij përpara ILDKPKI-së të datës 22.4.2015 ka përdorur termin *cash* për pagesën e apartamentit, pasi paratë janë dhënë hua *cash* te shoqëria “***” sh.p.k., dhe vazhdimësia e shlyerjes prej tyre ka qenë *cash* dhe asnjëherë në rrugë bankare.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe janë në nivel deklaramiv.

b. Zgjidhje kontrate me mirëkuptim e datës 10.1.2014, ndërmjet shoqërisë “***” sh.p.k., sipërmarrës dhe z. Tritan Hamitaj porosites. Në këtë dokument deklaramohet: *“Me kontratën e sipërmarrjes datë 10.1.2011, palët kanë lidhur kontratë, sipas të cilës z. Tritan Hamitaj do të përfitonte apartament me sip. 51.1 m² në pallatin me lejen e ndërtimit nr. ***, datë 11.3.2009, të Komunës Rrashbull. Porositësi në momentin e lidhjes së kontratës e kishte paguar të gjithë shumën e blerjes prej 41.000 euro dhe sipërmarrësi kishte marrë përsipër të regjistronte në hipotekë objektin para datës 30.4.2012. Nëse nuk regjistrohej objekti në hipotekë deri në datën 30.4.2012, porositesi kishte të drejtë të prishte kontratën dhe si sanksion të përfitonte veç shumës së blerjes 41.000 euro të apartamentit, edhe 50 % të kësaj vlere. Detyrimi i sipërmarrësit nuk u realizua për pajisjen me certifikatë pronësie brenda datës 30.4.2012 dhe palët e zgjidhin këtë kontratë me mirëkuptim. Porositësi do të përfitojë shumën 51.000 euro cash dhe nuk ka pretendime të tjera. Porositësi dorëzon që sot posedimin e tij në favor të sipërmarrësit. Shuma 51.000 euro u likuidua sot.”*

b.1 Subjektit i është kërkuar të provojë me dokumentacion provues aftësinë financiare të shoqërisë “***” sh.p.k., për kthimin e shumës 51.000 euro në vitin 2014. Subjekti ka deklaruar se shoqëria “***” sh.p.k., nuk disponon dokumentacion, pasi i është thënë se nuk ka dokumentacion të vitit 2014.

b.2 Nga hetimi ka rezultuar se shoqëria “***” sh.p.k. nuk ka pasur të ardhura për vitin 2014, për rrjedhojë, nuk ka pasur aftësi financiare për t’i dhënë subjektit shumën 51.000 euro. Gjithashtu, nuk dokumentohet dhe nuk provohet që në fillim të vitit 2014, por edhe përgjatë gjithë vitit shoqëria “***” sh.p.k. të ketë kryer aktivitetet tregtar (shitje-blerje) për të pasur para *cash* për t’ia dhënë subjektit, si dhe të ketë paguar detyrimet tatimore në lidhje me penalitetin në shumën 10.000 euro. Nuk dokumentohet që në organet tatimore të jetë deklaruar shuma 51.000 si shpenzim. Për sa më sipër, ka rezultuar se: (i) subjekti nuk provon me dokumentacion

⁷¹ Shihni pyetësorin nr. 1.

provues marrjen e shumës 51.000 euro nga shoqëria “****” sh.p.k.; (ii) subjekti nuk provon me dokumentacion provues aftësinë financiare të shoqërisë “****” sh.p.k., për dhënien e shumës 51.000 euro; (iii) shoqëria “****” sh.p.k., nuk ka pasur aftësi financiare për t’i dhënë subjektit shumën 51.000 euro.

b.3 Për rrjedhojë, Komisioni ka ngritur dyshime për veprime fiktive me qëllim justifikimin e të ardhurave, duke i kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën. Ndërkohë, shuma 51.000 euro nuk është përfshirë në analizë financiare.

Në lidhje me këtë rezultat, shpjegimet e subjektit, si dhe qëndrimi i Komisionit janë trajtuar më lart.

Në përfundim, Komisioni vendosi të mos përfshijë në analizë financiare shumën 51.0000 euro, pasi subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huave shoqërisë “****” sh.p.k. dhe kjo shoqëri nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kthimin e huas dhe pagimin e shumës 51.000 euro në vitin 2014.

52.3 Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar të ardhura nga donatori “****” sh.p.k., në shumën 3.000.000 lekë.

52.3.1 Në datën 14.1.2014 është lidhur kontratë donacioni midis shoqërisë “Frigo Food” sh.p.k. dhe z. Tritan Hamitaj. Në këtë kontratë parashikohet se donatori merr përsipër të paguajë të gjitha shpenzimet për djalin e subjektit A. H. për rehabilitimin e tij, por jo më shumë se 1.200.000 lekë. Kontrata është me afat deri sa djali i subjektit të mbushë moshën 18 vjeç.

52.3.2 Nga hetimi ka rezultuar se shoqëria “****” sh.p.k. ka bërë pagesat në llogarinë e subjektit në “Alpha Bank”, si vijon:

- në datën 29.12.2014⁷², shumën 1.200.000 lekë;
- në datën 3.4.2015⁷³, shumën 600.000 lekë;
- në datën 25.11.2015, shumën 600.000 lekë;
- në datën 5.10.2016⁷⁴, shumën 600.000 lekë.

52.3.3 Subjektit të rivlerësimit i është kërkuar informacion në lidhje me këto të ardhura, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ka sqaruar se *është njohur rastësisht në plazh me ortakun e kësaj shoqërie, z. S. M.. Nga z. M. u vlerësuan vështirësitë në rritjen e djalit të tij dhe njëkohësisht durimi i tyre në përballimin dhe menaxhimin e situatave me një sjellje shumë të vështirë të djalit me aftësi ndryshe. Nga z. M. nuk u kërkuar informacion për gjendjen e tij të pasurisë. Bamirësinë nuk e lidh me gjendjen e tij financiare, por u lidh me situatat që ai përjetoi për gjendjen e djalit, si dhe përkushtimin e tyre. Thjesht donte të bënte bamirësi.*

52.3.4 Subjektit i është kërkuar të vërë në dispozicion dokumentacionin e depozituar prej tij në shoqërinë “****” sh.p.k., për të provuar shpenzimet mjekësore apo të trajtimit me terapi të zhvillimit të djalit të tij, në zbatim të paragrafit 3 të kontratës së donacionit. Gjithashtu, i është kërkuar që të informojë Komisionin për shpenzimet e kryera për çdo vit për djalin e tij, para lidhjes së kontratës së donacionit. Në lidhje me këtë kërkesë subjekti ka sqaruar se nuk ka depozituar ndonjëherë dokumentacion për të provuar shpenzimet. Shoqëria “****” sh.p.k. ka zbatuar bindjen në financim dhe jo duke i kërkuar dokumentacion. Kjo shoqëri nuk e ka lidhur ndonjëherë financimin me shumën e shpenzimeve të kryera nga subjekti për djalin, pavarësisht ekzistencës së kontratës. Kontrata është lidhur më tepër nga insistimi i tij që të dokumentonte financimin dhe donatorit t’i jepte diçka në këmbim të shumës së marrë nëse djali i tij në të

⁷² Deklaruar në vitin 2014.

⁷³ Deklaruar në vitin 2015.

⁷⁴ Deklaruar në vitin 2016.

ardhmen do të kishte një dhunti. Shpenzimet e kryera për çdo vit për djalin para lidhjes së kontratës nuk e dinë sa janë.

52.3.5 Shpjegimet e subjektit në lidhje me donacionin e kryer nga shoqëria “****” sh.p.k. nuk duken bindëse. Nga subjekti nuk provohet me dokumentacion që djali i tij të ketë pasur shpenzime në shumën 1.200.000 lekë. Komisioni ka ngritur dyshime për kontratë fiktive me shoqërinë “****” sh.p.k., pasi: (i) subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues në shoqërinë “****” sh.p.k., për të justifikuar shpenzimet në ngarkim të djalit të tij; (ii) nuk provohet që subjekti të ketë shpenzuar shumën 1.200.000 lekë në vit për të mbuluar shpenzimet për djalin e tij; (iii) subjekti nuk ka deklaruar se sa janë shpenzimet vjetore të djalit të tij, duke u bërë pengesë për Komisionin në llogaritjen e analizës financiare. Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit. Në analizën financiare shumat e përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k. janë përfshirë edhe tek të ardhurat edhe tek shpenzimet.

52.3.6 Në lidhje me këto rezultate, subjekti prapësoi se sipas kontratës donacioni mund të jepet edhe pa paraqitur dokumentacion dhe kontrata është zbatuar pa u paraqitur prej tij dokumentacion për shpenzimet. Në lidhje me detyrimin për të dokumentuar shpenzimet e kryera për djalin A. H., subjekti deklaroi se ky detyrim nuk është i parashikuar në ligj. Për këtë ka argumentuar në pikën 2 në lidhje me shpenzimet e mbjelljes së ullinjve dhe vreshtit, argument i cili është i njëjtë edhe për këto shpenzime. Në lidhje me faktin se sa kanë qenë këto shpenzime e ka të pamundur të thotë një shifër.

Komisioni, pasi analizoi përgjigjet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse nga ana e tij. Subjekti në mënyrë të përsëritur ka refuzuar të japë përgjigje në lidhje me shpenzimet e tij, duke u bërë pengesë për kryerjen e një analize të saktë financiare në lidhje mbi mundësitë e tij për të pasur të ardhura të ligjshme. Është e vërtetë që subjekti nuk ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar shpenzimet e tij në deklaratën “Vetting”, por ndërkohë, në bazë të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 ka pasur detyrimin për të bashkëpunuar me Komisionin. Gjithashtu, nëse shpenzimet vjetore të subjektit kanë qenë mbi 300.000 lekë në lidhje me djalin e tij, ka pasur detyrimin për t’i deklaruar periodikisht.

Në përfundim, Komisioni, duke qenë në kushtet e pamundësisë për të bërë një analizë të saktë financiare, pa bashkëpunimin e subjektit, ka vendosur që vlerën e donacionit ta shpërndajë në mënyrë të barabartë për 12 muaj, duke i llogaritur shpenzimet të barabarta me vlerën e donacionit.

52.4 Për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore nga të ardhurat (qira+tokë bujqësore+interesat nga huaja) subjekti ka depozituar dokumentet:

- Pagesë tatime dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, datë 3.5.2016, të Alpha Bank, ku vërtetohet pagimi i tatimit mbi të ardhurat individuale për periudhën janar - dhjetor 2015, në shumën 192.000 lekë.

Kjo shumë përbëhet nga:

- a. shuma 171.000 lekë, paguar tatimi në burim mbi të ardhurat nga qiratë e vitit 2015;
 - b. shuma 21.000 lekë, tatimi në burim për të ardhura nga toka bujqësore, në shumën 140.000 lekë, sikurse është deklaruar nga subjekti në DPV/2015 dhe DIVA/2015.
- Pagesë tatime dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, datë 3.5.2016, të “Alpha Bank”, ku vërtetohet pagimi i tatimit mbi të ardhurat individuale për periudhën janar - dhjetor 2014, në shumën 69.541 lekë, e cila përfaqëson tatimin në burim për të ardhurat nga qiratë gjatë vitit 2014.

- Depozitë në arkë për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Tatimi i mbajtur në burim në dhjetor të vitit 2016 për znj. R. H. në shumën 143.600 lekë për të ardhurat nga puna *part-time* e bashkëshortes në Institutin e Kulturës Italiane, paguar më 16.1.2017.
- Depozitë në arkë për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Tatimi i mbajtur në burim në dhjetor të vitit 2016 për z. Tritan Hamitaj në shumën 198.100 lekë. Kjo pagesë i takon tatimit mbi interesat e përfituara nga huat e dhëna shoqërisë “***” sh.p.k.

53. Në lidhje me DVP-të

53.1 Subjekti, në DVP/2003⁷⁵, deklaron:

- depozitë bankare në shumën 635.000 lekë në Tirana Bank;
- depozitë bankare në shumën 1.380 USD në Tirana Bank;
- para *cash* në shumën 500.000 lekë.

53.1.1 Analiza financiare mbi mundësinë e krijimit të depozitave në Tirana Bank, si vijon:

	2002	2003
PASURI	-1 744 481	436 129
Apartament 2+1, sip. 81,16 m ² , Rr. “***” Durrës	1 500 000	
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>	<i>-3 244 481</i>	<i>436 129</i>
Likuiditete/Gjendje	821 269	1 257 398
Të ardhura dokumentuar	512 202	660 783
Të ardhura nga paga e subjektit	493 461	604 654
Të ardhura nga interesat bankare	18 741	56 129
SHPENZIME	93 894	93 964
Shpenzime jetese	93 894	93 964
Mundësia për kursime	2 162 790	130 690
<i>Mundësia për kursime kumulative</i>	<i>-814 631</i>	<i>-683 941</i>

Nga analiza financiare konstatohet se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e depozitave, duke i kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, kërkoi që të përfshiheshin edhe të ardhura të familjarëve të tij. Në lidhje me të ardhurat e familjarëve të tij Komisioni ka bërë një analizë të hollësishme në pikën 41.3.1 germa b të këtij vendimi, duke vendosur të mos i marrë në konsideratë.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e depozitave bankare në shumën 814.631 lekë në vitin 2002 dhe në shumën 683.941 lekë në vitin 2003.

53.1.2 Analizë financiare mbi mundësinë e subjektit për të krijuar shumën *cash* gjatë vitit 2003, si vijon:

	2003
PASURI	436,129
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>	<i>436,129</i>

⁷⁵ Kjo DVP është plotësuar në datën 17.3.2004.

Likuiditete/Gjendje	1,257,398
Të ardhura dokumentuar	660,783
Të ardhura nga paga e subjektit	604,654
Të ardhura nga interesat bankare	56,129
Të ardhura nga emigracioni	0
SHPENZIME	93,964
Shpenzime jetese	93,964
Mundësia për kursime	130,690

Subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash*.

53.2 Subjekti, në DVP/2004, deklaron:

- a. depozitë në shumën 520.000 lekë në Bankën Amerikane;
- b. depozitë në shumën 2.000.000 lekë në Bankën Amerikane, kjo llogari deklarohet e mbyllur në DVP/2005.

53.2.1 Për dy depozitat e mësipërme në pronësi të znj. R. H. në DVP/2004 është deklaruar si burim të ardhura nga puna dhe shitja e truallit nga nëna. Ndërkohë, në përgjigje të pyetësorit nr. 1 subjekti nuk ka deklaruar si burim të ardhurat nga shitja e truallit të nënës së bashkëshortes, por ka deklaruar të ardhurat e mëposhtme:

a. Për shumën 2.000.000 lekë:

- 97.955 lekë, paga e znj. R. H. te shoqëria “***” sh.p.k.;
- 45.925 lekë, paga e znj. R. H. (Hamitaj) pranë Personit Fizik “L. T.”;
- 72.665 lekë, të ardhura nga leja e lindjes, znj. R. H.;
- të ardhura të znj. R. H. pranë shoqërisë “***” sh.p.k., për periudhën 1.12.1998 – 31.3.1999 – nuk ka të dhëna të sakta për pagesën;
- të ardhura të znj. R. H. për periudhën 1.2.2000 – 1.11.2000, pranë shoqërisë “***” sh.p.k. – nuk ka të dhëna të sakta për pagesën.

Rezulton se të ardhurat nga shoqëria “***” sh.p.k. dhe shoqëria “***” sh.p.k. janë në nivel deklarativ dhe subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues, për rrjedhojë, nuk do të merren në konsideratë, duke i kaluar subjektit barrën e provës.

- të ardhura nga puna *part-time* e znj. R. H. pranë Institutit të Kulturës Italiane, për vitet 2001 e në vazhdim – nuk ka të dhëna të sakta për pagesën.

Në lidhje me këto të ardhura subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se janë përfituar për periudhën 2004 – 2007 dhe një pjesë në vitin 2008 në shumën 1.138.000 lekë.

Për sa më sipër rezulton se:

- i. Subjekti gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se nuk ka të dhëna të sakta për pagesën e përfituar nga bashkëshortja nga Instituti i Kulturës Italiane.
- ii. Deklarimi i subjektit gjatë hetimit administrativ nuk përputhet me deklarinimin në deklaratën “Vetting” në të cilën ka deklaruar të ardhura nga Instituti i Kulturës Italiane për periudhën 2004 – 2007 dhe një pjesë në vitin 2008 në shumën 1.138.000 lekë.
- iii. Subjekti nuk provon me dokumentacion provues të ardhurat e bashkëshortes nga Instituti i Kulturës Italiane për periudhën 200 – 2008.

Për rrjedhojë, të ardhurat e deklaruar në deklaratën “Vetting” në shumën 1.138.000 lekë nuk do të përfshihen në analizë financiare, si vijon:

- të ardhura nga dhënia e kurseve të gjuhës italiane në shtëpi (nuk ka të dhëna të sakta për pagesën);
- 85.565 lekë të ardhura nga depozita në Intesa Sanpaolo Bank në emër të znj. R. H., vitet 2003 – 2005;
- 33.333 lekë dhe 493.314 lekë privatizimi të ardhura nga dëmshpërblimi financiar si të përndjekur politikë të detajuar, si vijon:
 - 33.333 lekë dhe 120.000 lekë privatizimi të përfituar nga dëmshpërblimi si i përndjekur politik i z. S. H.;
 - 248.876 lekë privatizimi të përfituar nga dëmshpërblimi si i përndjekur politik i z. S. H.;
 - 124.438 lekë privatizimi të përfituar nga dëmshpërblimi si i përndjekur politik i znj. N. H..
- pension familjar i përfituar nga znj. R. H. gjatë vazhdimit të shkollës së lartë pas vdekjes së babait S. H.;
- bursë studimi e përfituar nga znj. R. H. në vitet 1993 – 1998, ndërkohë që vazhdonte shkollën e lartë të gjuhëve të huaja;
- të ardhura nga fitimi i realizuar nga veprimtaria tregtare në fushën e hotelerisë nëpërmjet personit fizik “H. H.” dhe dhënia me qira e 6 dyqaneve, në Gjirokastrë;
- të ardhura nga shitja e dy dyqaneve në vitin 2000 në Gjirokastrë;
- të ardhura nga dhënia me qira e kullotave në Gjirokastrë të kthyer me vendim nr. ***, datë 19.9.1997, të Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish Pronarëve Gjirokastrë; të ardhura nga dhënia me qira i shtëpive në Gjirokastrë.

Në lidhje me të ardhurat e mësipërme (nga të ardhurat nga kurset-dhënia me qira e kullotave) rezulton se: nuk janë deklaruar në deklaratën “Vetting”; nuk janë deklaruar si burim në DVP/2004; nuk provohen me dokumentacion provues dhe, për rrjedhojë, nuk do të merren në konsideratë në analizë financiare.

b. Për shumën 520.000 lekë subjekti ka deklaruar se veç të ardhurat më sipër të bashkëshortes ka edhe kontribut nga të ardhurat e tij (pas fejesës së tyre ka kontribuar edhe ai në shtimin e kësaj llogarie).

Në lidhje me të ardhurat e subjektit, për sa kohë nuk janë deklaruar si burim në DVP/2004, nuk do të merren në konsideratë në analizë financiare.

Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me këto të ardhura.

53.2.2 Analizë financiare për krijimin e depozitave të mësipërme

	2004
PASURI	7 171 947
Automjet “Mercedes Benz”	400 000
Dhënë hua të vëllait, G. H.	1 600 000
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>	<i>5 171 947</i>
Likuiditete/gjendje	6 429 345
Të ardhura dokumentuar	5 087 552
Të ardhura nga paga e subjektit	783 123
Të ardhura nga bashkëshortja	91 035
Interesa bankare	177 884

Të ardhura krijuar dhe dhëne/dhuruar nga familja	3 910 000
Të ardhura të kursyera para martese dhe të prura nga bashkëshortja	125 510
SHPENZIME	281 892
Shpenzime jetese	281 892
Mundësia për kursime	-2 366 287

Te likuiditetet është përfshirë shuma e bonos së thesarit që administrohet në një llogari 3 emërore të bashkëshortes së subjektit, nënës dhe motrës. Kjo shumë është e vendosur edhe te të ardhurat, pasi shuma është e depozituar nga nëna dhe ka burim⁷⁶ të ligjshëm.

53.2.3 Nga analiza financiare rezulton se bashkëshortja e subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e këtyre depozitave. Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën.

Pas kalimit të barrës provës së provës, subjekti në lidhje me rezultatet e mësipërme prapësoi se:

- Në lidhje me të ardhurat nga shoqëritë “***” sh.p.k. dhe “***” sh.p.k., subjekti pretendon se mospagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore nuk mund të penalizojë në mosllogaritjen e të ardhurave të krijuara nga puna e bashkëshortes. Gjithashtu, subjekti ka depozituar disa dokumente për të provuar të ardhurat e nënës së bashkëshortes, duke pretenduar se këto të ardhura kanë shërbyer si burim për hapjen e këtyre depozitave.
- Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se nuk janë të bazuara prej tij në DVP/2004, por dhe në deklaratën “Vetting” nuk rezultojnë të deklaruara si burime të ardhurat e pretenduara.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë të bazuara. Subjekti nuk rezultonë që të ketë provuar me dokumentacion provues këto të ardhura si dhe pagimin e detyrimeve tatimore përkatëse. Nga ana e tij nuk rezulton që në DVP/2004, por dhe në deklaratën “Vetting” këto të ardhura të jenë deklaruar si burim i pasurive të tij. Për rrjedhojë, Komisioni do të përfshijë në analizë financiare vetëm ato të ardhura për të cilat provohet se janë përfituar nga bashkëshortja dhe janë deklaruar në DVP/2004 dhe në deklaratën “Vetting”.

- Nga analiza financiare pas përfshirjes së të ardhurave nga shoqëria “***” sh.p.k., në shumën 48.000 lekë konstatohet se bashkëshortja e subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin depozitave në shumën 2.318.287 lekë.

53.2.4 Bono thesari në vlerën 4.000.000 lekë në Bankën Amerikane në emër të L., M. dhe R. H.. Burimi i krijimit është deklaruar shitje trualli.

Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 5.4.2004, znj. L. H. i ka shitur znj. Sh. T. truall me sip. 1.239 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, në lagjen “***”, Lushnjë, me çmim 4.000.000 lekë.

53.2.5 Hua dhënë vëllait G. H. në shumën 1.600.000 lekë, ku 1.300.000 lekë janë të mbartura nga viti 2003 dhe 300.000 lekë të ardhura nga viti 2004.

53.2.5.1 Burimi i huas, dhënë vëllait nuk përputhet me deklaratimet e subjektit në vitin 2003 ku ka deklaruar se ka gjendje *cash* shumën prej 500.000 lekësh dhe jo shumën 1.300.000 lekë. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr.1, ka deklaruar si burim të ardhurat nga toka bujqësore dhe të ardhurat gjatë viti.

⁷⁶ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 5.4.2004, me të cilën znj. L. H. ka shitur truall në shumën 4.000.000 lekë.

- i. Në datën 10.8.2004 subjekti ka tërhequr shumën 1.407 USD ose 144.344 lekë⁷⁷ nga Tirana Bank.
- ii. Në të njëjtën datë ka tërhequr shumën 607.581 lekë nga Tirana Bank.
- iii. Depozitat në Tirana Bank janë hapur më 7.8.2002, të cilat kanë qenë të investuara deri më 10.8.2004.

Këto shuma e kanë burimin të shumat e tërhequra gjatë janarit të vitit 2002⁷⁸ nga Intesa Sanpaolo Bank.

- iv. Shuma 500.000 lekë *cash* deklaruar në DPV/2003.
- v. Në total shuma e përftuar është 1.251.925 lekë.

Subjekti i rivlerësimit rezulton se ka pasur burime të mjaftueshme për dhënien e huas vëllait të tij.

53.2.5.2 Shlyerja e huas deklarohet, si vijon:

- në vitin 2006 shlyhet shuma prej 500.000 lekësh; dhe
- në vitin 2014 shlyhet shuma prej 1.100.000 lekësh.

53.2.5.3 Analizë financiare për mundësinë e kthimit të huas, si vijon:

	deri 2006	2006 – 2014
Të ardhura dokumentuar	1 111 458	1 596 373
Të ardhura nga paga e G. H.	597 205	829 706
Të ardhura nga bashkëshortja E. H.	514 253	0
Shitur apartament në bashkëpronësi 1/6 secili		766 667
SHPENZIME	1 473 373	2 920 860
Shpenzime jetese për 2 persona	973 373	1 820 860
Kthyer huaja të vëllait	500 000	1 100 000
Mundësia për kursime	-361 915	-1 324 487

Nga analiza financiare rezulton se vëllai i subjektit nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme për kthimin e huave. Subjektit iu kalua barra e provës.

Pas kalimit të barrës së provës subjektit provoi me dokumentacion provues se vëllai ka pasur të ardhura të mjaftueshme për kthimin e huas bazuar në analizën e mëposhtme.

	deri fund maji 2006	2007 deri 2014
Të ardhura	1 694 878	10 932 386
Të ardhura nga paga e G.	1 159 580	6 854 535
Të ardhura nga bashkëshortja E.	535 298	3 311 184
Shitur apartament në bashkëpronësi 1/6 secili		766 667
Shpenzime	1 061 801	4 651 010
Shpenzime jetese	500 000	3 551 010
Kthyer huaja tek vëllai	1 061 801	1 100 000
Mundësia për kursime kumulative	133 077	6 281 376

53.3 Subjekti, në DVP/2007, deklaron dhënie hua në shumën prej 900.000 lekësh, znj. M. G..

⁷⁷Kursi mesatar në gusht të vitit 2004, 1euro/102.59 lekë, sipas Bankës së Shqipërisë.

⁷⁸ Sa i takon burimit të ligjshëm të tyre, shihni analizën financiare “Subjekti para 2003”.

	2007
PASURI	-1 881 843
Shtuar huaja dhënë te shoqëria “****” sh.p.k.	800 000
Dhënë hua te M. G.	900 000
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>	<i>-3 581 843</i>
Likuiditete/gjendje	1 828 223
Të ardhura dokumentuar	1 308 107
Të ardhura nga paga e subjektit	1 094 246
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	164 653
Interesa bankare	49 208
Të ardhura nga dhënia e parave me interes	0
SHPENZIME	4 593 654
Shpenzime jetese	409 860
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	273 794
Kaluar shuma te motra M. H.	3 910 000
Mundësia për kursime	-1 403 704

Nga analiza financiare rezulton se subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënie e kësaj huaje dhe për këtë iu kalua barra e provës, e cila është trajtuar në pikën 43.3.2 germa b.4.

53.4 Subjekti, në DVP/2009, deklaron llogari rrjedhëse për znj. R. H. në shumën prej 15.000 euro krijuar nga gjendja *cash* në fund të vitit 2008.

Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar gjendje *cash* në fund të vitit 2008.

Në pyetësorin e datës 30.4.2020 në pyetjen 21, subjekti sqaron në lidhje me shumën 15.251,8 euro se *në fillim të vitit 2009 kumatës së tij i nevojitej përdorimi i një shume prej 15,000 euro. Një shumë të tillë e kishte të vendosur depozitë në Intesa Sanpaolo Bank dhe maturohej në datën 20.2.2009. Për të mos prishur depozitën për shkak të penalteteve dhe humbjes së interesit i ka kërkuar hua Rudinës shumën prej 15,000 euro me të drejtë kthimi në momentin e maturimit. Huaja nga R. iu dha M. në fillim të vitit 2009 pa dokument dhe u kthye nga M. në datën 20.2.2009 nëpërmjet bankës.*

Shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në prova. Nga analiza financiare rezulton se subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj llogarie. Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij rezultati.

Pas kalimit të barrës së provës subjekti dha të njëjtat shpjegime sikundër gjatë hetimit administrativ, duke kërkuar që të ndryshonim qëndrim, pasi shumën prej 15.000 euro nuk e ka pasur gjendje *cash* në fund të vitit 2008 dhe ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e shumës 15.000 euro në fillim të vitit 2009, pasi i është kthyer huaja nga shoqëria “****” sh.p.k.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se nuk mbështetën në prova. Referuar deklaratimeve në DVP/2009 të cilat kanë vlerë të plotë provuese, burimi i depozitës prej 15.000 euro është gjendja *cash* në fund të vitit 2008, por dhe sikur të merren në konsideratë shpjegimet e subjektit që kjo shumë është krijuar nga huaja e kthyer nga shoqëria “****” sh.p.k., sërish subjekti është në pamundësi financiare.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e shumës 15.000 euro.

54. Në lidhje me likuiditet e subjektit të rivlerësimit

54.1 Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 19.9.2019, të Alpha Bank, rezulton se:

- në datën 1.7.2016 ka depozituar shumën 6.000 euro;
- në datën 30.12.2016 ka depozituar shumën 10.000 euro.

	30/5 deri 6.7.2016	6/7 deri 30.12.2016
PASURI	992 676	2 085 174
Depozituar <i>cash</i> tek Alpha Bank 6.000 euro	811 620	
Depozituar <i>cash</i> tek Alpha Bank 10.000 euro		1 352 700
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>	181 056	732 474
Likuiditete/Gjendje	945 325	1 677 800
Të ardhura dokumentuar	491 008	3 780 911
Të ardhura nga paga e subjektit	272 271	543 231
Të ardhura nga bashkëshortja	92 737	231 843
Të ardhura nga puna <i>part-time</i> për Institutin e Kulturës Italiane	76 000	372 400
Të ardhura si kujdestare e paaftësisë për fëmijën		80 680
Të ardhura nga pensioni i paaftësisë për vetë fëmijën		82 680
Të ardhura nga kontrata e donacionit për djalin	50 000	300 000
Të ardhura nga qiratë		817 377
Të ardhura nga shitja e pasurive		1 352 700
SHPENZIME	210 552	1 510 845
Shpenzime jetese	115 936	576 458
Shpenzime të posaçme për djalin (sipas kontratës së donacionit)	50 000	300 000
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>		107 575
Paguar kredia tek Alpha Bank, 50.000 euro	44 616	227 312
Shpenzime shkollimi		285 500
Shpenzime në hipotekë		14 000
Mundësia për kursime	-712 220	184 891

Nga hetimi dhe analiza financiare duket sikur subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të depozituar shumën prej 6.000 euro në datën 6.7.2016. Për të provuar të kundërtën e këtij rezultati, subjektit i kaloi barra e provës.

54.2 Subjekti prapësoi se sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.1.2016, shtetaset M. G. dhe R. H. duhet të përfitonin shumën prej 16.000 euro, e cila do të derdhej në Alpha Bank nga blerësi. Shuma prej 16.000 euro është derdhur nga shitësi në datën 18.1.2016 në llogarinë e përbashkët në euro të shtetasve Tritan Hamitaj, R. H. dhe M. G. që shërbente për pagesën e kredisë. Nga kjo llogari znj. M. G. nuk ka bërë asnjëherë tërheqje apo derdhje. Subjekti, në datën 22.1.2016, ka tërhequr shumën prej 15.000 euro, por nga kjo shumë nuk është shlyer detyrimi prej 8.000 euro, për shtetasen M. G.. Këtë shumë e ka mbajtur për nevoja

të mobilimit dhe duke qenë se shoqëria “****” krijoi të ardhura në mobilim, për të cilin kontribuoi edhe ortakja tjetër dhe duke qenë se disa fatura janë paguar në fund të vitit, një pjesë të shumës së tërhequr prej 15.000 euro janë përdorur si derdhje prej 6.000 euro, në po të njëjtën llogari në datën 6.7.2016 me qëllim shlyerje në avancë të kredisë. Shumën prej 8.000 euro që i takonte znj. M. G. nga kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.1.2016, i është dhënë në dorë prej tij në tetor –nëntor të vitit 2016.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në prova, por dhe sikur të merren në konsideratë deklaratimet e tij, sërish do të ishte në pamundësi financiare për të kthyer shumën prej 8.000 euro te znj. M. G..

Për sa më sipër, subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme depozitimin e shumës 6.000 euro.

DEKLARIM I BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT – R. H.

DEKLARIMI I PASURIVE

55. Truall⁷⁹ me sip. 890 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, lagjja “****”, Lushnjë, bashkëpronare R. H., me pjesë 122.5 m² (L. H. e ka pasur pjesën 245 m²). Vlera e saj, e trashëguar. Koha e përfitimit, data 22.3.2015 (data e vdekjes së trashëgimlënësës L. H.). Pjesa takuese: 1/8.

Mbi këtë truall janë ndërtuar 3 pallate nga shoqëria “****” sh.p.k. Në këmbim të truallit me shoqërinë ndërtuese është kontraktuar për të përfituar nga znj. L. H. sip. 482 m² apartamente dhe njësi shërbimi me sip. 36.28 m² dhe znj. R. H. përfiton ½ e tyre.

Aktualisht, znj. R. H. ka shitur pjesën e saj të bodrumit dhe një apartament, duke poseduar në ½ pjesë 34.44 m² dyqan, apartament *** me sip. 119.4 m² shoqëria, *** me sip. 138.4 m².

Burimi i krijimit, sipas deklaratës *Vetting*: trashëgimi.

Arsyetimi ligjor⁸⁰

55.1 Në datën 3.6.2010 është lidhur aktmarrëveshja nr. ***, ndërmjet znj. L. H. (nëna e bashkëshortes së subjektit) dhe shoqërisë “****” sh.p.k., për vënien në dispozicion të truallit në z.k. ***, lagjja “****”, Lushnjë për ndërtimin e një ndërtese shumëkatëshe. Znj. L. H. do të përfitojë në këmbim të truallit, sip. 482 m² apartamente + njësi 36.28 m² + bodrum 36.28 m².

55.2 Origjina e kësaj prone është trashëgimia e znj. L. H. nga gjyshërit e saj I. dhe E. T.. Bazuar në vërtetim pronësie nr. ***, datë 9.8.1996, rezulton se në pronësi të trashëgimtarëve të ish-pronarëve I. dhe E. T. janë dy troje secili me sip. 10.000 m² (në total 20.000 m²) në lagjen “****”, Lushnjë, nga kjo sipërfaqe ½ është kthim fizik dhe ½ kompensim fizik.

⁷⁹ Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) aktmarrëveshje nr. *** prot., datë 3.6.2010, ndërmjet znj.L. H. dhe shoqërisë “****” sh.p.k.; (ii) aktmarrëveshje datë 21.1.2013, ndërmjet znj. L. H. dhe shoqërisë “****” sh.p.k.; (iii) dëshmi e trashëgimisë ligjore nr. *** prot., datë 14.9.2015 për trashëgimlënësën L. H.; (iv) ndryshim i pjesshëm i kontratës noteriale nr. ***, datë 6.1.2016, ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasve M. G. dhe R. H.; (v) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 5.4.2004, për shitjen nga znj. L. H. të truallit me sip. 1.239 m²; (vi) vërtetim pronësie nr. ***, datë 9.8.1996 për dy troje secili me sip. 10.000 m² në lagjen “****” Lushnjë; (vii) dëshmi trashëgimie nr. ***, datë 21.9.1993 për trashëgimlënësit I. dhe E. T.; (viii) vendim nr. ***, datë 9.4.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme, truall + ndërtesë me sip. totale 2.945 m²; (ix) vendim nr. ***, datë 6.5.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për korrigjimin e dispozitimit të vendimit nr. ***, datë 9.4.2003 të kësaj gjykate; (x) deklaratë noteriale nr. ***prot., datë 29.12.2016; (xi) nxjerrje llogarie në Alpha Bank.

⁸⁰ Hetimi i kryer nga Komisioni: shkresë nr. *** prot., datë 17.9.2019 drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 31.3.2020, e ASHK-së Lushnjë; shkresë nr. *** prot., datë 30.4.2020, drejtuar ASHK-së Lushnjë; kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 20.5.2020, drejtuar ASHK-së Lushnjë.

55.3 Me vendim nr. ***, datë 9.4.2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka vendosur pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme, truall + ndërtesë me sip. totale 2.945 m², nga e cila 626 m² ndërtesë në lagjen “****”, Lushnjë, z. k. 8571. Sipas këtij vendimi znj. L. H. i takon ¼ pjesë e sipërfaqes 890 m² truall + ndërtesë furrë buke.

55.4 Ky vendim është korigjuar me vendim nr. ***, datë 6.5.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ku është vendosur korigjimi i dispozitivit të vendimit nr. ***, duke i caktuar znj. L. H. sip. 245 m² – pjesa takuese në truallin me sipërfaqe 890 m².

55.5 Në datën 21.1.2013 është lidhur aktmarrëveshja ndërmjet znj. L. H. dhe shoqërisë “****” sh.p.k., sipas së cilës L. H., në këmbim të truallit me sip. 266.3 m² në lagjen “****”, Lushnjë, kompensohet me sipërfaqet: bodrum 34.44 m² + dyqan 34.44 m² + apartamente 344.44 m².

55.6 Në datën 14.9.2015 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. ***, për trashëgimlënësen L. H., sipas së cilës shtetaset M. G. dhe R. H. (bashkëshortja e subjektit) trashëgojnë secila ½ pjesë të pasurisë dhe detyrimeve të saj.

55.7 Në datën 6.1.2016 me akt noterial nr. ***, është bërë ndryshim i pjesshëm i kontratës sipërmarrjes nr. ***, datë 3.6.2010, për sa i përket sipërfaqes së bodrumit prej 36.28 m², e cila është shkëmbyer në vlerën në para të kësaj sipërfaqeje në shumën 13.000 euro. Gjithashtu, sipërmarrësi do të paguajë edhe shumën 3.000 euro si dëmshpërblim për përcaktim të njëres prej hyrjeve në pozicion jo të mirë në raport me pozicionin ndaj diellit. Pjesa totale prej 16.000 euro do të derdhet në llogarinë në euro të porositësit në Alpha Bank. Nga nxjerrja e llogarisë në Alpha Bank të shtetasve R. H., Tritan Hamitaj, A. G. dhe M. G., vërtetohet shlyerja e detyrimit të shoqërisë “****”sh.p.k., në datën 18.1.2016, me emërtim “detyrim kontratë sipërmarrjeje garazhe ish-hetuesia – R. H. dhe M. G.j”.

55.8 Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 29.12.2016, bashkëshortja e subjektit dhe motra e saj bien dakord që nga sipërfaqja e përgjithshme e përfutuar nga kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “****” sh.p.k., znj. M. G. të marrë një apartament me sip. 88.4 m², duke kompensuar znj. R. H. për pjesën e saj takuese në shumën 15.500 euro. Për sipërfaqen e mbetur nga ajo totale e përfutuar, të vazhdojë bashkëpronësia në mënyrë të barabartë.

55.9 Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Lushnjë rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është pronare me 1/8 pjesë takuese të pasurisë nr. ***, z. k. ***, me sip. 890 m² në adresën lagjja “****”, Lushnjë.

55.10 Në datën 5.4.2004 me kontratë shitblerje nr. ***, datë 5.4.2004, znj. L. H. i ka shitur znj. Sh. T. truall me sip. 1.239 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, lagjja “****”, Lushnjë, me çmim 4.000.000 lekë.

55.11 Nuk kanë rezultuar dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri.

56. Komisioni i ka kaluar subjektin barrën e provës për mungesë të ardhurash të ligjshme në shumën totale 19.253.934 lekë për të gjithë periudhën e rivlerësimit.

Në lidhje me këtë rezultat, Komisioni pasi analizoi shpjegimet e subjektit, rezulton se nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të blerë pasuritë, krijuar likuiditetet dhe mbuluar shpenzimet në shumën -14.836.427 lekë.

	1	2	3	4	5	6
--	---	---	---	---	---	---

Përshkrimi	Pasuri	Detyrime	Pasuri <i>neto</i> (1-2)	Të ardhura	Shpenzime	Mundësia për kursime (4-3-5)
deri 2003	3 157 398	0	3 157 398	3 077 315	603 858	-683 941
2004	7 171 947	0	7 171 947	5 135 552	281 892	-2 318 287
2005	-199 047	0	-199 047	937 342	478 671	657 718
2006	1 279 768	0	1 279 768	1 145 929	508 009	-641 847
2007	1 103 157	0	1 103 157	4 293 107	4 359 655	-1 169 705
2008	2 713 087	0	2 713 087	1 774 077	546 480	-1 485 490
2009	2 473 285	0	2 473 285	1 796 379	546 480	-1 223 386
2010	350 216	0	350 216	1 509 453	642 020	517 217
2011	1 855 796	0	1 855 796	1 685 034	1 084 697	-1 255 459
2012	224 587	0	224 587	1 720 478	818 460	677 431
2013	504 103	0	504 103	1 949 625	905 286	540 236
2014	16 765 726	7 331 777	9 433 949	4 214 264	2 622 394	-7 842 080
2015	12 670 582	9 200 916	3 469 667	6 168 374	2 870 515	-171 808
2016	6 354 692	-2 363 988	8 718 680	10 976 627	2 694 972	-437 025
Total	56 425 297	14 168 705	42 256 593	46 383 557	18 963 391	-14 836 427

V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

56. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit të subjektit Tritan Hamitaj për kriterin e pasurisë, vlerëson se:

- i. Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1,3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme blerjen e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të tij apo të personave të lidhur me të, dhënien e huave prej tij apo të personave të lidhur me të tek të tretët, aftësinë financiare të të tretëve për kthimin e huave, krijimin e likuiditeteve nga ana e tij apo e personave të lidhur me të, si dhe mbulimin e shpenzimeve prej tij apo të personave të lidhur me të për periudhën e rivlerësimit, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Subjekti nuk paraqiti prova, si dhe nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive të tij, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- iv. Subjekti në mënyrë të përsëritur ka ndryshuar deklaramin e tij nga deklarata “Vetting”, në përgjigje të pyetësorëve të Komisionit, si dhe në parashtrimet përfundimtare, duke lindur dyshimet për deklaram të rremë në kuptim germës “ç”, të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

- v. Komisioni mban parasysh në vlerësimin e tij qëndrimin jobashkëpunues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit administrativ, duke iu përgjigjur në mënyra të ndryshme pyetjeve të njëjta të drejtuara nga Komisioni për çështje të caktuara, për të cilat është kërkuar një shpjegim prej tij ose është shmangur nga përgjigjja. Subjekti i rivlerësimit ka cenuar qoftë edhe vetëm me këtë mënyrë sjelljeje besimin e publikut te një funksionar i drejtësisë, i cili duhet të karakterizohet nga sjellja e denjë, serioze dhe e sinqertë, jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe gjatë zbatimit të detyrimeve të tij përgjatë këtij procesi.

57. Në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat, sipas pikës 3, të nenit 61, të këtij ligji, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për rrjedhojë, referuar pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe standardit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, vendimi për subjektin e rivlerësimit është marrë bazuar vetëm në kriterin e pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Tritan Hamitaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 17.9.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Genta Tafa (BUNGO)
Relatore

Lulzim Hamitaj
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi

